

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Page 1

1 E mërkurë, 14 shtator 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes.

8 Asistente e Gjykatës, ju lutem të lajmëroni lëndën e  
9 çështjes.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Është  
11 çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër z.  
12 Salih Mustafa.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit.

15 Së pari, do të kërkoj të na tregojnë se kush është këtu  
16 në sallë nga Zyra e Prokurorisë.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
18 Gjykatës. Mirëmëngjes, të gjithëve brenda dhe jashtë sallës së  
19 Gjykatës. Sot Prokuroria është përfaqësuar nga Jack Smith,  
20 Prokuror i Specializuar; Silvia D'Ascoli dhe De Minicis; kemi  
21 Julie Mann, që është Përgjegjëse e Çështjes; dhe unë jam z.  
22 Michalczuk, Prokuror i Specializuar.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga  
24 ana e viktimave.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes. Viktimat e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 përfaqësuar në këtë Gjykatë sot përfaqësohen nga Jack Provan  
2 që është Zyrtar Ligjor i Asociuar, Unë Anni Pues si  
3 Bashkëmbrojtëse.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala  
5 Mbrojtëse.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
7 Gjykatës. Ne jemi të përfaqësuar nga unë Julius Von Bone, z.  
8 Betim Shala, që është Bashkëmbrojtës; dhe Fatmir Pelaj, Hetues  
9 dhe Përkthyes. Z. Mustafa na bashkohet me videolidhje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit.

12 Edhe për procesverbalin, ndodhemi përpara Trupit Gjykses  
13 numër I.

14 Sot do të vazhdojmë të dëgjojmë deklaratat mbyllëse të  
15 kësaj çështjeje.

16 Përpara se ta bëjmë këtë, sidoqoftë Trupi Gjykses do të  
17 trajtojë një çështje paraprake.

18 Paneli vëren se dje në orën 16.11 minuta Mbrojtësja e  
19 Viktimave njoftoi Trupin Gjykses që Pala Mbrojtëse nuk i  
20 kishte dërguar nocionet e saj të shkruara për reparacion apo  
21 shpërblim brenda afatit të 7 shtatorit 2022, siç është  
22 parashikuar në paragrafin 20 të vendimit të Trupit Gjykses në  
23 dosjen 461 datë 31 gusht 2022. Kjo është si rezultat i  
24 keqkuptimi nga ana e palës së Mbrojtëses së Viktimave.

25 Trupit Gjykses vëren gjithashtu që i ka kërkuar Mbrojtjes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 së Viktimave me email të dërguar përmes Njesisë Administrative  
2 menjëherë që të dërgonte mocionet brenda orës 20.00 të darkës  
3 më datën 13 shtator 2022.

4 Ne kërkuam nga Pala Mbrojtëse, duam të dëgjojmë se cilat  
5 janë parashtrimet e Palës Mbrojtëse.

6 Ne kemi një preferencë apo që t'i marrim të gjitha  
7 parashtrimet në mënyrë gojore përpara përfundimit të kësaj  
8 çështjeje, kështu që kërkesa që unë kam për juve është nëse  
9 jeni në gjendje që të reflektoni lidhur me këto parashtrime,  
10 lidhur me dëmshtëpërblimet, në rast se keni parashtrime të  
11 tilla, sigurisht, ju e keni fjalën.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, ne do t'i  
13 mbajmë të tëra argumentet gojore përfshirë edhe çështjen që ka  
14 ngritur Mbrojtësja e Viktimave në dosjen e saj të  
15 protokolluar. Për sa na përket neve, ne mund ta përfundojmë të  
16 gjithë këtë çështje gjatë ditës së sotme, pra, për sa na  
17 përket neve si Palë Mbrojtëse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit. Faleminderit që jeni në gjendje që t'i bëni  
20 parashtrimet tuaja gojarisht lidhur me parashtrimin që ka bërë  
21 Mbrojtësja e Viktimave, ne kishim parashikuar që ta bënim këtë  
22 gjatë ditës së nesërme. Dakord.

23 Atëhere, mund të vazhdojmë me deklaratën përmbyllëse të  
24 Mbrojtëses së Viktimave lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të  
25 akuzuarit dhe masën e dënimit dhe keni një kohë në

1 dispozicion, siç keni kërkuar.

2 Mbrojtësja e Viktimave, ju e keni fjalën.

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

4 Edhe njëherë, mirëmëngjes, të gjithëve.

5 Në deklaratën time sot, e nderuar Gjykatëse, unë nuk do

6 të përsëris argumente që ka parashtruar Prokurori i

7 Specializuar, por do të nënvijëzoj disa aspekte të rëndësishme

8 të rëndësisë së viktimave që kanë marrë pjesë në këtë çështje.

9 Ky gjyq ishte gjyqi i parë për krime lufte përpara

10 Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për viktimat që marrin

11 pjesë këtu ka rëndësi tejet të madhe që ta shohin që ky gjyq

12 po përfundon dhe që të sqarohen disa çështje. Të sqarohet gama

13 e përgjegjësisë të akuzuarit, fajësia apo pafajësia e tij, si

14 edhe masa e dënimit që mund të vendosë Trupi Gjykses, si dhe

15 dëmshpërblimi i cili u përket atyre.

16 Ajo që do të bëj gjatë ditës së sotme. së pari do të flas

17 lidhur me krimet dhe përgjegjësinë ligjore të të akuzuarit

18 apo, siç thonë avokatët penalë, llojin e përgjegjësisë. E

19 dyta, do të flasim më në hollësi lidhur me akuzën e vrasjes

20 për t'i shtuar prezantimit të ditës së djeshme. Dhe më pas,

21 shkurtimisht, do të diskutojmë besueshmërinë e dëshmisë të

22 paraqitur para Trupit Gjykses. Dhe, më në fund, disa mendime

23 lidhur me masën e dënimit.

24 Krimet për të cilat mbahet i përgjegjshëm i akuzuari.

25 Viktimat e kësaj çështjeje i janë nënshtruar ndalimit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 arbitrar, trajtimit çnjerezor, torturës dhe po kështu edhe  
2 vrasjes. Prokurori i Specializuar gjatë ditës së djeshme i  
3 vendosi viktimat në thelb të deklaratës së tij dhe me hollësi  
4 paraqiti se cilat kishin qenë përvojat e tyre dhe i dëgjuam po  
5 kështu edhe disa prej deklaratave të tyre përpara këtij Trupi  
6 Gjykues. Dhe e kemi vlerësuar një gjë të tillë.

7 Një nga akuzat është ajo e ndalimit arbitrar. Kemi  
8 dëgjuar mjaft rrëfime të dorës së parë nga viktimat të cilat  
9 janë ndaluar në mënyrë arbitrare. Arrestimi i tyre ka qenë i  
10 padrejtë dhe pa ndjekur ndonjë proces apo garanci ligjore.  
11 Asnjë ligj nuk ka justifikuar arrestimin e tyre. Nuk kanë  
12 ekzistuar fletëarrestime. Nuk ka pasur gjykatës i cili të ketë  
13 analizuar paraburgimin e tyre. Nuk janë njoftuar familjet. Dhe  
14 të paktën një rast kemi dëgjuar që anëtarëve të familjes u  
15 janë treguar gënjeshtër lidhur me vendndodhjen e të afërmeve  
16 të tyre.

17 Ndalimi arbitrar është një dhunim i të drejtave të  
18 njeriut. Është një nga të drejtat themelore që është pjesë e  
19 Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Neni 9 në  
20 mënyrë të hapur thotë që askush nuk do t'i nënshtrohet  
21 arrestimit arbitrar, paraburgimit apo dëbimit.

22 Përse është ndalimi arbitrar krim kaq i fshehtë, siç  
23 është përjetuar nga viktimat e kësaj çështjeje?

24 Për shkak se viktimat janë tejet të cenueshme dhe kjo çon  
25 në dhunimin e të drejtave të tjera të njeriut, atyre u

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 privohet mënyra për të mbrojtur veten e tyre. Dhe pikërisht  
2 kjo ka ndodhur këtu. Pas ndalimit arbitrar fillestar, ata janë  
3 ekspozuar ndaj një trajtimi çnjerëzor torture dhe vrasjeje.  
4 Dhe prandaj ne nënvijëzojmë këtë aspekt të ndalimit arbitrar.  
5 Pasi ishte një përvojë çnjerëzuese që ka bërë që viktimat të  
6 ndjeheshin të pafuqishme dhe të cenuara. Dhe anëtarët e  
7 familjes të cilët i kërkonin i ka lënë krejtësisht pa asnjë  
8 shpresë dhe po kështu të dëbuar.

9 Kemi dëgjuar nga rrëfime të ndryshme të viktimave të  
10 cilat janë ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe të  
11 atyre të cilët kërkonin se ku ishin anëtarët e tyre të  
12 familjes. Pavarësisht, është e vështirë që të ndahet ndikimi i  
13 këtij krimi nga ato që kanë ardhur më pas, është e rëndësishme  
14 të nënvijëzojmë që të mos e nënvlerësojmë ndalimin arbitrar  
15 dhe aspektin dhe ndikimin e tij mbi viktimat.

16 Do të diskutoj pak më vonë kredibilitetin e dëshmitarëve,  
17 megjithatë, nuk ka asnjë dyshim që njerëzit janë ndaluar dhe  
18 janë ndaluar pa asnjë arsye të justifikueshme dhe në mungesë  
19 të një ligji që të mbështeste paraburgimin e tyre.

20 I akuzuari mban përgjegjësi po kështu edhe për trajtimin  
21 çnjerëzor të viktimave të cilat kanë dhënë dëshmi para këtij  
22 Trupi Gjykses, si dhe të viktimave të tjera të cilat janë  
23 mbajtur në kompleksin e Zllashit. Prokuroria ka përshkruar në  
24 hollësi gjendjen në të cilën janë gjetur viktimat dhe abuzimin  
25 e tmerrshëm që kanë pësuar ata. Dhe trajtimi çnjerëzor është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Page 7

1 një sulm mbi dinjitetin e tyre njerëzor dhe ka shkaktuar  
2 dhimbje të mëdha. Dhe nga perspektiva e viktimave është e  
3 rëndësishme të nënvijëzohet që është ky aspekt çnjerëzues i  
4 cili i bën ata që të ndihen më keq se kafshët, duke bërë që  
5 disa prej tyre, të prisnin më mirë që t'i merrte vdekja.

6 Këto kushte janë kombinuar me akte të torturës me anë të  
7 së cilës është shkaktuar dhimbje e madhe fizike dhe mendore.  
8 Persona përgjegjës, i akuzuari, kërkuan që t'i dënonin ata dhe  
9 më duhet ta theksoj se bëhet fjalë për njerëz të cilët janë  
10 akuzuar në mënyrë të gabuar që kanë bashkëpunuar me armikun  
11 apo që ishin hajdutë. Akte të torturës, rrahje me anë të së  
12 cilës kërkohet që të frikësoheshin ata që kanë pikëpamje  
13 politike të ndryshme. Kemi dëgjuar mjaft nga Prokurori i  
14 Specializuar gjatë ditës së djeshme. Apo njerëz të cilët janë  
15 vendosur në objektiv për arsye të tjera. Djegia, rrahje,  
16 goditje me rrymë elektrike, ekzekutime të rreme, që të gjitha  
17 këto kanë lënë shumë për pasoja psikologjike dhe fiziologjike  
18 mbi viktimat.

19 Ndalimi i torturës është absolut dhe është një nga  
20 rregullat kryesore të luftës. Asgjë nuk justifikon torturën. E  
21 kam thënë këtë në deklaratën time hapëse dhe po e përsëris,  
22 pasi ky është një mesazh që duhet të përçojë ky gjyq.

23 Viktimat e kësaj çështjeje kanë projektuar të njëjtën  
24 gjë, atë që është shumë e rëndësishme për të mbrojtur popullin  
25 e Kosovës kundër persekutimit serb, por mesazhi duhet të jetë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 8

1 i qartë që nuk justifikohet në asnjë mënyrë tortura. Nuk mund  
2 të justifikohet objektivi i drejtë me metoda të padrejta.

3 Pala Mbrojtëse e ka thënë gjatë gjithë kohës që kjo nuk  
4 është e vërtetë. Po, kjo nuk është e vërtetë dhe nuk mjafton.  
5 Viktimat jo vetëm që kanë dhënë dëshminë e tyre lidhur me  
6 torturën të cilës i janë nënshtruar, ata kanë treguar se cilat  
7 ishin ato që kishin mbetur mbi trupin dhe mbi trurin e tyre si  
8 provë këtu. Ekspertë të pavarur, siç ka sugjeruar Mbrojtësja e  
9 Viktimave dhe Trupi Gjykses, i kanë ekzaminuar disa nga këto  
10 viktima. Ekspertë i kanë firmuar me raportet e tyre që trupat  
11 e viktimave kanë shenja të shumta dhe dëmtime të  
12 drejtpërdrejta të cilat janë si rezultat i torturës së  
13 përshkruar. Dhe kjo është dëshmi shumë e fuqishme.

14 Me këtë është dokumentuar edhe ndikimi psikologjik që  
15 krimi ka pasur mbi këto viktima. Ata vazhdojnë të vuajnë nga  
16 stresi post-traumatik dhe të rijetojnë atë kohë përmes  
17 ëndrrave të tmerrshme dhe kujtimeve po aq të dhimbshme.

18 Ekspertët të cilët i kanë bërë këto raporte kanë punuar  
19 në bazë të standardeve të njohura ndërkombëtare dhe të qasjes  
20 së përbashkët shkencore. Ata janë përmbajtur Protokollit të  
21 Stambollit, që është një manual ndërkombëtar mbi hetimin  
22 efektiv dhe dokumentimin e torturës dhe trajtimeve të tjera  
23 çnjerëzore dhe degraduese në kohën kur ata vetë kanë bërë  
24 raportet që janë paraqitur në këtë çështje penale.

25 Dhe mund të thuhet me të drejtë që Pala Mbrojtëse nuk e



1 ka kundërshtuar zgjedhjen e ekspertëve, metodat që kanë  
2 ndjekur ata apo sesa të vërteta ishin raportet e tyre. Nuk ka  
3 kundërshtuar që këto raporte të bëhen prova, të pranohen si  
4 prova materiale. Këto raporte sipas mendimit tonë nuk lënë  
5 dyshim, asnjë dyshim, që përvoja e trajtimit çnjerëzor dhe  
6 torturat që kanë përshkruar viktimat e drejtpërdrejta nuk  
7 ishin të sajuara por kishin të bënin me ngjarje të vërteta dhe  
8 traumatizuese dhe i akuzuari është një nga personat përgjegjës  
9 për këto vepra, siç do ta diskutoj tani.

10 Në fakt, po merrem tani me llojin e përgjegjësisë. Kemi  
11 dëgjuar dëshmi nga dëshmitarë të ndryshëm të cilët e  
12 përcaktojnë që i akuzuari, komandanti Cali, njeriu me kapelën  
13 e kuqe, është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me krimet,  
14 me ndalimin arbitrar dhe, në mënyrë të drejtë, e kanë lidhur  
15 në mënyrë të drejtpërdrejtë me torturën. Këto dëshmi  
16 deklarojnë, tregojnë qartë përfshirjen e drejtpërdrejtë të  
17 akuzuarit në këto krime dhe kanë bërë të mundur procedimin e  
18 tij si një kryes i drejtpërdrejtë. Prokuroria ka dhënë dëshmi  
19 të drejtpërdrejta dhe të mjaftueshme në këtë çështje.

20 Ishte ai që ka drejtuar. Ai që e ka filluar keqtrajtimin  
21 e njerit prej dëshmitarëve, kur ka thënë "jepini fund". Ai e  
22 ka bërë atë ekzekutimin e inskenuar. Ai ishte i pranishëm në  
23 atë zonë edhe kur ishte në rajon ai komunikonte me njësitin e  
24 tij. Kishte një telefon satelitor dhe kishte makinë me të  
25 cilën lëvizte.

1 Ne jemi dakord me Prokurorin që i akuzuari dhe anëtarët e  
2 tjerë të BIA-s mund të trajtohen si pjesë e një ndërmarrjeje  
3 kriminale të përbashkët, me shkurtesën ndërmarrje kriminale të  
4 përbashkët I. Plani i përbashkët ishte ai i ndalimit arbitrar,  
5 i trajtimit çnjerëzor dhe torturës. Dhe ata kanë bashkëpunuar  
6 për këtë. Dhe, në fakt, ai ka drejtuar.

7 Në qoftë se synimi kryesor i BIA-s ishte që ta çlironte  
8 Kosovën nga persekutimi serb dhe të luftonte për lirinë e saj,  
9 për pavarësinë e saj, veprimet e BIA-s, fatkeqësisht, bëjnë të  
10 qartë, që si një pjesë e vogël e atij plani të madh, ata kanë  
11 ndaluar ata persona të cilët për ta ishin të padëshiruar, i  
12 kanë përshkruar si spiunë apo hajdutë për shkak se nuk ju  
13 pëlqenin pikëpamjet e tyre politike. Dhe kjo formë e  
14 ndërmarrjes kriminale të përbashkët është pjesë e të drejtës  
15 zakonore. Ndërmarrje e përbashkët kriminale III do të ishte  
16 edhe ajo pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, por kjo  
17 nuk është me rëndësi në këtë pikë kundër të akuzuarit.

18 Ndalimi, kemi dëgjuar dëshmi për këtë, ky trajtim  
19 çnjerëzor dhe tortura janë bërë nga anëtarë të Skifterajve.  
20 Skifterat, siç ka treguar Pala Mbrojtëse, është emër tjetër  
21 për BIA-n, një njësit guerilas, i cili komandohej nga i  
22 akuzuari. Asnjë dëshmitar i Mbrojtjes nuk ka lënë ndonjë  
23 dyshim mbi këtë çështje. I akuzuari ishte një komandant i  
24 respektuar që kishte autoritet. Nuk kemi dëgjuar asgjë që të  
25 sugjerojë që ai të mos ketë pasur në kontroll BIA-n apo që BIA

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 11

1 të ketë bërë gjëra të cilat ai nuk donte që ata t'i bënin.

2 Përkundrazi, Pala Mbrojtëse me dëshmitarët e saj ka  
3 treguar në mënyrë të hapur sesi ekzistonte ky lloj  
4 solidariteti brenda këtij njësi.

5 Dhe kjo është arsyeja se përse, komandant Cali, është  
6 përgjegjës si komandant në bazë të nenit 16(1)(c) të ligjit që  
7 është një lloj i veçantë i përgjegjësisë. Prokuroria e ka  
8 diskutuar këtë, por unë dua të shtoj dy gjëra.

9 E para është që përgjegjësia komanduese ishte pjesë e  
10 ligjit zakonor në këtë kohë, në kohën e krimeve në vitin 1999.  
11 Statuti i Romës i 1998 reflekton këtë, siç e bën edhe Gjykata  
12 Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe gjykimi i fundit i  
13 Milanoviçit kundër Kroacisë në janar të këtij viti.

14 Pra, në mënyrë të përbashkët këtu bëhet fjalë për një  
15 përgjegjësi penale në bazë të një ndërmarrje kriminale të  
16 përbashkët. Sipas nenit 16 të Ligjit, nuk ka asgjë që mos  
17 sugjerojë që ky lloj i përgjegjësisë që përmendet atje të jetë  
18 përjashtues. Ne kemi parë edhe instrumente të tjera siç ishte  
19 Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Neni 28 i tij  
20 që thotë, që fillon duke thënë që "Përveç mënyrave të tjera të  
21 përgjegjësisë penale ..."

22 Por, përveç kësaj, që është e rëndësishme këtu është që  
23 të nënvijëzohet roli që luan komandanti për zbatimin e  
24 rregullave të luftës dhe për të bërë të mundur që të gjitha  
25 konfliktet e armatosura të mund të bëhen në mënyrë sa më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 njerëzore që të jetë e mundur në luftë. Është detyra e tij për  
2 të parandaluar shkeljet e të drejtave ndërkombëtare  
3 humanitare. Në qoftë se njësitë del nga kontrolli, është  
4 detyrë e komandantit që t'i dënojë ata të cilët janë  
5 përgjegjës dhe ky është krejtësisht i ndryshëm nga mënyrat e  
6 tjera të përgjegjësisë apo llojet e tjera.

7 Komandant Cali ishte komandant i BIA-s dhe nuk ka asnjë  
8 dyshim. Kur ai nuk ka marrë pjesë të drejtpërdrejtë për krimet  
9 në fjalë, vartësit e tij e kanë bërë këtë. Ai e ka ditur dhe  
10 ka pasur arsye ta dijë se çfarë ka ndodhur në Zllash. Ai ka  
11 qenë i pranishëm dhe siç e thashë edhe më parë, është  
12 përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai nuk ka marrë masa  
13 për t'i ndaluar ata. Dhe dështimi për të marrë veprimin e  
14 duhur për të parandaluar apo dënuar aktet e torturës dhe  
15 krimeve të tjera, kontraston me përfshirjen e tij të  
16 drejtpërdrejtë dhe ka efektin shtues.

17 Si komandant, z. Mustafa, ju keni pasur të drejtën për  
18 t'i mbrojtur viktimat. Përkundrazi, ju dhe njerëzit tuaj keni  
19 bërë ndalime arbitrare dhe keni kryer krime me të cilat jeni  
20 ngarkuar. Dhe nën komandën tuaj, të paktën njëri është vrarë.  
21 Pavarësisht se Pala Mbrojtëse është përpjekur të tregojë që ju  
22 keni lëvizur, nuk keni qenë gjatë gjithë kohës i pranishëm në  
23 Zllash, kjo nuk i heq përgjegjësi.

24 E them këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë, për shkak se  
25 viktimat nuk e kanë pasur mundësinë të përballen me të

1 akuzuarin brenda kësaj salle gjyqi.

2 Tani t'i kthehem akuzës të vrasjes dhe ta shpjegoj pak më  
3 gjatë. Ka nevojë që ta diskutojmë në mënyrë të posaçme për  
4 shkak të viktimave të cilat kanë mbijetuar dhe të cilat ishin  
5 të tronditur nga fati që ka pësuar i bashkëburgosuri që është  
6 vrarë. I ka lënë njerëz të traumatizuar, të cënueshëm dhe  
7 ndikon edhe sot e kësaj dite mbi jetën e tyre.

8 Kemi dëgjuar me hollësi dhe dëgjuam si u përshkrua edhe  
9 gjatë ditës së djeshme sesi një viktimë ishte veçuar, një  
10 viktimë mes atyre të ndaluarve në mënyrë arbitrare dhe që janë  
11 torturuar. Pra, njëri është veçuar. Në fakt, viktimat që kanë  
12 mbijetuar kanë dëshmuar, kanë përshkruar sesi viktima e vrarë  
13 është torturuar në mënyrë të përsëritur më shumë se të gjithë  
14 të tjerët. Nuk ishte një gjendje që të ecte apo të qëndronte  
15 në këmbë. Dhe, siç dëgjuam gjatë ditës së djeshme, ishte  
16 masakruar. Ishte më shumë i vdekur sesa i gjallë. Më vonë ai u  
17 gjet i varrosur në një varr të cekët në afërsi të kompleksit  
18 të ndalimit dhe trupi i tij ishte në dekompozim e sipër, që  
19 tregonte që ai, vdekja kishte ndodhur disa kohë përpara se të  
20 gjendej.

21 Të ballafaqohem me faktin, siç e bëri edhe Prokuroria  
22 deri në një farë mase gjatë ditës së djeshme, që ne nuk ishim  
23 në gjendje që të përcaktonim më saktësisht momentin e saktë të  
24 vdekjes së viktimës. Dhe kjo lë hapur pikëpyetje për ata të  
25 cilët duan ta kuptojnë plotësisht atë që ka ndodhur, por jam

1 dakord me Prokurorinë që kjo mungesë njohurish për momentet e  
2 fundit nuk nënkupton që i akuzuari nuk është përgjegjës për  
3 këtë vrasje.

4 Bazuar mbi dëshminë që kemi dëgjuar gjatë gjithë gjyqit,  
5 janë vetëm tre viktima [sipas përkthimit] të mundshme për  
6 vdekjen e viktimës së vrasjes, siç është diskutuar në mënyrë  
7 të gjerësishme nga pala e Prokurorisë. Dhe prandaj, unë do ta  
8 shkurtoj prezantimin tim për sa i përket këtij skenari dhe do  
9 të flas fare shkurtimisht përpara se të flas për pasojat  
10 ligjore të skenarëve të tjerë.

11 Ky skenar është që anëtarët e BIA-s kanë kryer veprën  
12 penale të vrasjes duke ja marrë jetën viktimës përpara se të  
13 largoheshin nga kompleksi i Zllashit. Ndërkohë që mund të  
14 spekulojmë thjesht se përse e kanë bërë këtë gjë anëtarët e  
15 BIA-s, është e mundur që ata kanë pasur frikë se do të  
16 identifikoheshin apo se viktima do të ishte një barrë e  
17 padëshiruar gjatë procesit të evakuimit. Në fund të fundit, ai  
18 nuk ishte në gjendje që të ecte për shkak të torturave të  
19 cilat kishte pësuar dhe dëshmitë kanë treguar se ndoshta  
20 kishte pasur edhe këmbët të thyera.

21 Pavarësisht arsyeve, skenari që parashikon që viktima  
22 është vrarë nga BIA është shpjegimi më i mundshëm në bazë të  
23 fotografive që kemi parë dhe të shenjës së plumbit në trup. Që  
24 të gjitha këto nxjerrin në pah përgjegjësinë e të akuzuarit si  
25 komandant.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 Po le të përqendrohemi pak në këto dy skenarët e tjerë. I  
2 dyti. Është e mundur teorikisht që kur BIA u largua nga  
3 kompleksi i Zllashit, viktimia u la prapa ndërkohë që po vinin  
4 forcat armike dhe vdiq si rezultat i plagëve të marra BIA.

5 Përafërsisht që jam dakord që është më pak i pranueshëm  
6 si skenar përsëri nuk ia heq përgjegjësinë të akuzuarit për  
7 vdekjen e viktimës. Përse?

8 Elementi i krimit të luftës së vrasjes si krim lufte  
9 është parashikuar në shumë raste. Në Tribunalin e Hagës në  
10 gjykimin e apelit të Xhorxheviqit më 27 janar 2014, paragrafi  
11 548 ku thotë që kërkohet që të përmbushin këto elemente: Që të  
12 ketë vdekur një viktimë që nuk merr pjesë në luftime, që është  
13 e qartë këtu; që vdekja është rezultat i një akti apo një  
14 mangësie nga ana e kryesve apo e një apo më shumë personave  
15 për të cilët mban përgjegjësi penale i akuzuari. Këto akte  
16 janë aktet e shumta të dhunës së tmerrshme që e kanë bërë që  
17 viktimia të ishte më shumë i vdekur sesa i gjallë. Siç kemi  
18 dëgjuar, është përshkruar si masakër.

19 Dhe, në fund, që kryesi ka synuar që ta vrasë viktimën  
20 ose që t'i shkaktojë atij dëme serioze duke pasur njohurinë e  
21 arsyeshme që ky sulm do të çonte me të gjitha gjasat në  
22 vdekje. Tortura kaq e rëndë që është demonstruar gjatë këtij  
23 gjyqi për sa i përket viktimës së mbrojtjes kishte gjasa më të  
24 mëdha që të çonte në vdekjen e tij. Dhe në një farë mënyre  
25 është një skenar më i tmerrshëm për ta lënë dikë të vdesë në

1 dhimbje kur ka pësuar këto lëndime kaq të mëdha.

2 Dhe, së fundi dhe skenari, për mendimin tim, më pak i  
3 pranueshëm apo i mundshëm është që viktima është lënë pas i  
4 lënduar rëndë në atë mënyrë që nuk ishte në gjendje as të  
5 ecte, as të vraponte për të kërkuar mbrojtje dhe teorikisht,  
6 ai mund të ishte vrarë nga zjarri i armikut. Dhe e nënvijëzoj  
7 teorikisht. Dhe është ky që përfundimisht i ka marrë jetën.  
8 Edhe në këto kushte, kjo nuk e heq përgjegjësinë për të  
9 akuzuarin.

10 Për shkak se viktima ishte i parandaluari i njësitit të  
11 akuzuarit, ata kanë pasur detyrën e përkujdesjes për të. Lënia  
12 e këtij personi pa mbrojtje përballë një armiku i cili njihej  
13 që persekutonte shqiptarët e Kosovës është i barasvlershëm me  
14 mbrojtjen [sipas përkthimit]. Në këtë rast, janë shfrytëzuar  
15 forcat serbe për ta përfunduar jetën e tij. Pra, siç e them  
16 edhe njëherë, ky skenar ka gjasa më të pakta, megjithatë duhet  
17 ta shqyrtojmë për shkak se Pala Mbrojtëse duket se kur ka  
18 sugjeruar se ky mund të ketë qenë edhe shkaku i vdekje.

19 Pavarësisht edhe në këtë kombinim, elementet ligjore të  
20 vrasjes janë përmbushur. Sidomos, synimi për të vrarë.

21 Edhe tani po përsëris jurisprudencën e Tribunalit të  
22 Hagës që është mjaft me vlerë. Për shembull, Trupi Gjykses i  
23 Tribunalit të Hagës në Ori, në çështjen Oriçe, 30 qershor  
24 2006, paragrafi 348, tha që synimi për të vrarë kërkohet me  
25 qëllim që të përmbushet kushti *mens rea* dhe këtu parashikohet



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 që të ekzistojë gjendja mendore në të cilën kryesi e  
2 parashikon që ka gjasa më shumë se mund të vdesë një viktimë  
3 si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tija dhe  
4 megjithatë e pranon këtë rrezik.

5 Po ashtu, në 2007, në 12 qershor, TPNJ-ja në çështjen  
6 Oriç tha se *mens rea* e vrasjes kërkon synimin për të vrarë.  
7 Njohurinë se vdekja e viktimës ka qenë një pasojë e mundshme e  
8 aktit të mosveprimit. Dhe, përsëri, të lësh një person të  
9 plagosur shumë pa mbrojtje përpara armiqve, që ishin duke  
10 ardhur, pasqyron qartësisht pasojën e mundshme të vdekjes së  
11 viktimës. Dhe kishte më shumë gjasa që kjo do të ndodhte.

12 Ne dëgjuam dhe jo më pak nga dëshmitarët e Mbrojtjes se i  
13 akuzuari ishte përfshirë aktivisht në evakuimin e të  
14 plagosurve nga Zllashi. Në qoftë se i akuzuari dha urdhra  
15 aktive se çfarë duhet të ndodhte me viktimën, ai është  
16 përgjegjës. Në qoftë se ai nuk u mor më tej me atë që do të  
17 ndodhte me këtë të burgosur të plagosur rëndë dhe ua la këtë  
18 njerëzve të tij, kjo nuk e çliron atë nga përgjegjësia.

19 I akuzuari të paktën kishte arsye të dinte se krimi i  
20 vrasjes do të kryhej. "Kishte arsye të dinte" ky element i  
21 arsyes për të ditur kërkon që një i akuzuari të ketë pasur  
22 informacione të përgjithshme për të qenë i informuar lidhur me  
23 akte të mundshme të paligjshme.

24 Dhe, njëherë, më lejoni t'i kthehem TPNJ-së në  
25 aktgjykimin të saj të Çelebiqit, paragrafët 237, 241. Dhe

1 interpretimi që është bërë në rastin e Tribunalit Ndërkombëtar  
2 të Ruandës në çështjen, në aktgjykimin e Nahimana.

3 Përgjegjësia e të akuzuarit për vrasje, pra, varet nga  
4 njohuria e tij e përgjithshme e cila do t'i jepte atij arsye  
5 të dinte minimumi gjasat e kryerjes së këtij krimi. Kjo do të  
6 thotë se i akuzuari prapë do të ishte përgjegjës edhe nëse nuk  
7 ka pasur hollësi konkrete për vetë vrasjen. Ai e dinte dhe  
8 është përfshirë në ndalimin dhe torturat e paligjshme. Ai i  
9 kryesonte përpjekjet e nxjerrjes së të plagosurve nga Zllashi.

10 Dëshmitari i Mbrojtjes Hadri, që u citua dje, u ndje i  
11 detyruar të thoshte gjatë gjyqit kur përshkruante evakuimin  
12 nga Zllashi.

13 "Unë e falënderoj publikisht Calin dhe ushtarët e tij që  
14 jam gjallë sot. Unë i falënderoj ata për organizimin. Ata na  
15 shpëtuan ne, pra, si staf mjekësor dhe civilët dhe bashkë me  
16 të plagosurit".

17 Pra, i vrari nuk ishte kaq fajtor, i vdekuri. Viktima e  
18 rrahur kaq keq sa nuk mund të ecte apo të qëndronte në këmbë  
19 nuk u shpëtua. Dhe, ose ndodhi kështu, ose u la aty. Pra, i  
20 akuzuari kishte të gjithë informacionin e nevojshëm për të  
21 ditur se një gjë e tillë do të ndodhte, prandaj i akuzuari  
22 është përgjegjës për vrasje si edhe për ndalim arbitrar,  
23 trajtim mizor dhe torturë dhe për këtë duhet ndëshkuar  
24 rrjedhimisht.

25 Tani, të diskutoj shkurtimisht kredibilitetin dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 19

1 besueshmërinë e disa prej dëshmitarëve dhe dëshmitë para këtij  
2 Paneli. Nuk dua të përsërit ato që dha Prokuroria, do të  
3 përpigem të flas sa më shkurt.

4 Disa konstatime shtesë janë të rëndësishme kur duam të  
5 vlerësojmë kredibilitetin e dëshmitarëve këtu dhe  
6 besueshmërinë e deklaratave të tyre. Paneli duhet të tregohet  
7 shumë i kujdesshëm kur të shqyrtojë efektet që traumat  
8 afatgjata kanë shkaktuar ndaj dëshmitarëve në këtë rast.  
9 Gjithashtu duhet t'i kushtojmë vëmendje konkrete pasojave të  
10 dinamikave të pushtetit që vazhdojnë në mënyrë të fshehtë,  
11 ndonjëherë jo aq të fshehtë, të ndikojnë në sjelljen e  
12 dëshmitarëve dhe, së fundi, komunikimin dhe pengesat e  
13 komunikimeve kulturore.

14 Kemi parë se disa dëshmitarë janë paraqitur në mënyra të  
15 ndryshme gjatë këtij gjykimi. Kemi parë sjellje shumë të  
16 largët, kemi parë përpjekje për të qëndruar, për të ndenjtur në  
17 kontroll. Kemi parë momente zemërimi, shmangieje, shqetësimi.  
18 Shkurtimisht, kemi parë një gamë të gjerë sjelljesh të  
19 ndryshme të shfaqura nga ata që kanë raportuar për krime të  
20 cilat ata kanë pësuar. Kjo gamë sjelljesh pritet nga viktimat  
21 e ngjarjeve traumatizuese.

22 Një studim i kohëve të fundit në këtë fushë ka treguar se  
23 prova të forta tregojnë se të mbijetuarit e këtyre ngjarjeve  
24 përjetojnë simptoma shqetësimesh post-traumatike, për  
25 shembull, duan që të mos i shprehin emocionet apo tregohen të

1 largët. Dhe kjo vlen, kjo shfaqet sidomos në rastin e  
2 kujtimeve traumatike kur ato riaktivizohen.

3 Trauma lidhur me mënyrën sesi truri vepron me  
4 informacionin ndryshon shumë nga një viktimë në tjetrën të  
5 cilat kanë përjetuar të njëjtat gjëra. Në rastin e disave, e  
6 kanë shumë të vështirë të kujtojnë apo të rrëfejnë hollësi në  
7 mënyrë lineare apo në mënyrë të plotë duke treguar një rrëfim  
8 koherent njëkohësisht. Disa të tjerë, mund të bëjnë rrëfime të  
9 hollësishme.

10 Shkurtimisht, këto veçori të efekteve të traumës ndaj  
11 kujtesës duhen marrë parasysh nga Paneli në vlerësimin e  
12 dëshmisë së dëshmitarëve.

13 Me këto fjalë, do të diskutoj tani disa elemente të  
14 dëshmive të dhëna nga dëshmitarë të ndryshëm dhe do ta bëj  
15 kryesisht në pjesën më të madhe në seancë të hapur, do të flas  
16 shkurt dhe herë pas here nuk do të futem në hollësi të mëdha,  
17 siç do të kisha bërë në raste të tjera. Por, për publikun  
18 mendoj që është e dobishme dhe nuk do të ndryshoj argumentet.  
19 Pra, do të ketë një seancë të shkurtër që do ta kryejmë  
20 privatisht.

21 Tani po i kthehem Dëshmitarit 01679, i cili na tregoi një  
22 histori të rëndësishme dhe të hollësishme nga vuajtjet e tij  
23 në Zllash. Edhe pse vuan me stres post-traumatik, të bënte  
24 përshtypje të shikoje kur ai përpigëj të rrinte, të ishte i  
25 qetë dhe i kontrolluar. U përpoq qartë të mos i linte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 emocionet ta kaplonin. Për mendimin tim, nuk ka dyshim fare se  
2 ky dëshmitar është i besueshëm.

3 Ai që në gjendje të na jepte një dëshmi themelore me  
4 shumë hollësi të cilat më pas, në mënyrë të pavarur, u  
5 vërtetuan. Siç na demonstroi ndërkohë ZPS-ja, një fakt  
6 interesant ishte se dëshmitari që në gjendje të identifikonte  
7 një nga torturuesit e tij me emër Bimi përpara sesa të  
8 përmendej në Gjykatë.

9 Dëshmitari 01679, gjithashtu, dha një rrëfim të  
10 hollësishëm konsekuent. Ai dha shpjegime të qarta lidhur me  
11 arsyen se pse deklarata e tij dhënë ZPS-së, deklaratat e tij  
12 nuk ishin aq konsekuente në lidhje me deklaratat e tij të  
13 mëparshme dhënë UNMIK-ut. Por, ta pranojmë, këto procedura në  
14 fakt ishin me të meta të UNMIK-ut. Në atë kohë, UNMIK-u nuk  
15 kishte aftësi profesionale të siguronte mbështetje të  
16 përshtatshme për dëshmitarët, përkthyes të trajnuar dhe  
17 profesionistë. Të gjithë këta komponentë të rëndësishëm për të  
18 siguruar integritetin e procedurave dhe kushte të cilat  
19 lejonin rrëfime autentike të ngjarjeve.

20 Rrëfimi i torturave nga dëshmitari provohet, vërtetohet  
21 dhe është përmendur dhe më përpara nga ekzaminimi mjekësor dhe  
22 psikiatrik ku dy ekspertë së bashku erdhën në përfundimin se  
23 shenjat e tij, lëndimet e tij dhe gjendja e tij mendore  
24 përputhen fuqimisht me ato që ai thoshte. Duke ju përmbajtur,  
25 siç thashë përpara, standardeve të Protokollit të Stambollit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 për hetimin e torturës, ky rezultat është aq i fortë sa mund  
2 të ishte.

3 Nuk mund të përcaktojmë kurrë plotësisht me siguri të  
4 plotë shkakun e një lëndimi pas shumë, shumë vitesh. Por një  
5 pamje konsistente, pra, konsekuente u pa nga ekspertët që  
6 është një rezultat i rëndësishëm për ta pasur parasysh dhe për  
7 ta theksuar se dëshmitari nuk kishte nevojë t'i nënshtrohej  
8 një ekzaminimi që për të ishte aq stresues.

9 Nuk kishim nevojë që ta sugjeronim këtë formë deponimi.  
10 Megjithatë, dëshmia e tij për të kontribuar në prova tregon  
11 sesa ai donte, sa i interesuar ishte ai që të nxirrte në dritë  
12 të vërtetën. Dhe kjo përforcon kredibilitetin dhe  
13 besueshmërinë e rrëfimit të tij.

14 Dëshmitari 04669 ishte një tjetër viktimë i  
15 drejtpërdrejtë që dëshmoi përpara kësaj Gjykate dhe ishte  
16 njëlloj i besueshëm në ato që tha lidhur me ngjarjen që çuan  
17 deri dhe gjatë ndalimit të tij në Zllash. Ai dëshmoi në mënyrë  
18 të qetë, të përmbajtur, mbështetur nga gjuha e trupit të tij,  
19 duke bërë përpjekje të mëdha që emocionet negative të mos i  
20 linte të ndërhyjnë në rrëfimin e tij të ngjarjeve. Edhe ai iu  
21 nënshtrua ekzaminimit të ekspertëve, me vullnetin e tij të  
22 lirë iu nënshtrua përvojave njëlloj të dhimbshme dhe ky  
23 ekzaminim po ashtu tregoi se trupi i tij i mbushur me shenja  
24 përputhej me rrëfimin e tij lidhur me ngjarjet të cilat  
25 rrahjet të cilat ai kishte pësuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 23

1 Dëshmia e tij gjithashtu përmbante hollësi që më vonë u  
2 vërtetuan nga dëshmitarë të tjerë. Jo vetëm ai konfirmoi  
3 përshkrimin e dëshmitarit të mëparshëm, 679, që kish dhënë  
4 lidhur me trajnimin me shkollën e Zllashit. Dëshmitarët e  
5 Mbrojtjes, për ironi, ishin midis atyre që dhanë hollësi  
6 provuese. Për shembull, trajneri, trajnuesi i UÇK-së i cili  
7 kishte një brez të zi në karate, Musli Halimi, po ashtu e  
8 konfirmoi këtë apo incidenti me helikopterin serb që kishte  
9 venë atë shenjën e ndihmës humanitare, Kryqin e Kuq, për të  
10 fshehur një sulm që më pas u konfirmua nga Sejdi Veseli.

11 Ky kontekst, sigurisht, është i rëndësishëm sepse ka qenë  
12 dhe motivim për dëshmitarin dhe për shumë, shumë njerëz në  
13 Kosovë për të luftuar me UÇK-në, për të marrë pjesë në  
14 konfliktin e armatosur që zhvillohej në atë kohë. Ishte në  
15 fakt një nga anët e fshehta të krimeve të kryera nga viktimat.  
16 Ai besonte se ishte një ndër kosovarët që luftonin për të  
17 njëjtën kauzë.

18 Tani t'i kthehem diskutimit të dëshmisë së Dëshmitarit  
19 03593. Edhe njëherë, nuk kam dyshim se është ndaluar  
20 arbitrarisht se i është nënshtruar torturës së trajtimit  
21 mizor.

22 Përshkrimi bazë i vuajtjeve të tij ishte konsekuent në të  
23 gjitha deklaratat e tij. Ai madje u përpoq të na tregonte edhe  
24 shenjat që dukeshin fizikisht. Ai raportoi shumë nga treguesit  
25 e traumave, anktheve dhe shqetësimeve që kishte me gjumin. E

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 24

1 megjithatë, siç dëgjuam dje dhe Paneli do ta kujtojë këtë,  
2 dëshmitari i bëri bisht përmendjes së emrit të të akuzuarit  
3 gjatë dhënies së dëshmisë.

4 Refuzimi i tij, që ndryshe do të dukej irracional, duke  
5 pasur parasysh deklaratat e tij të mëparshme dhe dëshminë e  
6 përgjithshme, mund të shpjegohen për dy arsye. E para, siç e  
7 diskutoj ZPS-ja dje, ai ishte në një presion të madh. Tjetra  
8 dhe, dua ta theksoj këtë, është se mund të kemi vënë re  
9 gjithashtu se një dëshmitar i traumatizuar përdor strategjinë  
10 e shmangies për t'u shkëputur nga personi që ai e identifikon  
11 si torturuesin kryesor të tij.

12 Neve na duket sikur s'ka shumë kuptim, por në një gjendje  
13 emocionale që është një viktimë e tillë, ky do të ishte një  
14 shpjegim tjetër që duhet ta marrim parasysh. Dëshmitari i  
15 ishte nënshtruar pyetjeve të gjata, të thella, aq sa pothuajse  
16 ndihej sikur përsëri po e torturonin, po e dhunonin,  
17 keqtrajtonin duke qenë se ishte i detyruar të rijetonte ato  
18 përvoja dhe ato trauma që kishte kaluar për katër ditë me  
19 radhë.

20 Edhe pse Mbrojtja ka ndjekur një pozicion më të lehtë  
21 duke thënë se të gjithë këto dëshmitarë nuk thonë të vërtetën,  
22 nuk ka asgjë që do të shpjegonte se përse ata do të gënjenin  
23 dhe do të vinin jetën e tyre në rrezik. Të gjitha këto viktima  
24 të drejtpërdrejta kanë dhënë rrëfime lidhur me përvojat e tyre  
25 në Zllash, gjë që nuk lë dyshim se ka ndodhur tortura dhe se



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 25

1 këto janë bërë nga njësia BIA nën komandën e komandantit Cali,  
2 që është përgjegjës për krimet e kryera. Të tre këta burra nuk  
3 ishin të lidhur me njëri-tjetrin, siç dëgjuam dje. I vetmi  
4 element i përbashkët është përvoja që kanë jetuar në Zllash.  
5 Të gjithë kishin shumë për të humbur duke ardhur dhe për të  
6 dëshmuar në këtë çështje.

7 Tani, po i kthehem Dëshmitarit 03594. Dëshmia e tij në  
8 Gjykatë dukej më pak e besueshme sesa ajo e tre viktimave të  
9 tjera të ndaluar në Zllash dhe ka vetëm vlerë të kufizuar  
10 provuese. Pjesërisht nuk përputhej me deklaratën e tij të  
11 mëparshme. Madje dhe më shumë se kaq, ai këtu paraqiti hollësi  
12 të cilat do të kishin qenë të rëndësishme nga pikëpamja e tij  
13 si dëshmitar. Megjithatë ai i solli ato vetëm kur e dëgjuam  
14 këtu në Gjykatë.

15 Mbrojtja vazhdimisht përmendi 100 Deutschmark gjermane  
16 dhe unë do të mendoja se të gjithë ne e kujtojmë. Më lejoni të  
17 kujtoj edhe një herë sesi e përshkroi ai mbas lirim të tij,  
18 kishte ndaluar të rruhej sepse po iknin nga forcat armike që  
19 po afroreshin. Ishte e çuditshme kur ai e përshkroi, në mënyrë  
20 që s'ia kërkoi kush që viktimat e tjera nuk kishin krah të  
21 thyera, këmbë të thyera apo dhëmbë të thyera.

22 Ky dëshmitar, për mendimin tonë, e kishte për mision të  
23 zbuste çdo veprim të cilin mund ta lidhnin me UÇK-në apo me të  
24 akuzuarin. Motivimi i tij mund të mbështetet në faktin se  
25 familja e tij dhe ajo e të akuzuarit vazhdojnë të jetojnë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 26

1 bashkë si fqinjë. Pra, kjo mund të ishte një trysni e  
2 mjaftueshme për t'u provuar dhe kufizuar "dëmin" që i ishte  
3 bërë atij më parë nga dëshmia për ZPS-në.

4 Pavarësisht nga përpjekjet e tij të qarta për të  
5 minimizuar çdo veprim të gabuar të të akuzuarit apo të njësisë  
6 së tij, dëshmitari, në fakt, provoi disa elemente që provojnë  
7 ato që kishin thënë viktimat e tjera. Ndalimin e tij të  
8 paligjshëm si bashkë me ata të tjerët, përshkrimin e vendit  
9 dhe të kompleksit në Zllash që mbivendoset ndjeshëm me atë të  
10 dëshmitarëve të tjerë, trarët në tavan, zona e ngritur, dhoma  
11 në haur dhe ato dërrasat e vjetra. Ai konfirmoi se pa disa  
12 shenja në trupat e tyre, gjithashtu konfirmoi lirimin e tyre  
13 në 18-19 prill në kontekstin e fillimit të ofensivës serbe si  
14 dhe të ecurit nga Zllashi në Prishtinë. Dhe konfirmoi se  
15 kushtet në Zllash ishin çnjerëzore dhe më pak se siç mund të  
16 trajtoheshin kafshët.

17 Dhe së fundi, Mbrojtja i dha shumë rëndësi dëshmisë së  
18 këtij dëshmitari. Megjithatë nuk mori parasysh faktin se edhe  
19 ky dëshmitar konfirmoi akuzat e ndalimit arbitrar dhe  
20 trajtimit mizor.

21 Tani do t'i lutesha Panelit të futeshim në seancë private  
22 që të diskutoj disa hollësitë cilat mund të jenë identifikuese  
23 për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të dëshmitarëve në  
24 këtë çështje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

1 të kalojmë në seancë private, ju lutem.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
5 jemi në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
7 nderuar Mbrojtësja e Viktimave, mund të vazhdoni.

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Ndërkohë që dëshmitarët kanë folur  
9 për përvojat e tyre, ata nuk janë munduar që të lidhin ndonjë  
10 përgjegjësi me të akuzuarin. Nuk janë përpjekur që ta  
11 fajësojnë të akuzuarin. Por dëshmitë e tyre, në fakt, janë  
12 karakterizuar nga dhimbja e madhe që vuajnë edhe sot e kësaj  
13 dite. Shumë prej tyre ishin në stres të dukshëm, shumë prej  
14 tyre ishin në stres, po mundoheshin që të mos dridheshin dhe  
15 të ishin sa më pak emocional që të ishte e mundur dhe të  
16 jepnin një dëshmi sa më të plotë të ishte e mundur.

17 Tani, të nderuar Gjykatës, më lejoni që të shtoj  
18 shkurtimisht disa konstatime për mënyrën sesi çështja e  
19 Mbrojtjes ka konfirmuar dhe ka mbështetur disa prej dëshmime  
20 të viktimave.

21 Ata kanë konfirmuar detaje që viktimat në fakt mund të  
22 kenë ditur për ngjarjet në qoftë se do të ishin trajnuar me  
23 UÇK-në dhe në qoftë se do të kishin qenë në kompleksin e  
24 Zllashit. Dhe përmendën disa raste në këtë kategori. Në fakt,  
25 dëshmitarët e Mbrojtjes mbështesin përvojat e viktimave dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 31

1 ndihmojnë për të konfirmuar kredibilitetin dhe vlerën për  
2 vërtetimin e të vërtetës përmes dëshmisë së tyre. Për  
3 shembull, Musli Halimi, pra, tha që ishte dëshmitar që kishte  
4 brez të zi në karate dhe gjithashtu, konfirmoi dhe dëshminë e  
5 dhënë nga Dëshmitari 04669 që rekrutët nuk gjuanin me armë të  
6 vërteta po vetë me armë ajri.

7 Pra, janë këto detaje të cilat në vetvete duket sikur nuk  
8 janë të rëndësishme për akuzat e ngritura në vetvete  
9 megjithatë janë të rëndësishme për të treguar që kjo ishte një  
10 përvojë e vërtetë me të cilën ishte hasur.

11 Dëshmitari 1679 përshkroi dhomën ku ishte dërguar pasi  
12 kishte mbërritur në Zllash dhe tha që duke u futur në ndërtesë  
13 kishte një korridor me një dhomë në të majtë dhe një derë në  
14 të djathtë. Ai ishte dërguar në dhomën në të majtë që  
15 përmbante, që kishte brenda saj karrige, një tavolinë pune,  
16 një gardërobë, kuti me gjëra, gjithashtu edhe parket druri në  
17 dysheme.

18 Dëshmitari 3593 gjithashtu mban mend që kishte të gjitha  
19 llojet e mundshme të gjërave në dhomë.

20 Këto hollësi gjithashtu konfirmohen nga Hadri, e cila i  
21 referohet ndërtesës si shtabi. Ajo, pra, e përshkruan  
22 korridorin me një dhomë në të dyja anët. Në dhomën në të  
23 majtë, ajo thotë që kishte një tavolinë pune, ishte dhe një  
24 person i cili qëndronte pas një kompjuteri dhe që kishte një  
25 telefon satelitor.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 32

1 Dhe një tjetër gjë e rëndësishme, e cila do të duhet të  
2 sillet në vëmendje, është fakti që bëhet fjalë për një dhomë  
3 që kishte pamjen e një zyre gjë e cila u përshkrua dhe nga  
4 Hadri, po gjithashtu edhe përkon me dëshminë e dhënë nga  
5 dëshmitarët e tjerë.

6 Viktimat gjithashtu përshkruan që ishin dërguar në katin  
7 e epërm dhe në katin e poshtëm. Ata merreshin në pyetje dhe  
8 torturoheshin dhe ndërmjet metodave të tjera, goditja me rrymë  
9 përdorej përmes një kutie e cila ju lidhej atyre në këmbë.

10 Pra, Hadri jo vetëm e konfirmoi këtë gjë, pra, konfirmoi  
11 faktin që ekzistonte kjo dhomë, por gjithashtu, që kishte  
12 rrymë elektrike në të cilën furnizohej kompleksi. Pra,  
13 dëshmitari Canolli po ashtu konfirmon faktin e përdorimit të  
14 baterive në kompleks për ta furnizuar atë me energji elektrike  
15 dhe për të pasur ndriçim. Një tjetër detaj i vogël i cili  
16 konfirmon dëshminë e Dëshmitarit 3593 që rikujton që kishte  
17 dritë që funksiononte me anë të baterive në vendin e ndalimit.  
18 Dhe këto janë shembuj të shkurtër të cilat mbështesin apo  
19 konfirmojnë çështjen e Mbrojtjes dhe që shkojnë në të njëjtin  
20 drejtim me dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e tjerë.

21 Dëshmitarët e Mbrojtjes, të cilët thuhet të gjithë kanë qenë  
22 pjesë e njësitit BIA vetë, forcojnë atë çfarë kanë thënë  
23 viktimat dhe nuk e cenojnë në fakt dëshminë e tyre. Sipas  
24 pikëpamjes tonë, çështja e Mbrojtjes nuk është bindëse.

25 Pra, ndërkohë më duhet të them që shpresa e viktimave që



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 33

1 ndjekja penale e të akuzuarit është e vetmja gjë që i mban ata  
2 gjallë. Shkurtimisht më lejoni që të bëj disa komente shumë të  
3 shkurtra të cilat kanë të bëjnë me dënimin për të akuzuarin.

4 Vrasja dhe tortura janë ndërmjet krimeve më të rënda që  
5 ekzistojnë. Ajo çfarë viktimat dëshirojnë që të shikojnë me  
6 sytë e tyre është që i akuzuari të marrë një dënim të drejtë  
7 që reflekton shtrirjen e përgjegjësisë së tij penale dhe unë  
8 mund të pasqyroj vetëm konstatimet e hollësishme dhe e  
9 mbështes plotësisht atë çfarë konstatoi në hollësi Prokuroria.

10 Një prej gjërave që doli tepër në pah është fakti që i  
11 akuzuari kishte përgjegjësi konkrete si komandant për të  
12 siguruar përmbushjen me rregullat e luftës. Ai ishte, në fakt,  
13 në të kundërtën pjesë aktive e kryerjes së veprave të luftës  
14 dhe krimeve të luftës dhe për këtë arsye duhet të mbajë  
15 përgjegjësi.

16 Krimet në vetvete shkatërrojnë jo vetëm jetën e viktimës  
17 së vrasjes, por vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të kenë ndikim  
18 mbi viktimat e mbijetuara. Krimet shkatërrojnë jetët private  
19 dhe kanë pasur ndikim dhe vazhdojnë edhe sot kësaj dite të  
20 kenë ndikim mbi shëndetin e viktimave. Masa e dëmtimit të  
21 shkaktuar është e jashtëzakonshme. Ajo është përcaktuar dhe  
22 është parashtruar në hollësi në këtë çështje dhe kemi dëgjuar  
23 të gjithë për brutalitetin dhe pikën deri ku ka shkuar një  
24 vuajtje e tillë. Dhe duke marrë parasysh këtë situatë Trupi  
25 Gjykues duhet të marrë parasysh faktorët rëndues në dënimin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 34

1 të akuzuarit.

2 Megjithatë viktimat nuk kërkojnë një gjatësi konkrete të  
3 dënimit për të akuzuarin. Por, ata dëshirojnë që të shikojnë  
4 që të pranohet dhe të reflektohet vuajtja e tyre në dënimin që  
5 do t'i jepet me të drejtë të akuzuarit.

6 Ky është fundi i parashtrimit tim.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, avokate.

9 Është ora 10.35.

10 Avokati i Mbrojtjes, propozoj që tani ta ndërpresim  
11 seancën në mënyrë të tillë që të keni pak më tepër kohë për të  
12 parë edhe njëherë parashtrimet e bëra nga Avokatja e Viktimave  
13 dhe për të rishikuar parashtrimin tuaj, domethënë. Dhe  
14 planifikoj që seanca të vazhdojë përsëri në orën 11.30. Jeni  
15 dakord me këtë propozim?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Pa diskutim, e nderuar Gjykatë.

17 Jemi gati që tani, megjithatë është në rregull.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
19 rregull.

20 Do të vazhdojmë në orën 11.30.

21 Seanca ndërpritet këtu.

22 --- Pauza fillon në orën 10.38

23 --- Seanca rifillon në orën 11.37

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
25 se erdhët. Tani do të vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 35

1 Mbrojtësi i Z. Mustafa.

2 Përpara se sa t'ju jap fjalën, i nderuar Mbrojtës, dua  
3 t'ju kujtoj se çfarëdo që të shfaqni në sallën e gjyqit për  
4 publikun, mund të përdoret vetëm nga Trupi Gjykses në qoftë se  
5 është paraqitur përpara afatit për mbylljen e procedurës  
6 provuese në përputhje me rregullin 134 të Rregullores së  
7 Procedurës dhe Provave.

8 E keni fjalën ju tani.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar  
10 Gjykatëse.

11 Në aktakuzën ndaj Salih Mustafës, ZPS-ja trajtoi të  
12 ashtuqajturën elementët kontekstual të pretendimeve kundër z.  
13 Mustafa. Pretendohet në paragrafin 5 që BIA përbehej nga  
14 mesatarisht 500 deri në 600 ushtarë të cilët kryesisht  
15 operonin në zonat urbane. Kjo pretendon se njësitë BIA  
16 funksiononte në kompleksin në Zllash dhe pretendohet  
17 gjithashtu që BIA ka përdorur këtë kompleks si shtëpi të  
18 sigurt si dhe një vend për të bërë pyetje dhe për ndalim.

19 Mbrojtja, së pari, do të dojë që të cekte terminologjinë  
20 e përdorur në këtë pjesë të aktakuzës, rreth 500 ose 600  
21 ushtarë. Për çfarë bëhet fjalë këtu faktikisht? Njerëzit, të  
22 cilët kanë punuar me UÇK-në, mund të mendojnë se këta ishin  
23 ushtarë. Por, në rastin e BIA-s kjo nuk mund të jetë më larg  
24 nga e vërteta.

25 Nuk ka asnjë dokumentacion sa i takon njerëzve që ishin

1 pjesë e BIA-s. Nuk kishte asnjë regjistrim dhe nuk kishte  
2 asnjë lloj trajnimit. Nuk kishte as grada, as uniforma dhe nuk  
3 kishte një strukturë komanduese. Njerëzit ishin të angazhuar  
4 për të çliruar vendin e tyre prej njerit prej regjimeve më  
5 shtypëse në historinë e kohëve të fundit. Sundimi serb i  
6 popullit të Kosovës i bën shumë njerëz që të mbështesin në një  
7 mënyrë apo në një mënyrë tjetër luftën për çlirim dhe për  
8 vetëvendosje.

9 Në gjykatë ne kemi dëgjuar shumë njerëz të cilët thanë që  
10 i përkisnin UÇK-së ndonjëherë dhe që ishin pjesë e BIA-s.  
11 Askush prej këtyre personave që kanë thënë që i përkisnin BIA-  
12 s nuk ka marrë asnjë formë trajnimit, nuk kishin asnjë lloj  
13 rangu. Nuk kishin asnjë lloj shenje dalluese të posaçme apo  
14 nuk ishin në një listë si pjesëtarë të BIA-s.

15 Në çështjen që jemi, ne kemi dëgjuar versione nga  
16 Barileva ose nga vende të tjera. Ishin persona që ishin të  
17 angazhuar për çlirimin e Kosovës, persona të cilët në mënyrë  
18 vullnetare kanë dhënë kontributin e tyre për çfarëdo lloj  
19 gjëje që mund të bënin në mënyrë të tillë që Kosova  
20 eventualisht t'ia dilte që të vetëçlironte. Për pasojë,  
21 terminologjia "ushtarë" për njerëzit që ose ishin ose e  
22 mendonin veten e tyre si pjesë e BIA-s, nuk është e saktë.  
23 Këta persona ishin qytetarë që kanë ndihmuar në përpjekjet e  
24 luftës në vetvete, por nuk kanë luajtur asnjë lloj roli  
25 ushtarak.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 37

1 Sa i takon UÇK-së, ne në fakt mund të themi se, edhe  
2 ndërkohë që personat ishin vullnetarë, ajo si strukturë dukej  
3 goxha më tepër sesi një organizatë ushtarake. Ishin krijuar  
4 brigadat, ishin përcaktuar zonat e funksionimit të tyre në  
5 kuadrin e të cilave funksiononin brigadat përkatëse. Brigadat  
6 operonin në shumë zona dhe njëra prej këtyre zonave ishte zona  
7 e Gollakut dhe në fakt njëra prej tyre ishte dhe zona e  
8 Zllashit.

9 BIA ka funksionuar vetëm në zonat urbane. Qytetarët i  
10 përdornin shtëpitë e tyre ose i linin shtëpitë e tyre të  
11 përdorshin nga persona të tjerë në mënyrë të tillë që mund të  
12 shikoheshin lëvizjet e trupave, të automjeteve, të automjeteve  
13 ushtarake nga forcat e armatosura serbe. Ata e transmetonin  
14 informacionin dhe ky informacion ishte i dobishëm për atë  
15 çfarë mund të ndodhte në një zonë të caktuar. Është kjo lloj  
16 mbledhjeje informacioni që ishte e nevojshme në mënyrë të  
17 tillë që të mund të dihej se çfarë bënin forcat e armikut ose  
18 në qoftë se ato po planifikonin ndonjë operacion.

19 Njerëzit e BIA-s nuk ishin të disiplinuar. Nuk kanë marrë  
20 ndonjë veprim sa i takon forcave serbe. Ata nuk kishin  
21 kurrfarë lidhjeje me brigadat. Brigadat nuk kishin kontroll  
22 mbi personat e BIA-s. BIA nuk kishte kontroll mbi njerëzit që  
23 ishin pjesë e brigadës. Ky ishte fakti, kaq e thjeshtë është.

24 Është një keqkuptim i plotë që BIA operonte në Zllash.  
25 Nuk ishte kështu në fakt. Ndoshta njerëz nga BIA mund të kenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 38

1 qenë të pranishëm atje, por ata në asnjë lloj mënyre nuk  
2 kishin kontroll mbi asgjë në Zllash. BIA nuk ka funksionuar në  
3 asnjë zonë të veçantë të Zllashit. BIA nuk kishte të bënte me  
4 asgjë atje. Nuk kishte asgjë që kërkonte nevojën e posaçme të  
5 tyre atje. Shkurtimisht, BIA nuk kishte asnjë lloj operacioni  
6 të kryer në Zllash.

7 Zona konkrete që është përshkruar në të gjithë çështjen  
8 është kompleksi, që do të thotë një grup i vogël strukturash.  
9 Këto struktura gjenden në një kodër dhe janë diskutuar me  
10 shumë prej dëshmitarëve të cilët kanë ardhur për të dhënë  
11 dëshminë e tyre këtu, në Hagë. Ai vend ishte një vend që ishte  
12 në pronësi të familjes Krasniqi. Kjo familje i dha UÇK-së  
13 mundësinë për ta përdorur këtë vend.

14 Në fakt, njerëzit nga BIA e përdornin këtë vend.  
15 Përdorimi ishte që të çlodheshin pas aktiviteteve të tyre në  
16 Prishtinë. Ndërkohë që ata nuk kanë pasur asnjë aktivitet  
17 specifik, qoftë në Zllash apo qoftë edhe në zonën e Gollakut.  
18 Z. Mustafa e quajti këtë vend një shtëpi të sigurt, një vend  
19 ku njerëzit mund të qëndronin për ca kohë dhe pastaj të  
20 largoheshin dhe të shkonin të merreshin me aktivitete të tjera  
21 që mund të ishin të nevojshme.

22 I tërë nocioni i këtij kompleksi që përdorej si bazë për  
23 BIA-n është tërësisht i gabuar. Njerëzit e BIA-s nuk kishin  
24 asnjëfarë pushteti atje. I gjithë kompleksi është përdorur si  
25 një vend i sigurt për refugjatët, pra për personat e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 39

1 zhvendosur brendapërbrenda vendit që vinin nga zona të tjera  
2 dhe të cilët mund të qëndronin atje të sigurt. Shumë  
3 dëshmitarë kanë folur rreth kësaj dhe këtë e kemi cekur  
4 gjithashtu edhe në dosjen përfundimtare të kësaj çështje.

5 Asnjë prej njerëzve që kanë qëndruar në Zllash nuk ka  
6 thënë që BIA operonte apo e drejtonte këtë kompleks ose ka  
7 thënë që ishte vetëm BIA që kishte monopol të plotë mbi këtë  
8 grup strukturash apo ndërtesash. Këtë temë do ta cekim edhe në  
9 një fazë të mëvonshme, por pretendimet që BIA do të përdornin  
10 një ndërtesë të caktuar për qëllimet e marrjes në pyetje apo  
11 për qëllimet e ndalimit, është thjesht e rreme.

12 Dua t'i kthehem edhe njëherë pretendimeve që janë në  
13 aktakuzë.

14 Njerëzit e BIA-s nuk kanë qenë në asnjë mënyrë ushtarë.  
15 Ata nuk kishin asnjë lloj trajnimi ushtarak apo jo-ushtarak si  
16 ushtarë. Ata nuk kishin trajnim jo-ushtarak në kuptimin taktik  
17 apo logjistik. Dhe nuk kishin asnjë lloj misioni që lidhej me  
18 luftimet. Njerëzit, personat nga brigadat ishin personat që  
19 kishin funksione dhe detyra të tilla dhe ekzistonte një  
20 strukturë e qartë komande. Personat e BIA-s nuk ishin pjesë e  
21 asnjë komande dhe të asnjë brigade. Ishte një njësit tërësisht  
22 i veçantë dhe me siguri ata kanë ndihmuar përpjekjet e luftës  
23 në tërësi.

24 Të bën përshtypje se pse për shembull, njerëzit nga BIA  
25 do t'i ndalonin njerëzit ose pse njerëzit e BIA-s do t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 40

1 merrnin në pyetje njerëzit? Ç'ju duhej atyre për të mbledhur  
2 informacion nga qytetarët e thjeshtë? Kjo është një pyetje e  
3 rëndësishme për të marrë përgjigje dhe duhet që dikush të ketë  
4 një qëllim për t'u bërë gjëra të tilla njerëzve. Çfarë  
5 informacioni të mundshëm mund të kishin njerëzit, personat të  
6 cilët pretendojnë që janë ndaluar, çfarë lloj informacioni  
7 mund t'i jepnin ata BIA-s?

8 Nuk ka pasur asnjë rast të regjistruar ku njësitet e  
9 brigadave të UÇK-së kanë funksionuar në bashkëpunim me njëri-  
10 tjetrin në mënyrë që të mund të arrihej një lloj objektiv  
11 konkret. Pra, thjesht pretendohet që njerëzit e BIA-s kanë  
12 ndërmarrë një veprim të tillë dhe ky pretendim arrin shumë  
13 larg. BIA në vetvete nuk ka operacione të përbashkëta apo  
14 aktivitete të përbashkëta as me policinë, as me rojet e asnjë  
15 lloji. Kështu që pse, për çfarë arsye anëtarët e BIA-s,  
16 ushtarët e UÇK-së, policia ose policia ushtarake do të punonin  
17 në mënyrë të përbashkët me qëllimin e përbashkët për të marrë  
18 në pyetje dhe keqtrajtuar njerëzit dhe pse do ta bënin një gjë  
19 të tillë në mënyrë të menjëhershme në periudhën e aktakuzës  
20 nga data 1 deri më datë 19 prill 1999?

21 Mbrojtja dëshiron ta bëjë të qartë se Salih Mustafa dhe  
22 asnjë person tjetër i BIA-s, as vetëm dhe as në mënyrë të  
23 përbashkët me ushtarë të tjerë të UÇK-së, me policë, policë  
24 ushtarakë apo për ndonjë qëllim të përbashkët, nuk kanë pasur  
25 si qëllim që të ndalojnë të keqtrajtojnë apo të trajtojnë në



1 mënyrë mizore të torturojnë apo të vrasin ndokënd. Salih  
2 Mustafa nuk ka pasur asnjë synim për kryerjen e këtyre krimeve  
3 të pretenduara dhe këtë gjë nuk e ka pasur si synim dhe askush  
4 tjetër.

5 Në fakt, ata thjesht nuk kanë kryer asnjë prej këtyre  
6 krimeve të pretenduar.

7 Nuk ka pasur asgjë të tillë si për shembull ndërmarrje  
8 kriminale e përbashkët ku Salih Mustafa ose anëtarët e BIA-s,  
9 kanë luajtur ndonjë rol për kryerjen e krimeve të pretenduara  
10 siç ato jepen në aktakuzë. Z. Mustafa nuk ka marrë pjesë në  
11 asnjë ndërmarrje kriminale të përbashkët, pavarësisht nga  
12 përbërja e një ndërmarrje të tillë se çfarë pamje mund të ketë  
13 pasur ajo apo çfarë [e pakuptueshme] mund të ketë ekzistuar.  
14 Z. Mustafa i rrëzon me vendosmëri të gjitha akuzat.

15 Z. Mustafa nuk kishte absolutisht asnjë lloj njohurie për  
16 krimet të cilat pretendohen në aktakuzë. Në periudhën nga data  
17 1 deri më 19 prill 1999, z. Mustafa ndoshta mund të ketë qenë  
18 pak herë në Zllash, në kompleks. Ai nuk ka ndaluar, nuk ka  
19 marrë në pyetje, nuk ka keqtrajtuar, nuk ka torturuar askënd  
20 asnjëherë në atë vend. Ai gjithashtu nuk ka urdhëruar askënd  
21 tjetër për ta bërë një gjë të tillë. Ai po ashtu, nuk ka  
22 kontrolluar asnjë prej këtyre veprimeve të pretenduara që mund  
23 të jenë ndërmarrë nga të tjerë. Nuk ka asnjë të dhënë, nuk ka  
24 asnjë provë që ai ka pasur dijeni se gjëra të tilla kanë  
25 ndodhur dhe ai vetë nuk ka parë me sytë e vet asgjë të tillë

1 të ketë ndodhur.

2 Z. Mustafa nuk ka vrarë asnjëherë askënd dhe nuk ka  
3 urdhëruar asnjëherë vrasjen e dikujt. Ai nuk e ka bërë askënd  
4 objekt torture ose nuk ka urdhëruar asnjëherë që të torturohet  
5 dikush. Z. Mustafa nuk ka qenë asnjëherë në dijeni të gjërave  
6 të tilla.

7 Nuk ka prova që ka ndonjë lidhje ose ka ndonjë  
8 marrëdhënie ndërmjet z. Mustafa dhe ushtarëve të UÇK-së me  
9 pseudonime të tilla si Tabuti, Ilmi Vela, Bimi, Dardani ose  
10 Afrimi, lidhur me kryerjen e këtyre krimeve, në qoftë se këto  
11 krime janë kryer nga ndonjëri prej këtyre individëve  
12 ndonjëherë. Bimi e mohoi këtë vetë. Të tjerët nuk janë gjetur  
13 asnjëherë apo nuk janë intervistuar asnjëherë. Dhe nuk ka  
14 asnjë provë që këta persona në kohën e aktakuzës kanë qenë të  
15 pranishëm në kompleks. Ata, madje, as nuk janë identifikuar.

16 Z. Mustafa vetë, dhe as njerëzit e tjerë nga BIA, nuk  
17 kanë pasur asnjë pushtet mbi kompleksin, strukturat, njerëzit  
18 që kanë qenë të pranishëm atje ose gjërave që mund të kenë  
19 ndodhur atje. Nuk ka asnjë lloj prove se z. Mustafa kishte  
20 ndonjë mjet të disponueshëm për të, të cilin ai do ta përdorte  
21 për të urdhëruar njerëzit për të kryer krimet e pretenduara në  
22 mungesë të tij.

23 Fjala BIA është përmendur shumë herë në Aktakuzën e  
24 Konfirmuar. Në qoftë se do të shikojmë dëshmitarin 1679, çfarë  
25 tha ky dëshmitar lidhur me BIA-n? Atij iu bë një pyetje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 43

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 "A ke dëgjuar ndonjëherë për BIA-n"?

5 Dhe ai iu përgjigj:

6 "Pas luftës, unë kam parë këto inicialet të shkruara në  
7 mure të shtëpisë" e kështu me radhë.

8 Mbrojtja dëshiron që të flasë rreth një prej vendeve më  
9 të përgjithshme që ZPS-ja e quan kompleksin e ndalimit në  
10 Zllash.

11 Dëshmitari 3593 thotë që ka qenë në një vend në Zllash në  
12 një vend që ai nuk e njihte, 7 deri në 8 km larg vendit nga ku  
13 ishte marrë. Deri në atë moment ai ishte dërguar në stallën e  
14 parë dhe kishte një thes në kokë. Nga momenti që kishte këtë  
15 thesin në kokë deri kur u dërgua në stallën e parë, ky vendi i  
16 dytë nuk ishte më tepër se sa 5 metra në madhësi. Ai tha që ka  
17 kaluar atje rreth një orë dhe pastaj u dërgua në një stallë të  
18 dytë. Kjo stalla e dytë ishte e mbushur me diçka.

19 Kur u dërgua në stallën e dytë, serish atij iu vu një  
20 thes në kokë. Ndërkohë stalla e dytë ishte 5 ose 6 metra larg  
21 stallës së parë. Ditën e nesërme ai u dërgua në një tjetër  
22 stallë së bashku me viktimat e pretenduara të vrasjes në këtë  
23 çështje dhe ky vend ishte rreth 15 deri 20 metra larg. Edhe  
24 kësaj radhe një thes i ishte vënë në kokë. Për procesverbal,  
25 këto janë faqe të cilat mund të gjenden në procesverbalin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 44

1 transkriptin e datës 20 shtator, faqe 402, 403, 467 [sipas  
2 përkthimit].

3 Pas lirimit, ai thotë që është liruar me uniformë dhe me  
4 veshje civile [sipas përkthimit]. Ai thotë që:

5 "Ndërtesat nuk e di se ku ishin, në ndërtesën 1, 2 apo 3.  
6 Ato nuk ishin larg por e di që ishin nga 50-60 metra distancë  
7 nga njëri tjetri".

8 "Ne nuk mund të flinim fare për shkak se pjesa e sipërme  
9 ishte e bërë me dru, ishte e mbuluar me dru. Ndërkohë që  
10 njerëzit rriheshin në katin e sipërm, ne nuk mund të flinim  
11 sepse kishim frikë".

12 Kjo mund të gjendet në transkriptin e datës 20 shtator  
13 2021, në faqen 476.

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 Kjo mund të gjendet në transkript të datës 22 shtator  
19 2021, faqja 608. Thjesht sa për të qartësuar çështjen në qoftë  
20 se personi kishte qenë aty më parë, dëshmitari i deklaroi ZPS-  
21 së në një intervistë [REDAKTUAR] dhe dua që  
22 ta citoj intervistën e ZPS-së, është dokumenti me ERN 100957-  
23 TR-ET, Pjesa 1, faqe 12, rreshti 12-13. Dëshmitari iu përgjigj  
24 një pyetje të Prokurorit. Pyetja është:

25 "Po për Zllashin, fshatin në përgjithësi? A ke qenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 45

1 ndonjëherë atje herë tjetër”?

2 Përgjigja është kjo:

3 “Po, ndoshta kam qenë atje 10 vite më herët. Ndoshta kam  
4 qenë atje sepse fshati është shumë i vogël”.

5 Përfundimi, të nderuar Gjykatës, sa i takon identifikimit  
6 të vendit të përgjithshëm ku është mbajtur Dëshmitari 03593  
7 është si më poshtë.

8 Indikacioni që ai kishte një thes në kokë në këto  
9 rrethana, dëshmitari në vetvete nuk mund të identifikojë  
10 vendin ku është mbajtur.

11 Së dyti, distancat që ai përmend nuk mund të lidhen në  
12 mënyrë objektive me asnjë prej strukturave të tjera në  
13 kompleksin e Zllashit. I tërë kompleksi është më pak se sa  
14 çereku i një fushe futbolli. Kompleksi është maksimumi 41  
15 metra në madhësi.

16 Dhe pika e katërt është që ai tha se nuk e di në qoftë se  
17 ka pasur 1, 2 apo 3 ndërtesa në kompleks. Nga fotografia nga  
18 ajri, është e qartë që ka pasur të paktën 9 struktura në dhe  
19 përreth kompleksit. Oborri nga njëra anë në tjetrën, nuk është  
20 më shumë se 35 metra. Ndërkohë që dëshmitari nuk është i  
21 sigurt për të thënë në qoftë se ka qenë atje më përpara,  
22 kështu që nuk është në gjendje ta dallojë nga herët e tjera,  
23 në qoftë se do të kishte qenë. Kështu që në mënyrë objektive  
24 identifikimi i tij i vendndodhjes së përgjithshme i Zllashit  
25 ose i kompleksit të ndalimit në Zllash, nuk mund të jetë i

1 saktë.

2 Mbrojtja është e mendimit që dëshmitari nuk është i  
3 besueshëm sa i takon këtij aspekti.

4 Dëshmitari 1679, dëshmitari thotë:

5 "Ne vazhduam rrugën dhe ecëm. Ne mbërritëm në një vend të  
6 cilin nuk di se si t'jua përshkruaj. Ishte hera e parë që e  
7 shihja atë vend. Ne mbërritëm në atë vend dhe ata më thanë që  
8 të ulja kokën. Unë nuk e dija se çfarë po ndodhte".

9 "Kur u afruam më tej ndaj disa godinave ishte një thes i  
10 zi, në qoftë se nuk gabohem, ata ma vunë në kokë dhe më  
11 dërguan në njërën prej ndërtesave".

12 Dëshmitari e ka deklaruar këtë më datë 4 tetor 2021 në  
13 faqen 867 të transkriptit.

14 Dhe vazhdon më tej:

15 "Ata më dërguan në të njëjtën ndërtesë, por në katin e  
16 poshtëm. Aty poshtë kishte një stallë, një ahër". Është faqja  
17 882 e të njëjtit transkript.

18 Në të njëjtën faqe:

19 "Nga çfarë mbaj mend ishte një ndërtesë e bërë me gurë  
20 dhe derën e kishte prej druri. Kishte dhe ca kashtë, kishte  
21 lagështirë".

22 Pas lirimit nga vendi i ndalimit, dëshmitari nuk tha  
23 asgjë sa i takon vendndodhjes së përgjithshme se ku ishte  
24 mbajtur ai. Dëshmitari flet për lirimin e tij më datën 5 tetor  
25 2021 dhe kjo reflektohet në transkript në faqen 867.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 47

1 Përfundimi, sa i takon identifikimit të vendndodhjes së  
2 përgjithshme ku është mbajtur Dëshmitari 01679, është si  
3 poshtë:

4 Një, dëshmitari në dëshminë e vet thotë që nuk e di sesi  
5 ta përshkruajë vendndodhjen e përgjithshme të vendit ku ishte  
6 i ndaluar.

7 Dy, dëshmitari deklaroi që kishte një thes mbi kokë,  
8 kështu që në këto rrethana ai nuk mund të identifikojë vendin  
9 e përgjithshëm.

10 Tre, indikacionet se ndërtesa ishte bërë prej guri dhe  
11 kishte një derë prej druri, nuk janë konkrete ose nuk janë  
12 dalluese për asnjë nga shtëpitë e Gollakut.

13 Dhe se katërti, edhe pas lirimit të tij, kur nuk kishte  
14 asnjë thes në kokë, dëshmitari nuk ka thënë asgjë sa i takon  
15 vendndodhjes së përgjithshme të vendit ku ishte i ndaluar.

16 Dhe dua të shtoj po ashtu që dëshmitari ka vizatuar  
17 rrethinat vetë. Kjo jepet në dokumentin ERN 060694. Në këtë  
18 vizatim jepen 3 ndërtesa të cilat asnjëra prej të cilave nuk  
19 lidhen me njëra tjetrën.

20 Në përfundim, Mbrojtja është e mendimit që dëshmitari nuk  
21 është i besueshëm sa i takon këtij aspekti.

22 Tani Dëshmitari 3594. Është një dëshmitar i cili ishte në  
23 gjendje të bënte një përshkrim të përgjithshëm të vendit ku e  
24 kanë mbajtur të ndaluar. E ka përshkruar kur i ka bërë një  
25 pyetje Mbrojtja. Pyetja ishte:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 48

1 "Përveç kësaj shtëpie të vjetër për të cilën ti po flet,  
2 a keni vënë re ndërtesa të tjera?"

3 Dëshmitari u përgjigj:

4 "Jo, jo."

5 Dhe vazhdoi:

6 "Kur më dërguan atje nuk kam parë asgjë tjetër. Sepse  
7 shkova menjëherë drejtpërdrejtë. Nuk kam parë në të majtë,  
8 shikova vetëm në të djathtë dhe atje pashë atë shtëpi të  
9 vjetër kur hyra brenda."

10 Kjo ishte në deklaratën e 13 tetorit 2021, faqet 1174,  
11 1175 të transkriptit.

12 Dhe ai vazhdoi të përshkruante se çfarë kishte parë:

13 "Kur dola jashtë pashë që ishte një oborr i madh dhe që  
14 aty ishte një ndërtesë tjetër që ishte, pak më duket si e  
15 ngjitur me këtë oborr. Pashë këtë hapësirë dhe pashë që ishin  
16 dy shtëpi në këtë kompleks. Nuk di se kush ishin pronarët e  
17 shtëpisë por ishin dy shtëpi të cilat ishin përballë njëra  
18 tjetrës. Pashë dy shtëpi."

19 Në veçanti dëshmitari tha:

20 "Po të dilje nga ahuri nuk shihej asgjë për shkak të  
21 mullarit që ishte përballë ahurit. Por po të shkoje pak më  
22 tutje, pak më lart pasi ishte një zonë e ngritur, vendi ku më  
23 kanë dërguar për të më marrë në pyetje. Kur shkova në këtë  
24 zonë të ngritur pashë që ishte një zonë e rrafshët dhe aty  
25 pashë që ekzistonte një shtëpi tjetër."



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 49

1 Pyetjes se Kryegjykatëses më datë 13 tetor 2021:

2 "Bëhej fjalë për një apo dy shtëpi?"

3 Dhe dëshmitari u përgjigj:

4 "Me shtëpinë ku ndodheshim ne, në fakt bëhet fjalë për dy  
5 shtëpia."

6 Dhe këtë dëshmitari e tha më datën 13 tetor në faqen 1176  
7 dhe 1177 të transkriptit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Avokat Mbrojtës, do t'ju kërkoja që të hynim në seancë private  
10 për një çështje të cilën unë dua të ngre.

11 Znj. Asistente e Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë  
12 private?

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 jemi kthyer në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit.

15 Avokat i Mbrojtjes, ju keni fjalën.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani po vazhdoj me Dëshmitarin  
17 03594, kur pas pyetjes:

18 "Ka pasur ndonjë shtëpi apo strukturë të ngjitur apo  
19 afërsisht të ngjitur me këtë ahurin apo shtëpinë në të cilën  
20 ndodhej ahuri?"

21 Dhe dëshmitari u përgjigj:

22 "Jo, unë nuk kam parë gjë. Nuk e di."

23 Më 13 tetor 2021, faqja 1178 e transkriptit.

24 Përfundimi, të nderuar Gjykatës, për sa i përket  
25 identifikimit të vendndodhjes së përgjithshme ku është mbajtur

1 3594 është si më poshtë.

2 Dëshmitari tha se në tërësi bëhet fjalë për dy shtëpi.

3 E dyta, tha që përballë ahurit ndodhej një mullar.

4 Tre, ai tha që nuk ka parë ndonjë shtëpi apo strukturë të  
5 ngjitur apo gati ngjitur me ahurin.

6 Katër, dëshmitari mund ta shihte këtë normalisht pasi nuk  
7 kishte thes në kokë, pra ishte në gjendje të shihte me sy të  
8 lirë.

9 Dhe e fundit, vëzhgimet e tij e bëjnë të qartë që vendi  
10 ku ndodhej ai nuk mund të jetë kompleksi i Zllashit. Kompleksi  
11 i Zllashit në atë kohë përbëhej nga të paktën 9 struktura në  
12 distancë shumë të afërt njëra me tjetrën.

13 Dhe konkluzioni i përgjithshëm është që ky dëshmitar  
14 ishte në gjendje që të bënte vëzhgime, por vëzhgimet e tij e  
15 bëjnë të qartë që ai duket sikur flet për një vend të ndryshëm  
16 nga kompleksi i Zllashit. Mbrojtja është e mendimit që ky  
17 dëshmitar jep dëshmi të saktë.

18 Dëshmitari 4669, të nderuar Gjykatës. W04669 ka folur  
19 lidhur me vendndodhjen e përgjithshme të vendit ku e kanë  
20 mbajtur. Pyetjes së Kregjykatësës lidhur me atë që ka parë  
21 dëshmitari përreth kur ka dalë nga ahuri ku e kanë mbajtur,  
22 dëshmitari u përgjigj:

23 "Asgjë. Një fushë të gjelbër dhe tualetin."

24 Kështu e mbante mend dëshmitari. Dhe pyetjes së  
25 Kryegjykatësës:

1 "A keni parë ndonjë ndërtesë?"

2 Dëshmitari iu përgjigj:

3 "Jo. Vetëm atë nga e cila dola për të shkuar në tualet.

4 Në kishte ndërtesa afër asaj përreth, por ne nuk lejoheshim të

5 shikonim në të majtë apo në të djathë. Vetëm duhej të ecnim

6 drejtë dhe të ktheheshim."

7 Dhe Gjykatësja vazhdoi:

8 "Dhe ndërtesa afër asaj nga e cila po dilnit ju, për sa

9 ndërtesa bëhet fjalë?"

10 "Rreth dy apo tre, që ishin shumë afër njëra-tjetrës, që

11 pothuajse të ngjitura me njëra tjetrën. Kishte të tjera pak më

12 larg në bazë të konfiguracionit të terrenit."

13 Edhe njëherë, Kryegjykatësja pyeti përsëri për këtë

14 vendndodhje pas lirimimit të tij, në këtë rast distancën mes

15 shkollës dhe vendit ku ishte mbajtur:

16 "Unë kuptova se ju thatë se nga vendi ku ju kanë mbajtur

17 ahuri dhe vendi ku keni mbajtur trajnimin, me sa kuptoj unë

18 ajo ishte shkolla, ju thoni që bëhet fjalë për jo më shumë se

19 200 metra?"

20 Ai u përgjigj:

21 "Kjo ishte distanca afërsisht. Nuk ju them dot me

22 saktësi, por ajo ishte distanca. Për shkak se kur bëhet fjalë

23 për trajnimin dhe manovrat, ne këto i bënim jashtë në male.

24 Nuk di nëse e keni fjalën për trajnim brenda apo jashtë.

25 Sepse, siç e thashë, kemi mbajtur pjesën teorike në shkollë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 53

1 kurse jashtë në ambient të hapur kemi mbajtur trajnimin fizik.

2 Më gjithë këtë, në përgjithësi ndërtesa është në këtë  
3 distancë. Nuk ju tregoj dot me saktësi se çfarë perimetër ka  
4 pasur ky vend, por afërsisht kjo është e saktë.”

5 Dhe këtë e ka thënë më datën 11 nëntor 2021, faqe 1575  
6 dhe 1576 e transkriptit.

7 Përfundimi, të nderuar Gjykatës, për këtë dëshmitar është  
8 si më poshtë.

9 Dëshmitari nuk ka identifikuar ndonjë ndërtesë. Ai nuk ka  
10 identifikuar madje as ndërtesën në të cilën e kanë mbajtur atë  
11 vetë. Atë aty e ka sjellë Dëshmitari 4600, i cili po kështu ka  
12 sjellë edhe viktimën e pretenduar të vrasjes së kësaj çështje.  
13 Ai nuk ka dhënë një përshkrim për strukturat e tjera që ka  
14 parë, të cilat ishin të ngjitura apo afërsisht të ngjitura me  
15 atë në të cilën ku mbahej. Foli për një maksimum prej tre  
16 ndërtesash që ishin shumë afër njëra tjetrës.

17 Dhe pika e fundit. Ndërtesa ku e kanë mbajtur nuk ishte  
18 më larg se 200 metra nga shkolla ku ka bërë trajnimin.

19 Dhe përfundimi ynë i përgjithshëm, të nderuar Gjykatës,  
20 është që ky dëshmitar nuk ka pasur në kokë ndonjë thes dhe ka  
21 qenë në gjendje të shohë me sy të lirë. Fakti që ai tregon që  
22 ndërtesa ishte vetëm 200 metra larg shkollës, të çon në  
23 përfundimin që këtu nuk bëhet fjalë për kompleksin e Zllashit.  
24 Kompleksi i Zllashit është të paktën 20 minuta apo më shumë në  
25 këmbë nga shkolla. Dëshmitari këtu i referohet një vendi

1 tjetër të ndryshëm nga kompleksi i Zllashit. Kompleksi i  
2 Zllashit ka 9 struktura të tjera, pra dëshmitari këtu flet për  
3 një vend tjetër.

4 Dëshmitarët e Mbrojtjes, të paktën pesë prej tyre Hadri,  
5 Canolli, Krasniqi, Ajeti dhe Humolli, që të gjithë kanë qenë  
6 në gjendje të përshkruajnë vendndodhjen e përgjithshme të  
7 kompleksit të Zllashit që përputhet me fotografitë ajrore që  
8 janë pjesë e kësaj çështjeje.

9 Një tjetër çështje është rrethimi, gardhi. Dëshmitari  
10 3593 nuk tha asgjë në përgjithësi lidhur me vendndodhjen dhe  
11 as për gardhin që mund të kishte qenë përreth kompleksit.

12 1679 nuk tha asgjë në këtë temë.

13 3594 atëherë. Ai tha se nuk i kujtohej. Tha se nuk  
14 mendonte. Nuk kishte parë. E citoj:

15 "Po të kishte ekzistuar, ndoshta pas shtëpisë. Në anën e  
16 kundër të shtëpisë. Pra, pas shtëpisë. Por përpara nuk kam  
17 vërejtur gjë."

18 13 tetor 2021, faqe 1181 e transkriptit.

19 Në fund, 4669, të nderuar Gjykatës, në pyetjen e bërë nga  
20 Kryegjykatësja:

21 "A ka pasur në atë vend ku ju kanë ndaluar, a ka pasur  
22 një gardh përreth atij vendi?"

23 Dëshmitari u përgjigj:

24 "Gardh?" Me pikëpyetje. "Ndoshta ka pasur pak më larg,  
25 por jo në afërsi të vendit ku ishim ne. Ishte një pjesë e

1 mbetur e një gardhi. Zakonisht gardhi përbëhet me shkopinj, me  
2 sa kuptoj unë.”

3 Pyetja:

4 “A ka pasur gardh apo jo?”

5 “Jo, ajo që mendoni ju” - u përgjigj dëshmitari. “Ka  
6 pasur një pjesë të vogël por shumë larg nga vendi ku isha unë,  
7 rreth 30 apo 40 metra tutje. Kështu më kujtohet.”

8 Deklaratë e 11 nëntorit, faqja 1546 e transkriptit.

9 Dhe përfundimi i përgjithshëm për këtë dëshmitar është që  
10 asnjëri nga këta dëshmitarët nuk kanë thënë që ka pasur gardh  
11 përreth kompleksit të Zllashit. Vetëm një dëshmitar flet për  
12 një gardh por thotë, “Jo ai që mendoni ju”. Nga dëshmitë e  
13 dëshmitarëve të ZPS-së, nuk mund të nxirret asnjë konkluzion  
14 lidhur me ekzistencën e një gardhi përreth kompleksit të  
15 Zllashit.

16 Nga ana tjetër, dëshmitarët e Mbrojtjes në mënyrë të  
17 përsëritur kanë thënë që ka qenë një pjesë e hapur pa gardh.

18 Dëshmitari 4600. Dëshmitari 4600, i cili thuhet që e ka  
19 dërguar të ashtuquajtur viktimë të vrasjes në këtë çështje tek  
20 ky kompleks, tha se nuk i kujtohet që të ketë pasur gardh.

21 Dëshmitari e tha këtë më datën 19 janar 2022, faqe 2049 e  
22 transkriptit.

23 ZPS-ja ka vërejtur që dëshmitari ka dhënë një variant të  
24 ndryshëm nga deklarata e tij e mëparshme e [REDAKTUAR].

25 E nderuar Gjykatëse, do të dëshiroj që të kalojmë në

Dhoma e Specializuarë të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbysëse (Seancë private)

Faqe 56

1 seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Sekretaria, a mund të kalojmë në seancë private?

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 jemi në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
14 Avokat i Mbrojtjes, mund ta lexoni atë pjesë të deklaratës me  
15 qëllim që kjo seancë të jetë publike, sa të jetë e mundur.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta lexoj, të nderuar Gjykatës.  
17 Po.

18 Po e filloj edhe njëherë.

19 "A ju kujtohet që keni thënë që ka pasur një gardh nga  
20 njëra anë e perimetrit të këtij kompleksi"?

21 Dhe ai u përgjigj:

22 "Çdo shtëpi është e rrethuar me një gardh apo një pjesë e  
23 oborrit të saj. Nuk e di se sa pjesë kanë qenë të rrethuara me  
24 gard. Por shtëpia jo. Nuk kishte familje që jetonte aty dhe  
25 nuk i kam kushtuar shumë vëmendje rrethimit të saj apo të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 58

1 ndonjë ndërtesë apo të ndonjë gardhi. Ndoshta ka pasur një  
2 pjesë gardhi aty. Ndoshta ka qenë dhe është djegur. Për mua  
3 nuk është e rëndësishme. Ndoshta është e rëndësishme për ju,  
4 por për mua nuk ka ndonjë rëndësi.”

5 Data 19 janar 2022, faqja 2050 e transkriptit, të nderuar  
6 Gjykatës.

7 Përfundimi i përgjithshëm për këtë dëshmitar për sa i  
8 përket kësaj, është që ai nuk arrin në ndonjë përfundim të  
9 plotë lidhur me ekzistencën e një gardhi rreth oborrit dhe nuk  
10 mund të nxirret ndonjë përfundim i plotë lidhur me dëshminë e  
11 tij.

12 Por, për sa i përket dëshmitarëve të Mbrojtjes, të paktën  
13 pesë prej tyre Hadri, Canolli, Krasniqi, Ajeti dhe Humolli, të  
14 gjithë kanë përshkruar në mënyrë të përgjithshme kompleksin e  
15 Zllashit. E kanë përshkruar atë si një zonë të hapur. Asnjëri  
16 prej tyre nuk ka përmendur ndonjë gardh, ndonjë portë apo derë  
17 përreth kompleksit ku të hyhej këtu brenda hapësirës së tij.

18 Tani po flas për oborrin, të nderuar Gjykatës. Dhe në  
19 këtë drejtim dua t'i kërkoj Sekretarisë që të vendosë në ekran  
20 DSM 00436. Është një fotografi që e kemi parë disa herë, të  
21 nderuar Gjykatës. Dhe kjo është fotografia ajrore.

22 Ndoshta mund ta zmadhojmë pak. Faleminderit.

23 Dhe tani REG00013.

24 Faleminderit Asistentja e Gjykatës.

25 Dhe këtu shohim të njëjtën fotografi ajrore. Edhe këtë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 59

1 kemi parë më parë, me të gjitha strukturat ekzistuese që duken  
2 në atë zonë. Këto fotografi më kujtohen janë marrë në vitin  
3 2006. Jo fotografite ajrore, por ajo që ndodhet si pjesë e  
4 çështjes për sa i përket kompleksit të Zllashit.

5 Tjetër që dua të paraqesim në ekran, të nderuar Gjykatës,  
6 është një fotografi me shifrën DSM00412. Dhe ndoshta mund t'i  
7 vendosim të dyja ngjitur njëra me tjetrën. I kërkoj ndjesë  
8 Sekretarisë së Gjykatës me qëllim që mund t'i shohim të dyja  
9 krah për krah.

10 Tani që i kemi ngjitur njëra me tjetrën pala Mbrojtëse e  
11 ka rikrijuar këtë zonë në përmasën 3 dimensionale për të parë  
12 më mirë se cilat ishin strukturat siç mund të kenë ekzistuar  
13 në atë kohë.

14 Të nderuar Gjykatës, do t'i kërkoja Sekretarisë që të  
15 vendosim dy diapozitiva të tjera, DSM00412.

16 Është e saktë? Më falni, kam bërë gabim.

17 DSM00035 është numri rendor.

18 Faleminderit Sekretarisë.

19 Dhe ngjitur me të DSM00424.

20 Me këto fotografi që kam këtu dua të diskutoj oborrin.

21 Kjo është mbi bazën e matjeve që ne kemi bërë në atë vend në  
22 atë kohë dhe pastaj kemi krijuar një hartë me shkallën  
23 përkatëse. Distancat janë të përafërta, por matjet tona kanë  
24 qenë të sakta, të nderuar Gjykatës.

25 Pra, oborri. Çfarë thotë Dëshmitari 3593? Dëshmitari 3593

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 60

1 nuk tha asgjë për sa i përket vendndodhjes në përgjithësi, por  
2 atij i janë bërë pyetje lidhur me oborrin pas liritimit. ZPS-ja  
3 e pyeti:

4 "Na thatë dje që në momentin e liritimit keni parë shumë  
5 njerëz jashtë. A është e saktë?"

6 Ai u përgjigj:

7 "Ju thashë dje që kur dola në oborr pashë shumë njerëz  
8 dhe ne të gjithë donim të largoheshim sa më shpejt që të  
9 mundeshim dhe prandaj nuk kam shikuar rreth e rrotull. Nuk  
10 isha i interesuar të shikoja rreth e rrotull. Isha i  
11 shqetësuar thjesht për jetën time."

12 Data 21 shtator faqe 516 e transkriptit.

13 Më herët ne kemi cituar dëshmitarin që ka thënë që kishte  
14 parë të paktën 60 persona në oborr me rroba civile apo  
15 ushtarake. Dhe nuk ka përshkruar më tej se si dukej ky oborr.  
16 Këtë e ka thënë më 22 shtator, faqe 608 dhe 609 e  
17 transkriptit.

18 Përfundimi për këtë dëshmitar mbi oborrin është që  
19 dëshmitari nuk ka shikuar rreth e rrotull pasi nuk ishte i  
20 interesuar dhe nuk ishte në gjendje që ta përshkruante  
21 oborrin.

22 Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që pavarësisht se ai  
23 ishte në gjendje të shihte me sy të lirë, dëshmitari nuk ishte  
24 në gjendje të thoshte asgjë lidhur me oborrin. Pasi janë rreth  
25 9 ndërtesa në këtë oborr, një nga të cilët ishte në mes të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 61

1 oborrit dhe dëshmitari duhet ta kishte parë këtë ndërtesë në  
2 këtë distancë të afërt. Dhe ne si palë Mbrojtëse jemi të  
3 mendimit që dëshmitari do të jetë mbajtur në një vend tjetër.

4 Dëshmitari 1679 nuk tha asgjë lidhur me këtë çështje.

5 Dëshmitari 3594. 3594 ka përshkruar se si kishte  
6 mundësinë që të dilte në oborr pa maskë, por nuk e ka  
7 përshkruar këtë oborr. Atij i është dhënë mundësia për të  
8 shfrytëzuar tualetin jashtë ahurit ku e kanë mbajtur. Këtë e  
9 ka thënë më datën 12 tetor 2021, faqe 1074 e transkriptit.

10 Edhe njëherë për sa i përket oborrit, dëshmitari që  
11 cituam më herët tha:

12 "E pashë këtë vend. E pashë që ishin dy shtëpi brenda  
13 këtij kompleksi. Nuk di se kush ka qenë pronari i shtëpisë,  
14 por ishin dy shtëpi përballë njëra tjetrës. Kam parë dy  
15 shtëpi."

16 Dhe për të qenë të qartë, dëshmitari e ka përshkruar këtë  
17 kur po ngjitej në dhomë ku ka pasur një bisedë dhe një kafe.

18 Pas pyetjes së Kryegjykatëses:

19 "Një apo dy shtëpi?"

20 Ai u përgjigj:

21 "Në shtëpinë ku ishim ne ishin krejtësisht vetëm dy  
22 shtëpi."

23 Data 13 tetor, faqet 1176 dhe 1177 të transkriptit.

24 Dëshmitari nuk ka dhënë përshkrime të tjera, por të  
25 paktën ishte ai që ishte në gjendje të thoshte diçka pasi nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 62

1 kishte maskë.

2 Pastaj Dëshmitari 4669. Pyetjes së Kryegjykatëses lidhur  
3 me atë që dëshmitari kishte parë përreth kur ka dalë nga ahuri  
4 ku e kanë mbajtur, dëshmitari u përgjigj:

5 "Asgjë. Vetëm një fushë. Një fushë të gjelbër dhe  
6 tualetin."

7 Kështu e mbante mend dëshmitari. Dëshmitari pyetjes së  
8 bërë:

9 "A keni parë ndonjë ndërtesë"?

10 Iu përgjigj:

11 "Jo. Vetëm atë nga e cila dolëm për të shkuar në tualet.  
12 Kishte ndërtesa afër asaj përreth, por ne nuk ishim të lejuar  
13 të shihnim as në të majtë, as në të djathtë. Duhet të ecnim  
14 drejtë dhe të ktheheshim."

15 Gjykatësja vazhdoi:

16 "Dhe ndërtesa afër asaj nga ku po dilnit, për sa ndërtesa  
17 bëhej fjalë"?

18 "Dy apo tre që ishin afër njëra tjetrës, pothuajse  
19 ngjitur njëra me tjetrën. Kishte të tjera pak me larg, bazuar  
20 mbi konfiguracionin e terrenit."

21 11 nëntor, faqja 1575 dhe 1576 e transkriptit.

22 Të nderuar Gjykatës, ai tha që është larguar pa hedhur  
23 sytë mbrapa kur është liruar. Nuk i kujtohej nëse ka pasur një  
24 portë në oborr për të dalë jashtë. Por thjesht një derë në  
25 ndërtesën e ahurit. Këtë dëshmitari e ka thënë në datën 11

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 63

1 nëntor, faqe 1549 e transkriptit.

2 Përfundimi për të dy dëshmitarët 3594 dhe 4669 është si  
3 më poshtë.

4 E para, të dy dëshmitarët kanë përshkruar dy apo tre  
5 shtëpi maksimumi që kanë parë aty përreth oborrit.

6 E dyta, siç thamë edhe më herët, 03594 foli për  
7 ekzistencën e një mullari përpara ahurit.

8 Dëshmitari 03594 foli për një shtëpi të vjetër nga ana  
9 tjetër, e kundërt. Por nuk ka dhënë përshkrime të mëtejshme të  
10 oborrit.

11 Konkluzioni i përgjithshëm është si më poshtë. Me 9  
12 ndërtesa përreth oborrit, nga të cilat njëra ishte në mes të  
13 oborrit, siç e kemi parë në fotografinë e mëparshme dhe me  
14 këtë distancë të shkurtër, dëshmitarët duhet të kishin qenë në  
15 gjendje t'i identifikonin. Dhe nga përshkrimi që japin, këto  
16 dëshmitarë flasin për një vendndodhje të ndryshme.

17 Të paktën pesë dëshmitarë të Mbrojtjes Hadri, Canolli,  
18 Krasniqi, Ajeti dhe Humolli, të gjithë mundën të përshkruanin  
19 vendndodhjen e kompleksit të Zllashit. Ata e përshkruar si një  
20 zonë të hapur. Askush prej tyre nuk foli për ndonjë gardh,  
21 derë apo hyrje. Të gjithë folën ose kaluam në oborr, qëndruam  
22 në oborr. Në veçanti Dëshmitari Fatmi Humolli foli me orë me  
23 familjen pikërisht në atë oborr. Dëshmitari Humolli  
24 shprehimisht tha se foli me familjen e tij në oborr. Pikërisht  
25 në oborr midis ndërtesave që duken në fotot me numër ERN

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 64

1 DSM00119 deri në 00133, shtojca 2. Dhe ai tha se pikërisht në  
2 oborr u takua me familjen e tij sepse nuk kishte mundësi të  
3 takohet me ta gjatë. Takimi vazhdoi disa orë.

4 Dhe tani, të nderuar Gjykatës, dëshmitari tha në 4 tetor  
5 2021, faqe 915 e transkriptit.

6 Më falni, bëra gabim. Transkripti është i datës 2 shkurt,  
7 faqet 2405 dhe 2422 [sipas përkthimit] dhe transkriptin e 1  
8 shkurtit, faqe 2366.

9 Tani dua të flas për numrin e strukturave. Dhe mbase mund  
10 t'i kthehem përsëri fotos që treguan pak më parë, që ka  
11 numrin REG0013 [sipas përkthimit].

12 Numri i strukturave.

13 3593 foli për tre vende. Vendi i parë ishte kur atë e  
14 mbajtën brenda, që ishte një ahur për kafshë jo më i madh se 5  
15 metra. Dhe kjo gjendet në faqen 403 të dëshmisë së tij të 20  
16 shtatorit 2021.

17 Vendi i dytë ishte kur e tërhoqën e çuan jashtë në një  
18 vend tjetër, pesë-gjashtë metra më larg nga vendi ku u soll  
19 fillimisht. Në këtë haur të dytë ishte ku ndodhen rrahjet.  
20 Hauri i dytë ishte i mbuluar me diçka. Dhe kjo gjendet në faqe  
21 408, 20 shtator 2021.

22 Vendi i tretë ishte vendi ku e çuan, që ndodhej 15-20  
23 metra më larg. E çuan aty me viktimën e pretenduar të vrasjes.  
24 Siç u diskutua më herët, në kokë kishte një thes. Dhe kjo  
25 është në faqen 416 të datës 20 shtator 2021. Dhe në këtë



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 65

1 haurin e dytë [sipas përkthimit] u mbajt për pjesën tjetër të  
2 periudhës që u mbajt i ndaluar.

3 Ai bëri një vizatim të vendit ku e mbajtën dhe ne mund  
4 ta shohim këtë në dokumentin me numër ERN 061012 deri në  
5 06015. Do t'i kthehemi më pas temës së përshkrimit të vetë  
6 stallës, por ka rëndësi të vëmë në dukje se dëshmitari u  
7 përpoq të vizatonte vendin e ndalimit. Kur u lirua nuk tha gjë  
8 tjetër, siç e kemi diskutuar më herët.

9 Dëshmitari 1679. Ai përmendi vetëm një ndërtesë, që ishte  
10 ndërtesa ku është mbajtur. Nuk përshkroi ndonjë ndërtesë  
11 tjetër. Ai sqaroi se kur e merrnin në pyetje, e çonin në një  
12 kat mësipërm. W1679 fillimisht kur u çua në një vend, kishte  
13 një thes në kokë. Kur e morën në pyetje dhe e çuan lart,  
14 përsëri kishte një thes mbi kokë.

15 Kjo gjë nuk bëhej nëpërmjet një shkalle të brendshme, por  
16 nëpërmjet shkallëve të jashtme.

17 Dhe skica që ai vizatoi, tregoi vetëm tre shtëpi  
18 gjithsej.

19 Shkurtimisht dua që të kalojmë në seancë private.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
21 lutem, të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të  
18 hapur.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
20 keni fjalën.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Po vazhdoj aty ku e lashë.

22 Të fundit ai tha në transkript:

23 "Kaluam nëpërmjet një shkalle të jashtme, jo të  
24 brendshme."

25 Këtë e tha të hënën më 4 nëntor 2021, faqja 915 e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 68

1 transkriptit. Me fjalë të tjera dëshmitari nuk tha asgjë për  
2 ndërtesa të tjera. Foli vetëm për ndërtesën ku është mbajtur  
3 gjatë 18 ditëve të ndalimit të tij.

4 Tani, në këtë pikë dua të pyes nëse e kemi këtë fotografi  
5 në ekran? Do t'i lutesha Punonjësës së Gjykatës të na tregonte  
6 fotografinë tjetër që është SPOE00128410.

7 Ju lutem ta lini për pak çaste këtë fotografi. Dua të  
8 përmend ndërtesën. Shumë mirë, kjo është. Ta zhvendosim pak në  
9 të majtë. Atë foton aty.

10 Pra, shohim ndërtesën numër 7, strukturën numër 8 apo më  
11 mirë të them 9. Mbrojta beson se fotoja në të djathtë tregon  
12 strukturën që mban numrin 7 dhe qëndrimi ynë është që kjo  
13 struktura aty tregon numrin 7 në fotografinë në anën e majtë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që ta  
15 kuptoj më mirë.

16 Në strukturën që tregoni ju me numër 7, me numër 00013,  
17 ju thoni se në foton tjetër 128420, çatia e dëmtuar, kjo është  
18 struktura numër 7?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Dhe për ta sqaruar, në foton  
20 e djathtë mund të shohim përtej strukturës së shkatërruar dhe  
21 pemës. Dhe aty shohim diçka që duket si pamja që në anën e  
22 majtë ka numrin 9.

23 Nëse heqim foton e djathtë, ju lutem Punonjësës së  
24 Gjykatës dhe të vendosim fotografinë tjetër. Dhe për të  
25 qartësuar, është foto me numër ERN SPOE00128410. Na duhet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 69

1 fotoja 82 [sipas përkthimit], Punonjëse e Gjykatës ju lutem.

2 Nuk është 410. Ju kërkoj ndjesë, është numri ERN 00128389.

3 Për të qenë të qartë, është foto A2.

4 Ne besojmë, të nderuar Gjykatës, mendojmë dhe ky është  
5 qëndrimi ynë, se po të shohim fotografinë e majtë -- ajo foto  
6 në të djathtë është me siguri nga ajo që ka numrin 9, në anën e  
7 majtë. Pra, nënta tregon pozicionin nga ku ajo foto që  
8 përshkruhet në anën e djathtë është parë, A2. Këtë deshëm të  
9 sqaronim këtu.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që ta  
11 kuptoj mirë, numri i ndërtesës në foton e djathtë, çfarë numri  
12 ka në anën e majtë?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndërtesa e shkatërruar që duket  
14 qartë, ka numrin 7.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
16 ajo në të djathtë?

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Është 6, në anën e majtë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
19 rregull. Faleminderit.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani dua të vazhdoj me  
21 Dëshmitarin 3594. Edhe një herë po diskutojmë numrin e  
22 strukturave.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
24 minutë.

25 Çfarë doni të thoni, që ta kuptojmë, që ta kemi parasysh

1 me këto që po thoni?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Do t'i kthehem pak më vonë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse  
4 jam kureshtarë, dua të krijoj një ide të përgjithshme.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund ta them në fakt që tani.  
6 Nëse Dëshmitari 4600, siç tha, ka dërguar dikë dhe ai tha që  
7 do të kishte dorëzuar viktimën e pretenduar të vrasjes në një  
8 moment të caktuar apo në një vend të caktuar në afërsi të  
9 Zllashit. Ai e tha diku këtë. Ai foli për një vend të caktuar.  
10 Dhe ne po përpiqemi të themi, me këto që po tregojmë, se e  
11 marrë nga ajo pikë që vuri në dukje dëshmitari, do të ishte e  
12 pamundur në fakt të shiheshin shtëpitë në anën e djathtë të  
13 kompleksit.

14 Po ta shikojmë edhe njëherë strukturën në foton e fundit,  
15 ajo me gjithë ato numrat që kishin.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni  
17 nevojë për numrin?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Është i njëjti numër. Po ta  
19 zmadhojmë pak do të ishte më mirë. Zmadhojeni dhe pak ju  
20 lutem. Dhe aty duket mirë numri 9.

21 Parë nga pozicioni 9, do të ishte e pamundur, për  
22 mendimin tonë, struktura tek numri 7 e pengon pamjen e  
23 ndërtesës në krahun e djathtë. Numrin 2 sidomos, 3, 4 dhe 5.  
24 Kjo pjesë nuk duket nga ai këndvështrim. Nuk mund të duket.  
25 Dhe aty është një pjerrësi, e shohim në fotografinë 820 [sipas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 71

1 përkthimit].

2 Ju lutem, paraqiteni edhe njëherë atë foto, numër  
3 00128410. Faleminderit shumë.

4 Pra, këtu e shohim qartë që është një pjerrësirë, terren  
5 i pjerrët që zbret, që tregon se po të rrish në atë vend në  
6 atë pozicion tek 9, ndërtesa e shkatërruar, siç e shihni, ta  
7 bllokun pamjen në anën e djathtë të vendndodhjes në Zllash.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
9 mund ta përsërisni edhe njëherë shpjegimin?

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

11 Po të shohim ndërtesën e shkatërruar dhe pemën, dhe po të  
12 shikosh ndërmjet tyre, ne besojmë se shikohet pozicioni që  
13 sapo thamë 9, që e pamë në foton e mëparshme.

14 E marrë nga ai pozicion, kjo pamje është e qartë sepse  
15 shohim edhe lartësinë e ndërtesës së prishur, por shohim edhe  
16 terrenin që është i pjerrët, që ulet që bie poshtë. Këtë  
17 deshëm të vëmë në dukje.

18 Gjithsesi, personi që mund të rrinte në pozicionin 9, do  
19 ta kishte pamjen e bllokuar për shkak të faktit se qëndron ajo  
20 ndërtesa aty, që është ndërtesa numër 7.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit për sqarimin.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se keni diçka të  
24 paqartë, mund ta sqaroj. Ky është momenti më i mirë po të keni  
25 ndonjë pyetje tjetër lidhur me këtë pikë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 72

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Në qoftë se ju  
2 kuptova drejtë, po të jesh në pozicionin 9 që duket si një  
3 gardh.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, janë mbeturinat e një gardhi.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, po të jesh në pozicionin  
6 9, do të shikosh vetëm ndërtesat 10, 11 dhe 12. Këtë s'e  
7 kuptoj mirë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
9 minutë. Ta tregojmë dhe atë foton tjetër? T'i vëmë përbri  
10 njëra tjetrës që t'i kemi më të qarta.

11 Mund ta bëni edhe njëherë pyetjen.

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në qoftë se e kuptova drejtë,  
13 në qoftë se dikush vjen nga numri 9, do të shikonte ndërtesat  
14 në krahun e majtë 10, 11, 12. Por, për shkak të ndërtesës 7  
15 dhe mbase edhe të pemës, nuk do të shikonte 2, 3, 5 dhe 6.  
16 Këtë doni të thoni?

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e kuptoni drejtë. Dhe për të  
18 qenë të qartë, Dëshmitari 4600 thotë që e pa Salih Mustafën në  
19 verandë. Thotë që e ka parë në atë strukturë.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, ju po thoni që 4600 nuk  
21 kishte si ta shikonte z. Mustafa sepse sipas këtyre po thoni,  
22 z. Mustafa duhet të kishte qenë në të djathë, e jo në të  
23 majtë?

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Këtë tha Dëshmitari 4600.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 73

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë me 3594.

2 Desha të them se ky dëshmitar flet vetëm për dy shtëpi.

3 Kur i bëri pyetje Gjykatësja kryesuese:

4 "Kishte një apo dy shtëpi?"

5 Ai tha:

6 "Gjithsej kishte dy shtëpi."

7 Pastaj të vijmë përsëri tek kjo çështje, dëshmitari u  
8 pyet nëse kishte ndonjë ndërtesë tjetër, ai tha:

9 "Jo. Vetëm ajo nga e cila unë dola për të shkuar në  
10 banjë. Kishte ndërtesa rreth, por ne nuk na lejonin të  
11 shikonim, as majtas, as djathtas. Vetëm të shkonim aty ku  
12 duhet të shkonim.

13 Dy apo tre shumë pranë njëra-tjetrës, pothuajse të  
14 lidhura me njëra tjetrën, të ngjitura. Dhe kishte disa të  
15 tjera pak më larg, sipas konfiguracionit të terrenit."

16 Këtë dëshmitari e tha më 11 nëntor 2021, faqe 1542 dhe  
17 1543 të transkriptit.

18 Përfundimi i përgjithshëm në lidhje me numrin e  
19 ndërtesave të dëshmitarëve të ZPS-se 3593, 1679 dhe 3594 dhe  
20 Dëshmitarit 4669, është se të katër ata nuk mund të  
21 identifikonin dhe të përshkruanin ndërtesat rreth vendit ku  
22 ata mbaheshin. Në qoftë se ata do të ishin ndaluar në  
23 kompleksin e Zllashit me 9 struktura, disa prej tyre struktura  
24 të mëdha dhe njëra prej tyre në mes të oborrit, nuk kishte si  
25 të mos i ishin parë ato.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 74

1 Pra, ne si Mbrojtje mendojmë se ata janë mbajtur në një  
2 vend tjetër.

3 Pastaj, ndërtesa ku janë mbajtur njerëzit, hauri apo  
4 stalla.

5 3593, sipas tij, ai tha se ka ndenjtur në këto vende ku e  
6 kanë mbajtur të ndaluar. Fillimisht i kanë vënë një thes në  
7 kokë dhe pastaj e kanë vendosur në një haur ku ia hoqën  
8 thesin. Vendi 1.

9 Pastaj e çuan jashtë në një vend tjetër tek numri 2, ku  
10 filluan ta rrahin. Kjo është në faqet 406, 407 [sipas  
11 përkthimit]. Dhe së fundi, të nesërmen e kthyen përsëri tek  
12 numri 1, ku personi tjetër ishte akoma. Dhe kjo është në faqet  
13 406, 407 dhe 408.

14 Të nesërmen e çuan në një vend tjetër, vendi 3, ku u  
15 mbajt eventualisht për 18 ditë. Në këtë vend u çua bashkë me  
16 viktimën e pretenduar të vrasjes dhe aty në këtë vend të  
17 fundit, gjeti edhe 2 apo 3 të tjerë. Që i përmblodhi gjithsej  
18 5 vetë. Dhe kjo gjendet në faqen 418 dhe 419.

19 Nuk po them se si ai përshkroi vendin 1. Tha që ishte 5  
20 metra, jo më shumë se 5 metra. Dhe të gjitha këto i ka thënë  
21 më 20 shtator 2021, faqet 402, 403 [sipas përkthimit].

22 Vendi i dytë, siç përshkruhet nga ai, ishte pak më larg.  
23 Ai tha ishte një vend ku ata filluan ta rrihnin. Kishte pemë  
24 aty, lloj-lloj gjërash. Dhe pastaj iu përgjigj pyetjes së ZPS-  
25 së:

1 "Ishte mbuluar me diçka, nuk mund ta them me saktësi  
2 sepse nuk po e shihja. Ishte një vend i errët dhe nuk isha në  
3 gjendje të shikoja se kush më rrahu. Njerëzit përdornin  
4 kështu, drita herë pas here."

5 Ishte një lloj vendi, nuk kishte mure. Kishte vetëm një  
6 mbulesë mbi kokë. Nuk di gjë tjetër. Sepse mbanin si pishtar.  
7 Ishte errësirë, nuk shikoja fare."

8 Më 21 shtator, faqe 562 e transkriptit.

9 Pyetja përsëri e ZPS-së:

10 "Kishte ndonjë dritë apo dritare?"

11 Përgjigja:

12 "Jo, jo. Asgjë s'kishte."

13 Dëshmitari e tha këtë më 20 shtator, faqe 417.

14 Ky dëshmitar pastaj përshkroi vendin 2 kur e pyetën nëse  
15 kishte ndonjë ndriçim apo dritare. Pas pyetjes që i bëri  
16 Mbrojtja, ai u përgjigj duke folur për atë stallën ku e  
17 mbajtën gjatë gjithë kohës, nëse kishte ndonjë dritare, ai u  
18 përgjigj:

19 "Jo, nuk ishte e mbyllur. Kishte një çati. Ishte e hapur,  
20 nuk kishte mure por vetëm një mbulesë mbi kokë dhe nuk di gjë  
21 tjetër sepse ishte errësirë dhe nuk pashë asgjë. Asgjë fare.  
22 Nuk e di nëse kishte rrymë apo jo, por di gjë ishte errët. Nuk  
23 e shihja çatinë. Nuk më lejuan të shikoja. Nuk e pashë fare  
24 çatinë."

25 Kjo është thënë në 21 shtator, faqja 562 e transkriptit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 76

1 Pastaj ai përshkroi vendin e tretë dhe tha:

2 "Po, nuk flinim dot sepse pjesa e sipërme ishte prej  
3 druri."

4 ZPS-ja e pyeti:

5 "Doni të thoni se çatia ishte prej druri?"

6 Ai u përgjigj:

7 "Ishin dërrasa. Aty mbanin kafshë dikur, por tani  
8 përdorej si dhomë."

9 Këtë e tha më 20 shtator 2021, faqe 476.

10 Ai vizatoi një skicë. Përveç këtij dëshmitari që bëri  
11 këtë skicën që mund të shikohet tek SPOE061012, dëshmitari i  
12 shpjegoi Gjykatës kur i treguan këtë vizatim.

13 Më 21 shtator, faqja 518 e transkriptit. Më pas i treguan  
14 fotografitë e pjesës së jashtme të asaj që Mbrojtja e quan  
15 ndërtesën e odës. Do t'i kthehem kësaj, çfarë kemi parasysh me  
16 odën, këtë ndërtesën ku ishte oda. Do ta shpjegoj më vonë  
17 këtë. Se çfarë kemi parasysh kur themi ndërtesa ku ishte oda.  
18 Mund ta bëj edhe tani.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është  
20 koha për drekën. Mbase mund të gjejmë momentin e natyrshëm për  
21 t'i ndërprerë parashtrimet.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase mund ta tregojmë edhe  
23 njëherë fotografinë me ato numrat. Pastaj do të përfundojmë me  
24 këtë dëshmitar.

25 Faleminderit shumë.

1           Është ndërtesa 12, është ajo që ne e quajmë ndërtesa e  
2 odës, në këtë foton që keni përpara.

3           Përfundimi, të nderuar Gjykatës, është se dëshmitari  
4 përmes një fotografie identifikoi, dhe foto është  
5 SPOE00128392, e një ndërtese që ai e shënoi me numrin 2. Dhe  
6 numri ERN është 100967 me një njoftim zyrtar të bashkangjitur  
7 në 3 qershor. Është metoda tjetër e identifikimit që është  
8 përdorur për këtë dëshmitar.

9           Tani vijmë tek përfundimi për këtë dëshmitar dhe besoj që  
10 do të ishte një moment i natyrshëm që të bënim pushimin e  
11 drekës.

12           Nëse më lejoni, ky dëshmitar përshkroi vetëm pjesën e  
13 brendshme të një strukture, por jo pjesën e jashtme të  
14 ndërtesës. Sepse nuk mund ta shikonte këtë meqenëse kishte një  
15 thes mbi kokë.

16           Numri dy. Siç thamë më herët, Dëshmitari 03593 çdo herë  
17 foli për pjesën e brendshme të një vendi. Asnjëherë nuk foli  
18 për pjesën e jashtme.

19           Tre. Megjithatë, atij i treguan një foto të odës.

20           Katër. 3593 rrjedhimisht nuk mund të identifikojë pjesën  
21 e jashtme të ndërtesës, bazuar në një fotografi.

22           Bazuar në një skeç, është pika tjetër, që ai bëri në një  
23 skicë dhe duke e krahasuar atë me atë që ai identifikoi përmes  
24 fotos numër 2, me numër SPOE00128392. Pra, bazuar në këtë  
25 skicë që bëri ai dhe duke e krahasuar me atë të ndërtesës e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 78

1 identifikuar me numrin 2, kjo konfirmon pozicionin e Mbrojtjes  
2 se ai nuk kishte se si të bënte një përshkrim të ndërtesës nga  
3 ana e jashtme sepse e kishte kokën të mbuluar gjatë gjithë  
4 kohës nga një thes. Edhe kur është transferuar.

5 Dhe siç them, ai përshkruan vetëm pjesët e brendshme të  
6 ndërtesës.

7 Përfundimi i përgjithshëm është se ky dëshmitar nuk bëri  
8 një identifikim të besueshëm të ndërtesës në të cilën është  
9 mbajtur. Dëshmitari nuk mund të identifikonte pjesën e jashtme  
10 të një ndërtese duke qenë se nuk ka mundur të shohë ku ka  
11 shkuar, ku e kanë çuar, në vendin ku e kanë rrahur.

12 Skica dhe fotoja që i është treguar atij nuk mund të jetë  
13 e besueshme dhe nuk ka asnjë lloj vlere provuese. T'i tregoje  
14 atij një fotografi të vetme, sidomos kur vendi nuk është  
15 përshkruar kurrë nga jashtë, t'i tregosh një dëshmitari në  
16 këto rrethana një foto të vetme, është sugjestionuese dhe në  
17 këtë rast dëshmitarit duhet t'i kishin treguar shumë foto të  
18 ndërtesave të ngjashme nga të cilat ai do të kishte zgjedhur  
19 një.

20 Rrjedhimisht dëshmia e tij në këtë drejtim dhe prova mbi  
21 të cilën ZPS-ja është mbështetur, nuk është e besueshme.

22 Faleminderit shumë. Dua të përfundoj në këtë moment dhe  
23 pastaj mbas pushimit të vazhdojmë. Faleminderit shumë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
25 rifillojmë pas orës 14.00

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 79

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.05

2 --- Seanca rifillon në orën 14.30

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
4 se erdhët.

5 Të shohim të pranishmit. Shikoj që ZPS-ja është në të  
6 njëjtën përbërje që ishte sot paradite; e njëjta gjë edhe për  
7 Avokaten e Viktimave dhe shoh që edhe Mbrojtja ka të njëjtën  
8 përbërje si më përpara. Dhe z. Mustafa na ndjek nga distanca.

9 Avokat, fjala për ju.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar  
11 Gjykatës.

12 Do të vazhdojmë me diskutimet e dëshmitarëve. Dëshirojmë  
13 t'i kërkojmë Sekretares së Seancës që të shfaqë në ekran një  
14 dokument me numër identifikimi ERN REG00001 deri në 003.

15 Të nderuar Gjykatës, do vazhdojmë aty ku e lamë dhe  
16 dëshirojmë që të diskutojmë për Dëshmitarin 4600 në këtë rast.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
18 lutem ndiz mikrofonin, Avokat.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duhet të sqaroj diçka.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
21 lutem vijoni.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të flas  
23 për Dëshmitarin 4600. Duke pasur parasysh fotografinë që kemi  
24 përpara, dëshiroj që të citoj atë çfarë ka thënë dëshmitari,  
25 pra, është ajo çfarë ka thënë Dëshmitari 4600, më datë 23

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 80

1 shtator 2021. Citoj nga transkripti që është faqja 732.

2 "Po, ishim te porta", thotë dëshmitari.

3 Dhe pyetja që bëhet është kjo:

4 "Dhe mendoj se ju na e keni thënë këtë, por a mund të na  
5 e përsërisni sesa është distanca, përafërsisht, nga vendi ku  
6 ishit ju dhe vendi ku ishte komandant Cali?"

7 Përgjigjja është kjo:

8 "Siç e thashë edhe më përpara, nuk e di ekzaktësisht,  
9 ishte rreth 20 deri në 30 metra. Po nuk jam i sigurt. Po, 20  
10 deri në 30 metra."

11 Pyetja vazhdon si më poshtë:

12 "Ishte si ballkon, a po na thoni që komandant Cali  
13 qëndronte në një vend si në ballkon, në një lloj ballkoni?"

14 Dhe përgjigjja është:

15 "Po, një lloj ballkoni. Siç e thashë, ai dilte nga një  
16 dhomë dhe ky ballkon lidhte me njëra-tjetrën dy ose tre dhoma.  
17 Nuk e di sesa ishin ekzaktësisht. Po ai dilte kjo dhoma kishte  
18 një derë aty, dilte nga dera e asaj dhome dhe na  
19 përshëndeste."

20 Pyetja:

21 "A ishte më sipër ky ballkoni ku dilte zotëria apo ishte  
22 në të njëjtin nivel siç ishit dhe ju?"

23 Përgjigjja:

24 "Jo, nuk ishte. Nuk ishte shumë lart sepse ishte një zonë  
25 në kodër. Ballkoni nuk është se ishte shumë më sipër nivelit



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 81

1 të tokës dhe aty ishte Cali.”

2 Të nderuar, nuk e di në qoftë se mund t'i kërkoj  
3 Sekretares së Seancës të tregojë në ekran dokumentin me numrin  
4 e identifikimit DSM00412. Kjo është pamja 3D që ka përgatitur  
5 Mbrojtja.

6 Znj. Sekretare, nuk e di në qoftë se mund ta zmadhoni  
7 pak. Shumë faleminderit. E zmadhoni dhe pak më tepër.

8 Pra, thuhet që ai qëndronte në këtë fotografinë që e kemi  
9 të shfaqur në ekran, një nga këto fotot nga ajri që janë bërë  
10 dhe ky është dokumenti me numër identifikimi SPOE00213478.

11 Ky do të ishte konfigurimi që është bërë mbi bazën e  
12 dëshmive të marra.

13 Në qoftë se do të shkojmë tek dokumenti DSM00388, në  
14 qoftë se do ta shikojmë këtë dokument përsëri. Edhe një herë  
15 kemi pak a shumë të njëjtën pamje, të njëjtin përfaqësim dhe  
16 me të njëjtat distanca treguese të cilave iu referua  
17 dëshmitari kompleksit në Zllash në atë kohë.

18 Këtu, siç mund ta shikojmë, struktura e cila është  
19 shkatërruar, për të cilën ne folëm pak më përpara, nuk është e  
20 shfaqur në këtë pamje. Megjithatë, në qoftë se do të shkojmë  
21 në dokumentin DSM -- tani dua që të tërheq vëmendjen tuaj tek  
22 shtëpia e familjes në të djathtë. Dhe dëshiroj të bëj disa  
23 komente lidhur me të.

24 Në qoftë se do të shkojmë në dokumentin DSM00436. Ky  
25 është dokumenti. Nuk e di në qoftë se mund ta zmadhoni pak.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 82

1 Mund ta zmadhoni dhe pak më tepër dhe të shkojmë në të djathtë  
2 të pamjes.

3 Aty shikojmë pjesën në të djathtë të fotografisë. Dhe aty  
4 në të djathtë shohim ndërtesën që është në cep fare në të  
5 djathtë. Është një godinë apo ndërtesë e madhe me ndërtesën e  
6 shkatërruar të cilën ne e identifikuar në fotografinë e  
7 mëparshme. Në të djathtë, në cep, shohim një shtëpi ose të  
8 paktën një dhomë që nuk ka çati dhe është pikërisht kjo godinë  
9 kjo shtëpi që do të doja ta sillja në vëmendje të Trupit  
10 Gjykues.

11 Në qoftë se Sekretarja e Seancës mund të tregojë në ekran  
12 dokumentin DSM00392. Kjo është pamja nga sipër mbi kodrën e  
13 hartës që ka ndërtuar Mbrojtja. Dhe kjo është mënyra sesi e  
14 kemi rindërtuar këtë shtëpi mbështetur në dëshminë e Selatin  
15 Krasniqin. Sepse, siç e dimë, Selatin Krasniqi ka qenë personi  
16 që ka jetuar aty dhe familja e tij e ka pasur këtë në pronësi  
17 të vet. Dhe mbështetur në dëshminë e dhënë prej tij dhe e kemi  
18 intervistuar atë dhe kemi krijuar një hartë mbështetur në  
19 rrëfimet që ai na ka dhënë në dëshminë e tij.

20 Lidhur me këtë --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Avokat, ndërtesa e kësaj ndërtese sipas fotografisë që ju na  
23 treguat pak më përpara me numrat që ishin mbi secilin prej  
24 godinave, çfarë numri do të kishte kjo ndërtesë siç është  
25 treguar nga z. Krasniqi?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 83

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Fotografinë që ishte me numrat?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

3 Pamë atë fotografinë më përpara që kishte të gjitha numrat dhe  
4 duam të bëjmë lidhjen ndërmjet kësaj ndërtese me të gjitha  
5 numrat e fotografive që u treguan më përpara.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Është fotografia me numrat 2,  
7 3, 4 dhe 5.

8 Sikundër e diskutuam këtë ndërtesë me Selatin Krasniqin,  
9 ai na tha, na tregoi se çfarë konfiguracioni kishte kjo  
10 shtëpi. Dhe ky konfiguracion shikohet pak a shumë në  
11 dokumentin DSM00406.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Avokat, nuk e di në qoftë se është e mundur duke marrë  
14 parasysh sesa e madhe është kjo fotografi, por do preferoja që  
15 të kishim përkrah edhe fotografinë që është bërë nga ajri.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] në  
18 mënyrë që të kuptojmë pak më mirë atë çfarë po mundoheni të  
19 shpjegoni.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Dhe kjo fotografi që ju  
21 kërkoni ka edhe numrat e ndërtesave në të.

22 Znj. Sekretare, ju lutem tregoheni edhe këtë fotografi.

23 Pra, kjo godinë përbëhej nga gjithsej nga katër dhoma me  
24 përmasat që jepen në fotografi siç tregohet në të djathtë.

25 Madhësia është mbështetur në dëshminë e dhënë nga Selatin

1 Krasniqi.

2 Pra, siç mund ta shikojmë këto dhomat të gjitha dalin në  
3 një ballkon, e kanë daljen të gjitha në një ballkon dhe duket  
4 qartë që kjo është një godinë, një ndërtesë e vetme që ka një  
5 ballkon ose një verandë, sido që të mund ta quajmë, kjo është  
6 një ndërtesë në kompleks.

7 Ndërkohë, në qoftë se do të shikojmë fotografinë e  
8 fundit, që është fotografia e identifikuar si A1. Dhe që është  
9 dokumenti identifikuar si SPOE00128388.

10 Znj. Sekretare, nuk e di në qoftë se mund të na e shfaqni  
11 këtë fotografi në ekran.

12 Dhe nëse do t'i zmadhojmë këto ndërtesa, do të zmadhojmë  
13 fotografinë pikërisht në këto ndërtesa, në veçanti, duke u  
14 përqendruar tek ndërtesa në të djathtë. Mund ta zmadhojmë pak  
15 edhe më tepër, ju lutem.

16 Atëherë, pra, është qëndrimi i Mbrojtjes që në këtë  
17 ndërtesë nuk ka kurrfarë ballkoni. Dhe, për rrjedhojë, të  
18 nderuar Gjykatës, ne besojmë që Dëshmitari 4600, pavarësisht  
19 nga ato çfarë ka deklaruar, nuk mund të ketë qenë duke folur  
20 për këtë ndërtesë sepse nuk ka pasur një godinë të kësaj  
21 natyre. Dhe dua që ta përsëris edhe njëherë dëshminë e dhënë  
22 prej tij, bëhet fjalë për dëshminë e dhënë më datë 23 shtator,  
23 faqja 732 e transkriptit.

24 "Po, një lloj ballkoni. Ai dilte nga një dhomë. Siç e  
25 thashë, ky ishte një ballkon i cili lidhte tre ose katër dhoma

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 85

1 me njëra-tjetrën. Nuk e di sesa ekzaktësisht. Ai dilte nga një  
2 dhomë aty. Dhoma kishte një derë, ai dilte nga ajo derë dhe na  
3 përshëndeste ne.”

4 Dhe ai vazhdon më tej dhe thotë:

5 “Ishte pak e ngritur, a ishte pak e ngritur kjo sipërfaqe  
6 krahasimisht me aty po qëndronit ju apo jo?”

7 “Ishte pak më e ngritur, jo shumë e ngritur se ishte si  
8 zonë kodrinore. Nuk ishte shumë lart gjithsesi dhe aty  
9 qëndronte Cali.”

10 Pra, të nderuar Gjykatës, pozita, qëndrimi i Mbrojtjes  
11 është që Dëshmitari 4600, në dëshminë e vet sa i takon të  
12 parit e Calit nga pozicioni që ai përmend, dhe më duhet të  
13 them që nuk e ka thënë një herë por e ka përmendur dy herë,  
14 dhe në dëshminë e tij të mëparshme e ka bërë dhe një vizitim  
15 apo një skicë të situatës. Dhe ajo tregon që ai po shikonte  
16 nga e djathta e tij në qoftë se do nisemi nga porta.

17 Të nderuar Gjykatës, ai deklaroi në dëshminë e tij kur  
18 foli me Prokurorin në atë kohë, me z. Carney, nuk jam i sigurt  
19 në qoftë se e kam këtë dokumentin të disponueshëm tani apo jo.  
20 Po, e kam, të nderuar Gjykatës. Ai vizatoi një skicë të  
21 situatës. Të nderuar Gjykatës, ai e bëri këtë gjë ndërkohë që  
22 u intervistua më [REDAKTUAR].

23 [REDAKTUAR] në këtë skicë të vizatuar më [REDAKTUAR] ai  
24 bëri dy shënime, shënimi 1 dhe shënimi 2. Shënimi 1 është  
25 pozicioni nga porta, që e diskutuam pak më përpara, që është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 86

1 pozicioni numër 9 në hartë. Mbase mund ta shfaqim edhe një  
2 herë fotografinë për ta parë.

3 Jo, nuk është kjo. Është ajo në të majtë.

4 Dhe më pas ai gjithashtu foli lidhur me atë çfarë ai e ka  
5 shënuar si numri 2. Me numrin 2 është shënuar një godinë e  
6 cila është në të djathtën e tij. Do t'ju jap numrin e  
7 dokumentit. Bëhet fjalë për dokumentin numër 072908 deri më  
8 072914-RED1. Ky është shënimi që është bërë. Dhe numri i saktë  
9 i kësaj skice të posaçme që ka bërë, për të qenë të saktë,  
10 është dokumenti i shënuar si ERN072909.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
12 synoni që ta tregoni këtë në ekran?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
15 dëshiroja që të na shfaqej në ekran sepse do e kuptonim më  
16 mirë.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk mendojmë që e kemi numrin e  
18 provave materiale që kemi dhënë. Thjesht ju referova --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
20 të qenë e sigurtë, nuk është e qartë për mua tani mënyra sesi  
21 e përshkruani.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund të bëj ndoshta ndonjë gjë  
23 për t'ju sqaruar por së pari më lejoni t'ju shpjegoj se çfarë  
24 thotë dëshmitari.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 87

1 rregull.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Ai thotë në dëshminë e tij, që  
3 është transkripti i datës 23 shtator 2021, si më poshtë në  
4 përgjigje të pyetjes, ai thotë edhe pyetja është kjo:

5 "A e mbani mend që e keni bërë këtë vizatim gjatë  
6 intervistës së ZPS-së që u zhvillua më datë 21 janar 2020?"

7 Përgjigja:

8 "Po, e mbaj mend."

9 "Pastaj në fund, në cep në të majtë, ka një shigjetë. A  
10 mund të na thoni se çfarë është ajo?"

11 Përgjigja:

12 "Po."

13 "A mund të na thoni se çfarë reflekton kjo shigjetë?"

14 Përgjigje:

15 "Ka dy shigjeta. Një shigjetë që tregon nga rruga deri  
16 tek porta dhe tjetra që të çon brenda oborrit?"

17 Përgjigja:

18 "Besoj që është numri 1, po nuk duket sikur është  
19 shigjetë."

20 "A mund të na e thuash se çfarë është?"

21 Përgjigja, pastaj e dëshmitarit është:

22 "Jo, jo, është shigjetë."

23 "Në rregull", thotë Prokurori.

24 Prokurori vazhdon:

25 "A mund të na thuash se çfarë përfaqëson kjo skicë? Çfarë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 88

1 jeni përpjekur që të vizatoni në këtë skicë?"

2 Përgjigja është që:

3 "Unë u mundova që të shpjegoja këtu që kur vjen në të  
4 majtë të rrugës dhe kur ndalon përpara portës, kjo është ajo  
5 çfarë përshkruan shigjeta e parë. Dhe shigjeta e dytë të  
6 tregon pamjen kur ti futesh brenda dhe prandaj e kam vendosur  
7 këtë shigjetë këtu."

8 "Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë", thotë Prokurori.

9 Pra, pyetja është:

10 "Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë që e kam keqkuptuar  
11 skicën tuaj. Tani, ju shikoni atë çfarë duket numri 2. Numri 2  
12 që është diku nga qendra e skicës. A e shikoni këtë?"

13 Dhe përgjigja që jep dëshmitari është:

14 "Po."

15 Pyetja është.

16 "A mund t'i tregoni Trupit Gjykues se çfarë tregon kjo  
17 shigjetë?"

18 Përgjigja është.

19 "Kjo ishte një godinë, një ndërtesë, ndërtesë njëkatëshe  
20 e vjetër. Deri në këto rreshta dhe pastaj mund të shikoni tek  
21 skica që kishte edhe një soj si verandë aty. Dhe pastaj kishin  
22 dhoma, një, dy, tre, katër dhe të gjitha këto dhoma kishin  
23 dyer që të nxirrnin në këtë verandë."

24 "Në këtë vizatim, a përshkruhet vendi nga ku komandant  
25 Cali ju përshëndeste?"



1 Përgjigje:

2 "Po."

3 Pyetje:

4 "Dhe ku ishte ky vendi ku ju përshëndeste komandant Cali  
5 nga kjo pjesa këtu?"

6 "Nga kjo pjesa këtu."

7 "Faleminderit. Shumë mirë. Ju lutem, a mund të shënoni  
8 dhe njëherë me të njëjtin stilolaps vendin ku keni qëndruar,  
9 ndërkohë që çfarë shikonit kur ishit te porta?"

10 Do të vazhdojmë më tej. Pyetja vazhdon:

11 "Besoj që na e ke thënë, po nuk e di në qoftë se mund të  
12 na e thoni se çfarë distance ka pasur vendi nga ku qëndronit  
13 ju dhe aty ku qëndronte z. Cali?"

14 Përgjigje:

15 "Siç e thashë më përpara, nuk e di ekzaktësisht por besoj  
16 20 deri në 30 metra. Nuk jam i sigurt. Po, 20 deri në 30  
17 metra."

18 Pyetje:

19 "Tani, a ishte një lloj - a ishte ballkon? A po thoni që  
20 komandant Cali qëndronte në një ballkon ose një lloj  
21 ballkoni?"

22 Përgjigje:

23 "Po, një lloj ballkoni. Ai dilte nga një dhomë dhe siç e  
24 thashë ky ballkon bashkonte me njëra-tjetrën tre-katër dhoma.  
25 Ai nuk e mbaj mend tamam po ai kishte një dhomë aty. Dhoma

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 90

1 kishte derë dhe ai dilte nga ajo derë dhe na përshëndeste.”

2 Dhe do të përfundoj në këtë pikë me këtë dëshmitar sepse  
3 e kam lexuar pjesën tjetër të dëshmisë së tij.

4 Të nderuar Gjykatës, në përmbledhje, për të qenë të qartë  
5 lidhur me Dëshmitarin 4600 dhe për të bërë të ditur qëndrimin  
6 e Mbrojtjes nga vendi ku mund të ketë qëndruar ai, nuk ka qenë  
7 e mundur që të shikonte z. Mustafa në qoftë se z. Mustafa do  
8 të ketë qenë aty.

9 Në çdo rast, pra, kishte një strukturë që bllokonte  
10 pamjen nga vendi ku qëndronte ai, kështu që nuk do ishte e  
11 mundur për të të kishte parë z. Mustafa në qoftë se ai do të  
12 kishte qenë aty.

13 Do të vazhdojmë me dëshmitar tjetër, të nderuar Gjykatës.  
14 Është Dëshmitari 1679. Është një dëshmitar që unë do ta gjykoj  
15 në kuptimin e asaj që ai mund të shikonte ndonjë strukturë nga  
16 pika nga ku qëndronte.

17 Sipas Dëshmitarit 1679, ai foli për një stallë ose ahur  
18 ku mbahej. Ai deklaronte si më poshtë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne ju  
20 kërkojmë ndjesë që ju ndërpres. A mund t'i heqim fotografitë?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, mund t'i heqim.

22 Pra, ajo çfarë thotë Dëshmitari 1679, thotë:

23 “Nga ajo çfarë mbaj mend unë, bëhej fjalë për një  
24 ndërtesë që ishte bërë me gurë dhe që kishte dysHEME prej  
25 druri. Kishte dhe kashtë dhe ishte lagështirë.”

1 Kjo mund të gjendet në transkript në faqen 889 të datës 4  
2 tetor 2021.

3 Stalla ose podrumi përshkruhet si më poshtë:

4 "... nuk kishte kafshë. Por ishte e dukshme që ishte një  
5 stallë. Mund ta shihje, sepse unë kam parë vende të tilla në  
6 të shkuarën, vende ku mbaheshin lopët."

7 Dhe në përgjigje të pyetjes dhe pyetja pastaj vazhdon:

8 "Po. Ishte një derë, një derë prej druri nga e cila  
9 futeshe dhe dilje. Dhe gjithashtu edhe trarët ishin prej  
10 druri."

11 Kjo jepet qartë në transkriptin e datës 4 tetor 2021.

12 Ndërkohë Dëshmitar 1679 pyetet për sa i takon stallës ku  
13 ishte mbajtur personi dhe pyetja që i bëhet atij ishte:

14 "A mund të përshkruani ju lutem vendin se ku gjendej kjo  
15 stallë, ky ahur dhe çfarë përmasash kishte ai?"

16 Dhe dëshmitari përgjigjet:

17 "Nuk ishte një vend i madh. Nuk e di vërtet sesa ishte.  
18 Ishte një ambient normal. Kishte kashtë në dysHEME, kishte  
19 lagështirë, muret ishin prej guri, kishte dhe trarë. Nuk e di  
20 sesa e madhe ishte. Ndoshta ishte një dhomë që ishte normale."

21 Sa i takon pyetjes së bërë për tavanin, ai thotë:

22 "Nuk e mbaj mend. Nuk e di. Në atëkohë isha më i dobët,  
23 por mendoj që nuk ishte e mundur që të cekej tavani."

24 Sa i takon përmasave të stallës, dëshmitar thotë:

25 "Nuk e di, zotëri. Nuk jam në gjendje për t'jua thënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 92

1 këtë gjë.”

2 Për sa i takon dritares, dëshmitari thotë:

3 “Nuk e mbaj mend. Me aq sa mbaj mend unë, nuk kishte  
4 dritare. Kishte një derë, një derë prej druri dhe kishte ca  
5 hapësira nga ku ti mund të shihje nga dërrasat prej druri.”

6 Këtë mund ta shikojmë në transkriptin e datës 5 tetor  
7 2021, në faqen 982.

8 Identifikimi përmes fotografive. Ai identifikoi përmes dy  
9 fotografive, fotografitë SPOE00128388 dhe SPOE00128392 të  
10 ndërtesave që i kishte shënjuar me numrin 2. Dhe këto janë  
11 dokumentet në ERN100803 dhe 100805 me një shënim të veçantë që  
12 i është bashkëlidhur [REDAKTUAR].

13 Të nderuar Gjykatës, ne kemi këtë përfundim për  
14 Dëshmitarin 1679. Dëshmitari ka përshkruar vetëm njëherë  
15 sipërfaqen e jashtme të ndërtesës.

16 Dy, për shkak se kokën e kishte gjithmonë të mbuluar për  
17 shkak të vendosjes së thesit në kohë edhe kur është  
18 transferuar, ai nuk kishte mundësi që të shikonte se cili  
19 ishte ambienti sepse gjithmonë kishte thesin në kokë.

20 Së treti, siç e thamë edhe më përpara, 1679 thuhej se  
21 gjatë gjithë kohës ose pjesën më të madhe të kohës foli për  
22 sipërfaqen e brendshme të një vendi, jo për sipërfaqen e  
23 jashtme. Përshkrimi i zonës së jashtme, që tha ai, ishte shumë  
24 i kufizuar.

25 Katër, pavarësisht kësaj, atij ju treguan dy fotografi të

1 asaj çfarë ne quajmë oda në kompleks.

2 Pesë, nga deklarata e këtij dëshmitari, dëshmitari nuk  
3 jep asnjë përshkrim dallues të pjesës së jashtme ose të pamjes  
4 së vendit ku ka qëndruar i ndaluar. Përveç kësaj, dëshmitari  
5 nuk dha asnjë përshkrim të oborrit. Përshkrimi i sipërfaqes së  
6 brendshme të atij podrumi, ku ai është mbajtur, nuk jep asnjë  
7 gjë konkrete që mund të çojë në sipërfaqen e brendshme të  
8 podrumit të goditës ku gjendej oda ose në një godinë tjetër  
9 nën skenën e kompleksit. Nuk është përshkrim dallues i një  
10 podrumi por mund të jetë çdo podrum në zonë.

11 Së gjashti, Dëshmitari 1679, për rrjedhojë nuk mund të  
12 identifikojë asnjëherë pjesën e jashtme të një ndërtese  
13 mbështetur në një fotografi.

14 Shtatë, ishte hera e parë që ai shkonte atje dhe ai nuk  
15 ka qenë më asnjëherë tjetër atje.

16 Tetë, skica që vizatoi, e identifikuar me numrin  
17 ERNo60694, datë 5 qershor 2019 dhe po ta krahasojmë atë lidhur  
18 me çfarë dimë ne për kompleksin, është e pamundur që të  
19 kuptojmë gjë prej kësaj. Është e qartë që ai në asnjë mënyrë  
20 ose asgjë e lidhur me të, pra, nuk reflekton asgjë në asnjë  
21 mënyrë që mund të shihet në kompleks.

22 Së fundi, të nderuar Gjykatës, për pasojë identifikimi  
23 përmes dy fotografive, fotografitë 00128388 dhe 00128392 të  
24 ndërtesës së odës, çon në konfirmimin e pozicionit të  
25 Mbrojtjes që dëshmitari nuk ishte në gjendje që të bënte një

1 identifikim të mirë të ndërtesës ku ishte mbajtur.

2 Të nderuar Gjykatës, ky dëshmitar nuk bëri një

3 identifikim të besueshëm të ndërtesës ku është mbajtur.

4 Dëshmitari nuk ishte në gjendje të identifikonte pjesën e

5 jashtme të ndërtesës sepse nuk ka qenë asnjëherë në gjendje ta

6 shikonte atë kur shkoi atje dhe kur është transferuar për në

7 vendin ku është rrahur. Skica dhe fotot që i janë treguar atij

8 nuk mund të jenë të besueshme dhe nuk mund të kenë absolutisht

9 asnjë vlerë provuese.

10 Të treguarit e një fotografie të vetme, sidomos kur bëhet

11 fjalë për pjesën e jashtme të ndërtesës, sidomos kur ajo nuk

12 është diskutuar, pra, duke i treguar në këto rrethana

13 dëshmitarit një ndërtesë të vetme është një pyetje sugjeruese,

14 drejtuese. Në këtë rast, dëshmitarit do të duhesh t'i kishin

15 treguar një numër fotografish të ndërtesave të ngjashme nga e

16 cila të mund të zgjidhte një. Dhe për këtë arsye nuk mund të

17 mbështetemi në dëshminë e tij as ZPS-ja dhe as të tjerët.

18 Të nderuar Gjykatës, tani do të kalojmë në Dëshmitarin

19 03594. E ka shpjeguar ndërtesën ku është mbajtur si një shtëpi

20 me dy kate.

21 "Në katin e poshtëm ndodhej një derë e vjetër. U hap

22 dera, hyra në një dhomë.

23 Nuk ishte një hapësirë e madhe. Nuk ishte as e vogël as e

24 madhe. Ishte një vend ku mbaheshin kafshët."

25 "Kishte një dritare të vogël në pjesën e poshtme, pra,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 95

1 një derë dhe një dritare.”

2 Dhe këtë dëshmitari e ka bërë më datën 12 tetor, në faqen  
3 1039 të transkriptit.

4 “Nuk ka pasur krevat, as diskutim që mund të kishte  
5 krevat.”

6 “Na sollën ca kashtë sepse kishte ca kashtë jashtë  
7 ndërtesës dhe këtë bëmë e shtruum atë dhe kishim edhe disa  
8 batanije.”

9 Kjo ka datën 12 tetor dhe është faqja 1073.

10 “A ka pasur apo nuk ka pasur dritë? Ishit në gjendje të  
11 shihnit dritë këtu në haur?”

12 “Po, sepse ka pasur një dritare. Ishin dy pjesë dhe  
13 kishte dritë. Nuk ishte dritare me xham. Ishte me dru po  
14 kishte një pjesë të hapur aty.”

15 Kjo ishte pyetja.

16 Pyetja:

17 “Po a ishte një pjesë ku mund të shihej, ishte hapur apo  
18 ishte mbyllur, bërë me dru?”

19 Përgjigja:

20 “Kishte mjaft vrime nga ku të hynte drita. Ato ishin  
21 dërrasa të vjetra. Mund të imagjinoni, ishte një dritare për  
22 një vend ku mbahen kafshët.”

23 “A ishte e mundur që nga ahuri të shihej jashtë, pra, a  
24 mund të shihje jashtë nga ahuri?”

25 Përgjigja e tij ishte:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 96

1 "Jo."

2 Dhe kjo më datën 13 tetor, në faqen 1185, 86 të  
3 transkriptit.

4 Përfundimi lidhur me këtë dëshmitar, e nderuara  
5 Gjykatëse, është që dëshmitari e përshkruan ndërtesën me terma  
6 të përgjithshëm pavarësisht se ai nuk kishte thes në kokë dhe  
7 mund të shihte lirisht me sytë e tij. Dhe, siç e thamë më  
8 parë, ai pothuajse gjithë kohën ka folur për pjesën e  
9 brendshme të ndërtesës por nuk ka bërë ndonjë përshkrim të  
10 pjesës së jashtme. Përshkrimi i pjesës së jashtme ishte i  
11 kufizuar, nuk ishte shumë përshkrues në kuptimin që të mund të  
12 krahasohet me ndonjë nga fotografitë.

13 Ai ka shpjeguar një shtëpi të vetme nga pjesa e pasme e  
14 së cilës mund të shihej një shtëpi e vjetër.

15 Dhe përfundimi për këtë dëshmitar, të nderuar Gjykatës,  
16 është që nuk ka bërë ndonjë identifikim që qëndrueshëm të  
17 ndërtesës në të cilën e kanë mbajtur.

18 Dhe pastaj të kalojmë, të nderuar Gjykatës, tek 4669.

19 Dëshmitari ka thënë lidhur me ahurin:

20 "Ahuri ishte një si dhomë e madhe, pak si stallë. Ishte  
21 si një vend ku ushqehen kafshët aty brenda që ishte druri.  
22 Muret ishin me dru dhe me dhe'. Ato kishin të çara dhe mund të  
23 shihej nga jashtë që ishin të bëra këto mure me dru, me dhe'  
24 dhe me kashtë, po ishte gjithmonë errësirë. Kishte një dritare  
25 por hynte pak dritë."



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 97

1 Dhe kjo është më datën 10 nëntor 2021, faqe 1430 e  
2 transkriptit.

3 Ndërsa për kushtet e këtij ahuri dëshmitari, të nderuar  
4 Gjykatës, tha nëse kishte mundësi që të shihje nga dritarja.  
5 Dhe dëshmitari thotë.

6 "Jo", jo nga dritarja por ishte e mundur që të shihje nga  
7 vrimat që kishte muri. Momenti kur është mbajtur brenda ky  
8 dëshmitar ka pasur persona të tjerë rreth e rrotull për shkak  
9 se dëshmitari ishte në gjendje që t'i shihte lëvizjet e tyre  
10 nga të çarat e ahuri. Të shihte siluetat e këtyre personave.  
11 Ka parë me dhjetëra personave të cilën zhvillonin aktivitetet  
12 e ndryshme jashtë. Dhe dëshmitari e ka deklaruar këtë më datën  
13 11 nëntor, në faqen 1532 të transkriptit.

14 Kur është pyetur cila ishte gjendja e këtij ahuri,  
15 dëshmitari u përgjigj se ishte si një stallë dhe kishte aty-  
16 këtu kishte ca bar. Dhe tha që kishte parë dhe ndjerë  
17 mbeturinat, ekskrementet e kafshëve. Më 11 nëntor 2021.

18 Më pas është pyetur lidhur me derën e këtij ahuri. Tha:

19 "Ishte druri. Ishte bërë me panele druri dhe ishte me kyç  
20 nga jashtë, si ato dyert tona tradicionale. Ato mbyllen ose me  
21 në kyç ose me diçka. Unë nuk e kam parë. Në fakt ishte ngjyrë  
22 që ishte gri në të zezë."

23 Data 11 nëntor, faqja 1547 e transkriptit.

24 Në parashtrimet që kishin të bënin me pyetjet e Trupit  
25 Gjykses, ZPS-ja dorëzoi një dokument, F00471. Në këtë dokument

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 98

1 në faqen 3, që është fotografia SPOE128388. Në krye të faqes  
2 shikohet kjo fotografi me një rreth blu. Megjithëkëtë,  
3 dëshmitari gjatë dëshmisë së tij tha dhe citoj:

4 "Z. Dëshmitar, dy ndërtesa janë të rrethuara me një rreth  
5 blu, a e keni bërë ju vetë këtë vizatim?"

6 Përgjigja:

7 "Nuk më kujtohet ta kem bërë unë, se ndoshta dikush  
8 tjetër e ka bërë. Pyeti së pari nëse ky ishte vendi dhe  
9 ndoshta ato e bënë rrethimin e këtij vendi."

10 Transkripti në faqen 1471, data 10 nëntor 2021.

11 Dëshmitari kish treguar në intervistën e tij me ZPS-në në  
12 atë kohë, [REDAKTUAR] gjendet në  
13 dokumentin SPOE082023-TR-ET, Pjesa 2, faqja 29 dhe 30, i tërë  
14 albumi fotografik. Dokumenti ka numrin rendor ERN SPOE00128386  
15 deri 128420.

16 Në atë kohë që është treguar albumi gjatë kësaj  
17 interviste, ai tregoi fotografinë 00128407, që, në fakt, është  
18 një fotografi tjetër. Dhe për këtë arsye, ai po komentonte mbi  
19 në fotografi tjetër, SPOE128407, për shkak se nuk ka asnjë  
20 tregues në intervistë se cilën fotografi kishte rrethuar në  
21 veçanti.

22 Dhe përfundimi për këtë dëshmitar është që dëshmitari ka  
23 përshkruar vetëm ahurin. Dhe bazuar mbi përshkrimin e tij, ai  
24 ishte shfrytëzuar për kafshë kohët e fundit.

25 E dyta, dëshmitari e ka përshkruar në vija të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 99

1 përgjithshme këtë ndërtesë, pavarësisht se mund të shihte  
2 lirisht se nuk kishte thes në kokë.

3 E treta, përshkrimi i pjesës së jashtme ishte i kufizuar  
4 dhe jo me shumë hollësi, në kuptimin që të mund të krahasohet  
5 me ndonjë nga fotografitë.

6 Dhe, e katërta, ai tha se nuk besonte që ai të kishte  
7 rrethuar ndonjë gjë në këtë fotografi.

8 Dhe përfundimi i përgjithshëm është që dëshmitari nuk ka  
9 identifikuar në mënyrë të besueshme ndërtesën në të cilën e  
10 kanë mbajtur.

11 E nderuar Gjykatëse, tani do të kaloj --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala  
13 Mbrojtëse?

14 Ne kemi hyrë në seancë private në mëngjes dhe dua t'ju  
15 përkujtoj, pa hyrë në seancë private përsëri, atë që kemi  
16 diskutuar në atë kohë për atë që mund të thuhet dhe atë që nuk  
17 mund të mos thuhet. Faleminderit.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të diskutojmë ato që ne do  
19 t'i quanim hetuesit. Dua që të diskutoj së pari 0593.

20 Dëshmitari tha që ishte marrë në pyetje nga i akuzuari  
21 dhe kjo ka ndodhur gjashtë apo shtatë ditë mbas datës 18, kur  
22 ushtarët e kishin dërguar në dhomën lart. Pra, ekzistonte kjo  
23 dhomë lart dhe i akuzuari filloi t'i bënte pyetje. Dhe i bëri  
24 pyetje si: Kush është hajdut? Dhe këtë e ka thënë më datën 20  
25 shtator 2021, në faqen 149 të transkriptit. Dhe do t'ju

Dhoma e Specializuarë të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbysëse (Seancë private)

Faqe 100

1 kërkoja që të futeshim në seancë private, të nderuar Gjykatës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Sekretare, a mund të hyjmë në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 101

1 jemi në seancë publike.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Ky dëshmitar në vitin 2021 fillon  
6 të përdorë emrin e të akuzuarit. Ai nuk dëshiron as t'ia thotë  
7 emrin të akuzuarit, por asnjëherë nuk e ka përmendur emrin e  
8 të akuzuarit askund asnjëherë më parë.

9 Dhe përfundimi është, që bazuar mbi dëshminë e tij, nuk  
10 mund të provohet nga një kapele e kuqe, që është i akuzuari  
11 personi që e ka marrë në pyetje.

12 Pastaj Dëshmitari 1679. Ai thotë që është marrë në pyetje  
13 nga komandanti Cali. Dhe kjo ndodhi pas arritjes në kohën kur  
14 është marrë nga ndërtesa e shkollës dhe dërguar në vendin e  
15 paraburgimit.

16 Data 4 tetor, faqja 867 e transkriptit.

17 Përfundimi. Nga dëshmia e dëshmitarit nuk mund të  
18 provohet që në ditën e arrestimit të dëshmitarit komandanti që  
19 e ka marrë atë në pyetje nuk është ai që është paraqitur si  
20 komandanti Cali.

21 Tani Dëshmitari 3594. Ky dëshmitar nuk e ka përmendur të  
22 akuzuarin fare si një prej personave që e kanë marrë në  
23 pyetje.

24 Dëshmitari 4669, është marrë në pyetje vetëm njëherë,  
25 ditën e tretë pas mbërritjes dhe në vendin ku është mbajtur.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 102

1 Seanca ka zgjatur 20 minuta, gjysëm ore, përfshirë edhe  
2 rrahjen që ka pësuar. Në një moment të caktuar kanë ardhur dy  
3 femra. Kanë ndenjur në afërsi të të tjerëve. Është rrahur ai  
4 pasi ishin marrë në pyetje ose rrahur të paraburgosurit e  
5 tjerë.

6 Dhe kush e ka marrë në pyetje këtë dëshmitar? Në kohën që  
7 e kanë marrë në pyetje, ai nuk ka vërejtur që ndokush të ishte  
8 komandant. Ishin dy persona të cilët e kanë marrë atë në  
9 pyetje dhe ishin rreth 17 vjeçarë. Aty në afërsi të tyre  
10 qëndronin dy persona të tjerë që ishin të gatshëm po të ishte  
11 e nevojshme që të ndërhyenin, pra, ishin katër persona rreth e  
12 rrotull tij. Ai nuk i njihte njerëzit të cilët e kanë marrë në  
13 pyetje.

14 Dhe përfundimi i përgjithshëm për këtë dëshmitar, të  
15 nderuar Gjykatës, është që ai nuk e ka përmendur të akuzuarin  
16 fare si një prej personave që e kanë marrë në pyetje.

17 E nderuar Gjykatëse, kam një numër reference të personit  
18 që diskutuam në seancë private. Mendoj se ky është momenti për  
19 ta dhënë këtë referencë. A dëshironi ta jap në seancë të  
20 hapur?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Numri  
22 rendor nuk është problem.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Numri është SPOE00127751 deri  
24 SPOE00127752.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 103

1 Faleminderit.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Gjykatëse, numri i personave të  
3 mbajtur në ndalim.

4 Po e filloj me Dëshmitarin 3593. Në lidhje me W03593, ai  
5 ka përmendur një numër individësh të cilët arritën në vendin  
6 ku e mbanin atë. Dhe kjo është zhvilluar gjatë kohës që ai  
7 ndodhej atje. Atje në atë vend ai ka takuar vetëm të  
8 ashtuquajturin viktimë të vrasjes, që është mbajtur atje për  
9 rreth 1 orë deri një orë e gjysëm. Dhe më pas shkoi në vendin  
10 e dytë, ku nuk ka takuar askënd për shkak se është rrahur  
11 atje. Ai shkon përsëri tek vendi i parë, ku edhe njëherë ka  
12 takuar personin i cili thuhet që është personi i vrarë në këtë  
13 çështje. Dhe pastaj shkon në vendin e tretë, ku së bashku me  
14 personin që supozohet që është vrarë dhe është pjesë e kësaj  
15 çështjeje dhe me të arritur fillimisht ka parë aty dy apo tre  
16 persona që gjendeshin aty. Kjo është dëshmia e dëshmitarit më  
17 datën 20 shtator, faqen 416 e transkriptit.

18 "Pra, ata hapën derën dhe nuk e di, sepse ne në kokë  
19 kishim thasë. E hapën. Na hoqën thesin dhe aty më pas pamë dy  
20 apo tre personat e tjerë. Ja kështu mbërritëm."

21 Dëshmitari e ka përshkruar këtë në faqen 419, të njëjtën  
22 ditë më datë 20 shtator 2021.

23 Dhe më pas vazhdon:

24 "Çdo natë sillnin njerëz të tjerë. Ishim deri në 17  
25 persona në atë dhomë".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 104

1 Ai nuk ka njohur asnjë nga personat të cilët janë sjellë  
2 në atë dhomë. Dëshmitari e deklaroi këtë me të hënën më 20  
3 shtator, në faqen 419 e transkriptit.

4 Pas lirimit, dëshmitari po kështu dha dëshmi lidhur me  
5 numrin e njerëzve të cilët ndodheshin në kohën e lirimit dhe  
6 po citoj:

7 "Ishim ne personat që ndodheshim aty. Unë isha personi i  
8 parafundit. Ndoshta 17 persona, mendoj. Ne u larguam nga ky  
9 vend dhe unë kam lënë vetëm një person prapa. Pra, në fund  
10 ndodheshin tre nga ne. Unë ndalova dhe lashë dhe ishin dy  
11 persona kur u largova. Kur unë u largova nga ndërtesa unë  
12 lashë dy persona prapa."

13 E nderuar Gjykatëse, pavarësisht se dëshmitari nuk është  
14 i qartë se me sa persona ishte atje, përgjigja e tij tregon se  
15 në kohën e lirimit kanë qenë të paktën 17 persona. Pra, në  
16 kohën e lirimit të tij më 20 shtator, faqja 484.

17 Si përfundim, ky është i vetmi dëshmitar që përmend 17  
18 persona që kanë qenë aty në një kohë të caktuar. Nuk është e  
19 mundur, po ta shohim në mënyrë objektive vendin ku janë  
20 mbajtur këto që ky vend të zërë kaq shumë njerëz dhe e kam  
21 fjalën për ahurin apo për podrumin e asaj që quhet oda.

22 Dëshmitari 1679, të nderuar Gjykatës, tha që: "Kur është  
23 dërguar atje ka gjetur të ashtuquajturën viktimë të vrasjes,  
24 3594, 3593, pavarësisht se tha që mbiemri i këtij personi që  
25 ndryshe nga ai i 3593. Dhe ai përmendi një person tjetër i



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 105

1 cili nuk është identifikuar asnjëherë, e nderuar Gjykatëse.

2 Ndoshta mund të hyjmë shkurtimisht në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare, mund të hyjmë në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

18 jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

22 Gjykatëse.

23 Atëherë, tani 3594.

24 "Sa njerëz të tjerë maksimumi kanë qenë në atë stallë?"

25 Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje ishte:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 106

1 "A e keni fjalën sesa persona mund të ishin, kanë mundur  
2 të qëndrojnë në atë stallë? Kjo është pyetja? Është e saktë?"

3 "Jo. Më vjen keq. Pyetja është me sa persona keni qenë  
4 aty brenda përfshirë veten tende në këtë stallë?"

5 Përgjigja ishte që:

6 "Në një moment kemi qenë pesë persona, pastaj gjashtë."

7 Dëshmitari e ka deklaruar këtë më datën 12 tetor 2021, në  
8 faqen 1186 të transkriptit.

9 Edhe W4669 e ka diskutuar numrin e personave. Dhe ai tha:

10 "Kur hyra në këtë dhomë kam parë dy njerëz të tjerë."

11 Dëshmitari e ka bërë këtë më datën 10 nëntor, në faqen  
12 1415 të transkriptit.

13 Dhe ai thotë për ata persona që: Nuk i njihte këta njerëz  
14 që ndodheshin brenda. Nuk i ka mësuar emrat e tyre. Pas  
15 luftës, ai mori numrin e telefonit të njërit prej tyre. Ky  
16 person kishte dy djem të cilin ishin bashkuar me UÇK-në.

17 Këtë e ka deklaruar më datën 10 nëntor, në faqen 1417.

18 Dy personat e tjerë që ndodheshin në ahur. Ai thotë që i  
19 kujtohet që janë sjellë dy persona të tjerë. Ishin tre apo  
20 katër ditë përpara dëshmitarit.

21 Kjo është 10 nëntor, faqja 1424, rreshti 19.

22 Në një moment të caktuar viktimat e supozuar e vrasjes,  
23 thotë që dëshmitari e njihte këtë person.

24 E nderuara, Gjykatëse, dëshiroj të kaloj në seancë  
25 private për një çast.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë private)

Faqe 107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, mund të kalojnë në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur,

21 të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit, znj. Sekretare.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Konkluzioni i përgjithshëm për

25 dëshmitarët që kemi diskutuar 1679, 3593, 3594 dhe 4669.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 108

1 Dëshmitari përmend njerëz të cilët nuk i përmendin njerëz të  
2 tjerë. Në veçanti, W1679 përmend 3593, 3594, viktimën e  
3 supozuar të vrasjes, 04669 dhe një person që quhet Burmak.

4 3593, ka përmendur viktimën e supozuar të vrasjes, 3594  
5 dhe Burmakun.

6 Po të shohim se ç`thotë 3594, ai përmend 3593, Burmakun,  
7 viktimën e supozuar të vrasjes dhe tre persona i thotë me  
8 emër.

9 Dhe në fund, 4669 përmend vetëm viktimën e supozuar të  
10 vrasjes së kësaj çështjeje, pra, vetëm një person me emër.

11 Pra këta, në të njëjtën kohë, në të njëjtën vend, kanë  
12 qenë së bashku megjithëkëtë askush nuk përmend të njëjtët  
13 njerëz që t`i tregojë ose me emër ose me përshkrim.

14 Dhe ne nuk besojmë, të nderuar Gjykatës, që bazuar mbi  
15 këtë mund të ketë ndonjë vlerë provuese në këto rrëfime të  
16 dëshmitarëve. Po jap edhe një shembull tjetër.

17 W1679 thotë që W4669 ishte bashkë me të në ahur. Ndërkohë  
18 që në të njëjtën kohë, W4699 asnjëherë nuk e ka përmendur  
19 W1679 dhe mund të vazhdojmë kështu gjatë kohës.

20 E nderuar Gjykatëse, doja ta përfundojë këtë pjesë dhe të  
21 kaloj tek tematika që ka të bëjë me ndalimin arbitrar.

22 Ndalimi arbitrar i shtatë njerëzve. Sipas dosjes  
23 paraprahe të ZPS-së, paragrafët 52 deri në 59, numër F0088,  
24 faqja 1921, dokumenti F00088, Aneksi 01, ishin të ndaluar  
25 shtatë persona. Mbrojtja do të diskutoj ata që kanë dëshmuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 109

1 Të tjerët që nuk kanë dëshmuar ose mungojnë, janë të vdekur,  
2 apo personi nuk është gjetur. Kjo na lë me katër persona të  
3 ndaluar.

4 Ndalimi i Dëshmitarit 1679, sipas ZPS-së.

5 Sipas dosjes paraprake të ZPS-së, paragrafi 53,  
6 Dëshmitari 1679 është arrestuar në 1 prill nga anëtarë të  
7 armatosur të njësisë BIA të UÇK-së. Në këtë dosje të ZPS-së,  
8 paragrafi 33, lexon se Dëshmitari 1679 u arrestua në ditën e  
9 pestë të trajnimit të tij, të paktën nga katër ushtarë të  
10 armatosur, të veshur me uniforma të zeza të cilët e morën me  
11 vete.

12 Tani, për shumë arsye, ne nuk e besojmë atë që pretendon  
13 ZPS-ja të ketë ndodhur në atë datë, madje dhe atë që  
14 dëshmitari e ka thënë lidhur me trajnimin nëse është e mundur.  
15 Është e rëndësishme të vihet në dukje se Dëshmitari 1679  
16 pretendon se është trajnuar nga Adem Shehu. Për këtë ai  
17 dëshmoi në 4 tetor 2021, në faqen 864 të transkriptit.

18 Ne e dimë me siguri se Adem Shehu, komandant i Brigadës  
19 153, sipas deklaratës së dhënë vetë prej tij, nuk ka mbërritur  
20 më përpara se data 28 mars 1999 në Brigadën 153. ZPS-ja e ka  
21 intervistuar Adem Shehun në 27 janar 2021. ERN 090258-TR-ET,  
22 pjesa 2, faqja 6, rreshtat 9 deri 16 dhe faqe 10, rreshtat 19  
23 deri në 20.

24 Mbrojtja po ashtu e intervistoi z. Shehu. Adem Shehu nuk  
25 tha kurrë se kishte trajnuar ndonjë rekrut në Zllash. Ai tha

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 110

1 se kish trajnuar njerëz në Tiranë. Kjo ka ndodhur në 27 janar  
2 2021. Me numër ERN 090258-TR-ET, Pjesa 2, faqja 5, rreshtat 13  
3 deri në 15.

4 Sipas Musli Halimit, gjatë kohës që ai ishte aty si  
5 komandant i qendrës trajnuese deri në 7 apo 10 prill, Adem  
6 Shehu nuk ka qenë instruktor i rekrutëve. Ai këtë e ka thënë  
7 në dëshminë e tij të datës 20 prill 2022.

8 Pika e dytë. Në qoftë se W1679 është arrestuar, sikurse  
9 ka thënë dhe sipas ZPS-së, në datën e pestë të trajnimit të  
10 tij dhe duke pasur parasysh faktin që Adem Shehu ka mbërritur  
11 aty në 28 mars 1999, Dëshmitari 1679 duhet të jetë marrë apo  
12 arrestuar në 2 prill të paktën. Nuk është e mundur që Adem  
13 Shehu të ketë filluar të trajnojë njerëzit në qendrën  
14 stërvitore në Zllash në datën e mbërritjes së tij.

15 Të mos harrojmë, të nderuar Gjykatës, se Adem Shehu ka  
16 shkuar më këmbë nga Shqipëria në Kosovë dhe ka mbërritur aty  
17 në Zllash në këmbë. Ai këtë e ka thënë në 27 janar, me numër  
18 ERN 090258-TR-ET, Pjesa 2, faqja 6, rreshtat 9 deri 16 dhe në  
19 faqen 10, rreshtat 19 deri në 20.

20 Tani, z. Shehu është një njeri në gjendje të shëndoshë,  
21 por unë e përjashtoj faktin që mbasi të ketë ecur 18 ditë, të  
22 ketë filluar të trajnojë rekrutët po atë ditë që ka mbërritur  
23 në Zllash. Në fakt, teoria është që 1679 duhet të jetë  
24 trajnuar nga Shehu në 28 mars. Dhe po ta llogarisësh nga ajo  
25 ditë minimumi i bie 1 prilli. Pra, dua të them se edhe në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 111

1 qoftë se vërtet 1679 është trajnuar nga Shehu në ditën që  
2 është arrestuar, atëherë historia e tij nuk del. Kjo vjen për  
3 shkak të kësaj që do të them.

4 Një konflikt me këtë deklaram të tij është ky që vijon.  
5 Në këtë kontekst, është interesante të shihet se dëshmia e  
6 1679 para Gjykatës thotë që, kur ai mbërriti në vendin e  
7 ndalimit, pa, aty gjeti të pretenduarin viktimën e pretenduar  
8 të vrarë; W05494 dhe pastaj W03593, por i jep një mbiemër  
9 tjetër; dhe një person të quajtur -- dhe tani dua të futem në  
10 seancë private.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
12 lutem, të kalojmë ë seancë private.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Pika 4. Sipas D3594, ai, pra,

16 3594, është arrestuar në 4 prill 1999.

17 Dëshmitari 1679 tha se kur hyri për herë të parë në  
18 stallë, pa katër njerëz aty, përfshirë 3594 që ishte njëri  
19 prej tyre. Pra, del se 1679 është arrestuar pasi 3594 ishte  
20 ndërkohë i ndaluar. Ndryshe 1679 nuk do ta kishte parë dot kur  
21 mbërriti në ahur.

22 Dëshmitari 3594 është i sigurt për datën e arrestimit të  
23 tij, e cila ndodhi pas datës që ai përmendi.

24 Dhe mund të kalojmë në seancë private.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund



1 të kalojmë në seancë private, ju lutem.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Për Mbrojtjen është me rëndësi të

23 vihet në dukje se personi i vetëm i cili ka mundur t'i

24 referohet një date të caktuar ishte 3594. Asnjë dëshmitar

25 tjetër i ZPS-së nuk ishte në gjendje t'i jepte një referencë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë private)

Faqe 114

1 se ku e kishin fjalën.

2 Dhe duhet të themi se kjo bie në kontrast të madh me  
3 dëshmitarët e Mbrojtjes. Megjithatë, nëse Dëshmitari 1679  
4 thotë se është mbajtur për 18 ditë, atëherë i bie që të jetë  
5 liruar në 23 prill, domethënë, mbas ofensivës serbe.

6 Pesë. Në qoftë se ka ndodhur që 1679 është arrestuar në 1  
7 prill, prapë historia e tij nuk ka kuptim. 1679 është  
8 arrestuar mëngjes vonë, sipas asaj që tha vetë, rreth orës  
9 11.00. Por viktima e pretenduar e vrasjes është arrestuar nga  
10 4600 dhe nuk mbërriti aty përpara pasdites vonë. Pra, edhe në  
11 këtë rast, nuk është e mundur që 1679 ta ketë gjetur viktimën  
12 e vrasjes e pretenduar pikërisht në vendin e ndalimit.

13 Gjashtë. 1679 deklaroi se pas disa ditësh një person i  
14 quajtur 4669 arriti aty. Por 4669 gjeti vetëm dy veta kur  
15 mbërriti në stallë. Njëri ishte nga Mitrovica [REDAKTUAR]  
16 [REDAKTUAR]  
17 [REDAKTUAR]4669, i cili ka lindur -  
18 mbase duhet të shkojmë në seancë private.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
20 kalojmë në seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7  
8  
9  
10  
11  
12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Keni fjalën.

Z. VON BONE: [Përkthim] Pikë 7. Ne e thamë se trajnuesi i rekrutëve të rinj tha se në fillim -- ne thamë se atë që ka thënë trajneri i rekrutëve, Musli Halimi tha se kishte një plan të caktuar ku në fillimin e një muaji fillonte trajnimi ose rreth datës 15. Pra, çdo brez fillonte në njëerën nga këto dy pika. Përveç kësaj duke folur për lirim 3593 foli për lirim e tij duke thënë se vetëm 3495 dhe personi që përmenda më herët, të nderuar Gjykatës, në seancë private shkoj me të në familjen e viktimës së pretenduar të vrasjes. Ai, pra, 3593, nuk e përmendi asnjëherë që me ta aty shkoi dhe 1679.

Pika 9. Provat e listës së dëshmitarëve gjithashtu nuk përputhen. ZPS-ja i referohet kësaj liste të dëshmitarëve, në numrin 171, 174 të dosjes së saj përfundimtare.

Lista e dëshmitarëve që përdori ZPS-ja si provë për pohimin e saj se 1679 është rrëmbyer në fillim të prillit nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 116

1 përputhet. Lista e të burgosurve ku një person i quajtur me  
2 numrin 1679 është burgosur në 3 prill.

3 Në qoftë se llogaritja e 1679 do të ishte e drejtë, e  
4 saktë, se është mbajtur aty për 18 ditë dhe 17 net, kjo do të  
5 thotë që ai është liruar në 20 prill. Është koha kur Dr. Teuta  
6 Hadri dhe Ibadete Kaçiu-Canolli do të ishin ndërkohë aty duke  
7 trajtuar pacientët në ndërtesën ku 1679 pretendon se është  
8 mbajtur. Është deklarata e 1679, në 4 tetor.

9 Pastaj ndalimi i 3593, sipas ZPS-së. Dëshmitari 3593,  
10 ishte sipas dosjes paraprake të ZPS-së, u arrestua më 1 prill.  
11 Në dosjen përfundimtare të ZPS-së, paragrafi 45, u arrestua në  
12 fillim të prillit.

13 Pra, një vëzhgim i përgjithshëm i këtij dëshmitari është  
14 se ne nuk kemi mundur ta lidhim asnjëherë historinë e tij me  
15 asnjë lloj pike referimi. Ai nuk e lidhi atë me bombardimet e  
16 NATO-s, as me asgjë që ka ndodhur në atë shtëpi, që ai nuk i  
17 mbante mend dhe si rezultat nuk mund të përdoret, pra, si pikë  
18 referimi. Ne nuk e dimë. Ai thotë vetëm data 4. Nuk dimë se  
19 kujt i referohet. Është një numër kot. Nuk jep një muaj sepse  
20 nuk e di. Deklarata e tij është dhënë në 20 shtator 2021,  
21 numri i faqes është 394.

22 Fakti që një dëshmitar thjesht jep një numër dhe nuk  
23 është në gjendje ta lidhi këtë numër me asnjë moment, një  
24 ditëlindje, një bombardim apo ndonjë ngjarje personale apo dhe  
25 një ngjarje që mund të ketë ndodhur në fshatin e tij është një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 117

1 indikacion i përgjithshëm se çfarëdo që të thotë ky dëshmitar  
2 për të nuk mund të merret si pikë e sigurt. Të thuash vetëm,  
3 të përmendesh një datë pa e lidhur me asgjë nuk ka vlerë  
4 provuese në një çështje penale. Por ajo mund të shpjegojë se  
5 përse ZPS-ja devijoi nga pikëpamja e saj e parë se ai u  
6 arrestua, pikënisja e saj, se u arrestua në datën 1 prill, në  
7 fillimin e prillit në dosjen e saj përfundimtare.

8 Provat e listës së dëshmitarëve nuk përputhen me pohimin  
9 e ZPS-së se kjo ka ndodhur në 1 prill. ZPS-ja i referohet  
10 kësaj liste të burgosurve në paragrafin 171, 174 të dosjes  
11 përfundimtare.

12 Lista e të burgosurve që ZPS-ja ka përdorur si provë  
13 provuese, pra, për pohimin e saj se 3593 është rrëmbyer në  
14 fillim të prillit tregon që personi në atë listë shënohet në  
15 datën 2 prill. Pra, dëshmitari ka thënë që e dinte me siguri.  
16 Deklarata e 20 shtatorit 2021, faqja 403.

17 Unë citoj:

18 "Personi që ishte aty ishte i akuzuari."

19 "Nga e di ai atë?" Kjo ishte pyetja që i bëri Prokurori.

20 Në momentin që u pyet se cila ishte baza për këtë  
21 deklaram të tij, ai thotë:

22 "E di me siguri."

23 Por dëshmitari nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej.

24 Vazhdonte të thoshte atë fjali. Mbrojtja e ngriti këtë

25 problem, sidomos kur ai përmend një person, kur ai nuk e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 118

1 kishte parë kurrë atë person dhe nuk e kishte njohur kurrë më  
2 përpara atë person. Deklarata 3594, 22 shtator, faqja 95.

3 Mbrojtja është e mendimit se të thuash thjesht "e di me  
4 siguri" nuk ka vlerë provuese në asnjë mënyrë. Një shembull  
5 tjetër i këtij dëshmitari është vlerësimi, kredibiliteti për  
6 tema të përgjithshme por edhe për tema konkrete.

7 Sipas atij, ai është arrestuar dhe është futur në një  
8 stallë. Kjo ka ndodhur në datën 4. Asgjë më shumë.

9 Në qoftë se dokumenti që quhet lista e të burgosurve  
10 është i saktë atëherë nuk është data 4. Sipas atij dokumenti,  
11 është data 2 prill. Mbase dëshmitari ka të drejtë. Përfundimi  
12 është se lista e të burgosurve nuk është e saktë dhe nuk ka  
13 vlerë provuese dhe nuk provon asgjë në këtë drejtim.

14 Ai përshkroi në përgjithësi tre vende ku është mbajtur  
15 për një kohë. Por në momentin e parë që atë e çuan në një  
16 vend, ai dha në indikacion lidhur me kohën e ditës kur ka  
17 ndodhur.

18 Dëshmitari deklaroi se ndaluar në 4, dhe në qoftë se  
19 marrim fjalën e tij si një përvojë e paharrueshme që i ka  
20 ndryshuar jetën, atëherë nga kjo del se për sa kohë ai është  
21 mbajtur. Ai tha se fjeti në ujë për 18 ditë. 20 shtator, faqja  
22 418. Kjo do të thotë që dëshmitari është liruar më 22 prill  
23 edhe në qoftë se ai ka thënë se ofensiva filloi në 18  
24 dëshmitari deklaroi në 20 shtator, faqe 419. Është e njëjta  
25 gjë. Ai jep vetëm një datë, por nuk mund ta lidhë këtë datë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 119

1 apo më mirë të themi, mendon një ngjarje tjetër. Në qoftë se  
2 data e lirimit të tij do të kishte qenë data 18, duke supozuar  
3 se është ndaluar në 4, atëherë kjo do të thotë se dëshmitari  
4 përsëri nuk ka qenë i saktë. Duhet të kishte ndenjur aty vetëm  
5 14 ditë në atë vend ku e kanë mbajtur.

6 Pastaj ndalimi i 3594, sipas ZPS-së. 3594 sipas dosjes  
7 paraprahe të ZPS-së, paragrafi 55, është arrestuar në 5 prill.  
8 Sipas dosjes përfundimtare të ZPS-së, paragrafi 61, ai nuk  
9 është arrestuar po ka shkuar vetë me vullnetin e tij me dy  
10 njerëz që erdhën për ta kërkuar dhe kjo ka ndodhur në 4 prill.  
11 Ai është ndaluar po atë ditë.

12 Dëshmitari është, për disa arsye, dëshmitar dëshmia e të  
13 cilit është e besueshme. Ai nuk është maskuar në asnjë moment,  
14 kështu që mund të bënte përshkrime. Nuk i vunë një thes në  
15 kokë. Kur e nxorën jashtë nga ahuri për të zhvilluan një që ai  
16 e quan bisedë. Ai njihte njerëzit. Ai përshkruan njerëzit që e  
17 morën në pyetje apo ato që rrinin aty. Ai mund të përshkruante  
18 vendet, dhomën ku është marrë në pyetje dhe vendin ku është  
19 mbajtur. Së fundi, ishte në gjendje të largohet, të dilte nga  
20 ahuri dhe të shkonte në banjë dhe të përshkruante vendin rreth  
21 e qark.

22 Edhe pse ZPS-ja pretendoi se ai është arrestuar në 5  
23 prill, dëshmitari tha se u arrestua në 4. Për këtë arsye mesa  
24 duket ZPS-ja ndryshoi mendjen lidhur me datën kur është  
25 arrestuar ky person.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 120

1 Ky dëshmitar i ZPS-së tha se i akuzuari, Salih Mustafa,  
2 nuk ishte i pranishëm gjatë kohës së marrjes së tij në pyetje  
3 apo gjatë bisedave, siç i quante. Për sa i takon pyetjes së  
4 Mbrojtjes nëse kishte njeri të pranishëm gjatë këtyre  
5 bisedave, ai përmendi Salih Mustafën. Ai tha:

6 "Z. Lawyer, unë e njoh Saliun personalisht. Po ta kishte  
7 përmendur njeri emrin e tij do thosha, po."

8 Dhe ai e njihte Salih Mustafën që më parë. E njihte  
9 personalisht. Nuk dëgjoi kurrë apo nuk e pa kurrë Salih  
10 Mustafën gjatë kohës që ishte në Zllash. Ai thotë:

11 "Po ta kisha parë, nuk do ta kisha mbrojtur edhe në qoftë  
12 se do ishte vëllai im. Por nuk e pashë aty edhe mund ta kisha  
13 parë lart po të ishte aty, por nuk e pashë kur vajta lart."

14 Faqja 1210, 13 tetor.

15 Ky dëshmitar është shumë i qartë dhe ishte në gjendje të  
16 jepte informacion se s'e kishte kokën të mbuluar me thes. Ne e  
17 dimë, se ky dëshmitar, ishte në gjendje të përcaktonte gjërat  
18 dhe të dëshmonte për to.

19 Dëshmitari 4669. Sipas ZPS-së, paragrafi 56, ai është  
20 arrestuar në prill 1999. Sipas dosjes përfundimtare të ZPS-së,  
21 u ndalua në mars apo prill, por dëshmitari nuk ishte kurrë i  
22 sigurt për këtë, nuk e tha me siguri.

23 4669, në fakt, deklaroi dhe raportoi rreth shkurtit 1999,  
24 sipas dëshmisë së tij. Është transkripti i 10 nëntor 2021,  
25 faqja 1391. Ai tha faktikisht dhe po e citoj:



1 "Ishte katër apo pesë ditë më pas apo një javë kur ne  
2 shkua aty në Zllash për të raportuar".

3 Pasi përfundoi trajnimi, stërvitjen në Zllash, shkoi në  
4 shtëpi. Ne vlerësojmë se, po të ishte stërvitur në Zllash, kjo  
5 duhet të ketë qenë në fillim të marsit. E dimë që trajnimi  
6 përfundoi në 15 mars siç deklaroi Musli Halimi, stërvitësi. Ai  
7 shkoi të thoshte, pra, ai thotë që shkoi përsëri në Zllash  
8 një, dy, tre, katër herë sepse duhej të paraqitej. Herën e  
9 fundit është ndaluar dhe eventualisht është marrë nga 4600 në  
10 Zllash.

11 [Nuk ka përkthim]

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Tema tjetër është tjetër, kështu  
13 që dua që ta përfundoj këtë temë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua  
15 ta përfundojmë në 4.00 sepse përkthyesit kanë gjithë ditën që  
16 punojnë, kështu që dua t'i përmbahem kohës.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

18 Në faqen 1452, dëshmitar ka thënë:

19 "Por më vonë, u ktheva përsëri aty por ishte një kthim i  
20 ndryshëm. Atëherë isha i armatosur dhe isha bashkë me shumë të  
21 tjerë. Shpërndanim furnizime për ushtrinë dhe kjo është koha  
22 kur unë shkova aty për herëte fundit pasi filluan bombardimet  
23 e NATO-s".

24 4669 deklaroi se ishte rrahur nga disa njerëz. Njerëzit  
25 që e rrahën ishin më të rinj se ai. Ishin rreth 17, 18 vjeç.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 122

1 Në atë kohë, 4669 ishte [REDAKTUAR]. Ai nuk pa nëse ishte  
2 dikush si përgjegjës dhe nuk vuri re një gjë të tillë. Salih  
3 Mustafa në atë kohë ishte [REDAKTUAR]  
4 [REDAKTUAR].

5 Dua që të redaktohet kjo pjesë.

6 4669 nuk e njihte në atë kohë Salih Mustafën, pra, nuk e  
7 njihte as pseudonimin e tij.

8 Të nderuar, dua të flas për ligjin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
10 flasim për këtë argument më mirë pas pushimit.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit.

14 Tani do të bëjmë një pushim deri në orën 4.30.

15 --- Pauza fillon në orën 15.58

16 --- Seanca rifillon në orën 16.30

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
18 se erdhët përsëri. Tani do të vazhdojmë me orën e fundit të  
19 seancës së ditës së sotme.

20 Z. Avokat fjala është për juve.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar  
22 Gjykatës.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj  
24 edhe përmes tundjes së kokës, po për procesverbal po them se  
25 jemi në të njëjtën përbërjes siç ishim në seancën e mëparshëm.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 123

1           Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne  
2   dëshirojmë të bëjmë parashtrim lidhur me ligjin. Në paragrafin  
3   23 deri në 30 të vendimin për konfirmimin e Aktakuzës,  
4   Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe është parashtrimi i  
5   protokolluar F0008/CONF/RED, vëren se ndalimi arbitrar nuk  
6   është i renditur në Ligjin e Dhomave të Specializuara.

7           Neni 6 i Ligjit parashikon se Dhomat e Specializuara kanë  
8   juridiksion në krime që parashikohen në nenet nga 12 deri në  
9   15 të Ligjit. Krimet e luftës së trajtimit mizor, torturës dhe  
10   vdekjes, siç pretendohet nga Prokurori i Specializuar renditen  
11   në nenin 14(1)(b)(i) dhe për rrjedhojë janë objekt i  
12   juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

13           Gjykatësi i Procedurës Paraprake parashikon në paragrafin  
14   23 të vendimit për konfirmimin e aktakuzës që ZPS-ja ka  
15   parashtruar në Aktakuzën e rishikuar më tej, që z. Mustafa  
16   është përgjegjës në aspektin penal për krimin e luftës të  
17   ndalimit arbitrar, në shkelje me nenin 14(10)(c) të Ligjit.

18           Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se:´

19           “Ndërsa kjo dispozitë nuk e rendit shprehimisht ndalimin  
20   e arbitrar si krim lufte në një konflikt jo-ndërkombëtar të  
21   armatosur, ajo nuk e kufizon, nuk i kufizon këto krime që janë  
22   nën objektin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara në  
23   krimet që janë të renditura shprehimisht atje.”

24           Vijoj më tej.

25           “Pavarësisht kësaj, mënyre që të ushtrohet juridiksion

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 124

1 mbi një krim lufte që nuk është i renditur në nenin  
2 1491) (c) (i)-(iv) të Ligjit, krime të tilla duhet: (1) të  
3 përbëjnë shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3, dhe (ii)  
4 të ndalohen nga e drejta ndërkombëtare zakonore në kohën e  
5 kryerjes së tyre, në përputhje me nenet 3(2) (d) dhe 12 të  
6 Ligjit.”

7 Gjykatësi i Procedurës Paraprake deklaroi në paragrafin  
8 24 që neni i përbashkët 3 parashikon se “Personat të cilët nuk  
9 marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë dhe ata që janë  
10 jashtë luftimeve, për shkak të sëmundjeve, plagëve, ndalimit  
11 ose shkaqeve të tjera, në të gjitha rrethanat duhet të  
12 trajtohen në mënyrë njerëzore”.

13 Kjo mbrojtje, gjithashtu e parashikuar në nenin 14(1) të  
14 protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gusht 1949  
15 dhe që lidhen me mbrojtjen e viktimave, të konflikteve të  
16 armatosura jo-ndërkombëtare, Protokolli II i datës 8 qershor  
17 1977, duhet të zbatohen nga të gjitha palët që marrin pjesë në  
18 konfliktin e armatosur dhe ju duhet ofruar të gjithë personave  
19 të ndaluar, pavarësisht arsyes së mohimit të lirisë së tyre.

20 Gjykatësi i Procedurës Paraprake vijon më tej dhe vëren  
21 se:

22 “Kërkesa për trajtim njerëzor përbën një detyrim themelor  
23 të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe reflekton të  
24 drejtën humanitare zakonore. Është më -- ajo është më e gjerë  
25 sesa ndalimet të cilat renditen në mënyrë të shprehur në nenin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 125

1 e përbashkët 3, që shërben si shembull i sjelljes që është në  
2 mënyrë të padiskutueshme në shkelje me këtë dispozitë.”

3 Gjykatësi i Procedurës Paraprake parashton në paragrafin  
4 25 se:

5 “Mohimi i lirisë pa një arsye juridike ose në shkelje të  
6 garancive themelore nuk është në përputhje me, dhe shkel  
7 kërkesën për trajtim njerëzor të të gjithë personave të  
8 vendosur jashtë luftimeve, përfshirë përmes ndalimit, siç  
9 mishërohet në nenin e përbashkët 3.”

10 Gjykatësi i Procedurës Paraprake vijon më tej dhe vëren  
11 se në paragrafin 26, si më poshtë:

12 “E drejta kombëtare zakonore parandalon mohimin arbitrar  
13 të lirisë. Praktika e gjerë shtetërore në formën e, ndër të  
14 tjera, manualeve ushtarake, legjisllacionit penal, dokumente të  
15 organizatave ndërkombëtare dhe konferencave të tilla dhe  
16 organeve ndërkombëtare gjyqësore dhe kuazi gjyqësore  
17 përcaktojnë apo vendosin zbatueshmërinë e kësaj dispozite  
18 ndaluese si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe ato  
19 jondërkombëtare. Kjo është konfirmuar gjithashtu nga KNKK-ja  
20 në rregullin 99 të studimit të 2005 lidhur me të drejtën  
21 humanitare ndërkombëtare zakonore.

22 “Në bazë të sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
23 konstaton se, ndalimi i arbitrar përbën një shkelje të rëndë  
24 të nenit të përbashkët 3 dhe është i ndaluar nga e drejta  
25 ndërkombëtare zakonore në kohën e kryerjes së krimeve që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 126

1 pretendohen në aktakuzën e rishikuar më tej. Gjendja, statusi  
2 i ligjit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar është  
3 mjaftueshmërisht i qartë dhe i parashikueshëm për të kërkuar  
4 faktin që mohimi i lirisë së dikujt në mënyrë arbitrare mund  
5 të çojë në përgjegjësi penale nga individit që e ka kryer këtë  
6 gjë.

7 "Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në  
8 përfundimin", në paragrafin 28 se "Dhomat e Specializuara mund  
9 të ushtrojnë juridiksion mbi këtë krim lufte bazuar në nenin  
10 14(1) (c) në kombinim me nenin 12 të Ligjit".

11 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të nderuar Gjykatës, e  
12 përkufizon ndalimin arbitrar si më poshtë në konfirmimin e  
13 aktakuzën, në paragraf 49 të këtij dokumenti:

14 "Krimi i ndalimit arbitrar si krim lufte, brenda kuptimit  
15 të nenit 14(1) (c) të Ligjit, kryhet përmes veprimit ose  
16 mosveprimit që çon në mohimin e një presoni i cili nuk merr  
17 pjesë në luftime të lirisë së tij ose të saj pa pasur një bazë  
18 ligjore ose pa respektuar garancitë bazë procedurale."

19 Lidhur me ndalimin arbitrar, qëndrimi i Mbrojtjes është  
20 sa më poshtë:

21 Krimi i ndalimit arbitrar nuk është i renditur në asnjë  
22 nga nenet e Ligjit për Dhomat e Specializuara. Neni i  
23 përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, flet për trajtimin e  
24 personave të mbrojtur. Në Konventën e Gjenevës I, II, III dhe  
25 IV formulimi parashikon si më poshtë "do të trajtohen në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 127

1 mënyrë humane, në mënyrë njerëzore". Formulimi apo fjala "do  
2 të trajtohen" nuk është rastësisht.

3 Trajtimi që ndalohet është i renditur në shumë akte të  
4 cilat përmenden në nenin 14 të Ligjit për Dhomat e  
5 Specializuara. Është gabim në interpretimin e Ligjit kur  
6 Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vë ndalimin arbitrar në  
7 kornizën ose në kutinë e nenit të përbashkët 3 të Konventave  
8 të Gjenevës.

9 Ligji për Dhomat e Specializuara përkufizon si nen lufte  
10 në nenin 14 të Ligjit dhe këtu citoj:

11 "Për qëllime të këtij Ligji bazuar në ligjin  
12 ndërkombëtare zakonor, krimet e luftës nënkuptojnë..."

13 Dhe pastaj vijon një listë e gjatë e akteve që  
14 parashikohen në të.

15 Është fakt, të nderuar Gjykatës, se asnjë prej akteve në  
16 nenin 14(c) nuk rendit aktin e ndalimit arbitrar. Akti i  
17 ndalimit të paligjshëm është i renditur vetëm në nenin  
18 14(a) (vii). Ndalimi arbitrar nuk është i renditur në nenin  
19 14(c) aspak. Neni 14(c) flet rreth marrjes së pengjeve,  
20 megjithatë, ndalimi i personave në vetvete nuk çon në marrjen  
21 peng, në kuptimin e formulimit që nënkuptohet në interpretimin  
22 e përbashkët të kësaj fjale në të drejtën ndërkombëtare.

23 Ndalimi në vetvete nuk përbën shkelje të jetës. Ndalimi  
24 nuk përbën as vrasje, as gjymtim, as trajtim mizor dhe as  
25 torturë. Ndalimi nuk përbën në vetvete një cenim të dinjitetit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 128

1 njerëzor, në veçanti, trajtim poshtërues dhe degradues. Ky  
2 formulim është përdorur në nenin 14(c) dhe pika (ii) e Ligjit  
3 për Dhomat e Specializuara.

4 Edhe një herë këtu ne shohim trajtimin e njerëzve, ajo  
5 pra çfarë trajtohet është elementi i trajtimit të njerëzve.  
6 Dhe kjo është në përputhje me aktet që renditen në nenin e  
7 përbashkët 3 të katër konventave të Gjenevës.

8 Personat e mbrojtur sipas Konventës së Katërt të  
9 Gjenevës. Kjo është tema e radhës.

10 Katër Konventat e Gjenevës mbrojnë lloje të ndryshme  
11 njerëzsisht. Në secilën prej këtyre Konventa këta njerëz  
12 përkufizohen dhe përcaktohen saktë. Për shembull në Konventën  
13 I flitet për personat e lënduar dhe të sëmurë ashtu siç  
14 përkufizohen edhe personat e mbrojtur sipas Konventës I dhe  
15 III. Konventa IV e Gjenevës ka të bëjë me popullsinë civile.  
16 Neni 4 - ndjesë, neni 14 i Konventës së Katërt të Gjenevës  
17 parashikon si më poshtë:

18 "Personat e mbrojtur nga konventa janë ata persona të  
19 cilët në një moment të caktuar dhe në çdo lloj mënyre e gjejnë  
20 veten në rastin e një konflikti të armatosur ose një  
21 okupacioni në duart e një pale në konflikt ose që ka fuqi  
22 zaptuese tek të cilët ata nuk janë shtetas."

23 Komentari i Konventës së Katërt të Gjenevës parashikon si  
24 më poshtë dhe këtu citoj:

25 "Vetë titulli i Konventës tregon në mënyrë të



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 129

1 përgjithshme se cilët janë personat që synon ajo të mbulojë,  
2 por është e këshillueshme të jemi në gjendje të përcaktojmë  
3 ekzaktësisht se cilat janë ato klasa personash që mbrohen  
4 sipas kësaj Konvente. Ky është qëllimi i këtij neni.

5 Ky nen është në një kuptim një nen kyç për Konventën  
6 sepse është neni që përkufizon persona të cilët i drejtohet  
7 Konventa.”

8 Komentari në nenin 14 të Konventës vijon më tej për të  
9 përkufizuar personat të cilët janë të mbrojtur nga neni 3 i  
10 Konventës. Pra, është neni 3 i përbashkët i Konventës. Dhe në  
11 të thuhet si më parë dhe këtu citoj sa i takon territorit të  
12 shteteve palë “mbrojtja ofrohet bazuar në nenin 14 për të  
13 gjithë personat me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi.”

14 Dhe më pas komentari vijon më tej si më poshtë: “Siç  
15 bëhet në përkufizimet e këtij neni, përkufizimet janë vendosur  
16 në formë negative pasi synohet që ato të mbulojnë çdokënd që  
17 nuk është një shtetas i palës në konflikt ose i fuqisë  
18 okupuese në duart e të cilave është personi në fjalë. Konventa  
19 mbetet për rrjedhojë besnike ndaj parimit të njohur të së  
20 drejtës kombëtare. Ajo nuk ndërhyt me marrëdhëniet e një  
21 shteti me shtetasit e vet.”

22 Për rrjedhojë, Mbrojtja nuk pajtohet me konstatimin e  
23 Gjykatësit të Procedurës Paraprake në paragrafin 25 të  
24 Aktakuzës së konfirmuar, sipas të cilës thuhet:

25 “Mohimi i lirisë pa një bazë ligjore ose në shkelje të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 130

1 garancive bazë nuk është në përputhje me, dhe shkel kërkesën  
2 për trajtim njerëzor të të gjithë personave të vendosur jashtë  
3 luftime, përfshirë përmes ndalimit siç parashikohet në nenin e  
4 përbashkët 2.”

5 Edhe një herë neni i përbashkët 3 në asnjë mënyrë nuk  
6 parashikon dhe pa diskutim jo në mënyrën që formulohet sipas  
7 nenit 14(1) të Aktakuzës, ndalimin e njerëzve. Ky është një  
8 nen i cili flet për trajtimin e personave të cilët gjenden në  
9 duart e palës që ka epërsi në konflikt.

10 Për këtë arsye Mbrojtja arrin në përfundimin se baza për  
11 Aktakuzën, përkatësisht neni 14(1)(c) nuk rendit dhe madje as  
12 përkufizon krimin në ndalimin arbitrar.

13 Për më tepër, siç parashikohet qartë nga Konventa nuk  
14 duhet ndërhyrë me parimin e të drejtës ndërkombëtare dhe nuk  
15 duhet ndërhyrë në marrëdhëniet e një shteti dhe shtetasit e  
16 vet dhe për rrjedhojë, Mbrojtja është e mendimit se akti i  
17 ndalimit arbitrar nuk mund të cilësohet nën fushën e veprimit  
18 të nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, siç  
19 parashtrohet nga ZPS-ja në aktakuzën e vet.

20 Në rastin e njerëzve që pretendohet që janë ndaluar në  
21 këtë çështje gjyqësore. Ata ishin shtetas të Republikës  
22 Federale të Jugosllavisë ose të Provincës Socialiste Autonome  
23 të Kosovës. Për rrjedhojë zbatohet për këto lloj aktesh ligji  
24 i vendit përkatës. Në çdo rast nuk është ligji i Dhomave të  
25 Specializuara ai i cili mund të zbatohet për këta persona.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 131

1 Neni 14(c) nuk është i zbatueshëm ose thjesht nuk mund të  
2 zbatohet dhe kjo nuk parashikohet në nenin e përbashkët 3.

3 Tani më lejoni të bëj një konstatim sa i takon konfliktit  
4 të armatosur.

5 Kosova deklaroi pavarësinë e vet në vitin 2008. Kosova në  
6 vitin 1999, gjatë periudhës së aktakuzës, ishte pjesë e  
7 Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Deri në vitin  
8 1990 Kosova është njohur si Provinca Socialiste Autonome e  
9 Kosovës. Pas vitit 1990 ajo thjesht ka qenë një provincë e  
10 Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë dhe statusi  
11 autonom më pas u shpërbë nga Parlamenti Serb.

12 Nga qershori i vitit 1999, ajo ka qenë nën Administratën  
13 e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara. Në aspektin ligjor edhe  
14 pse me një administratë të ndryshme, kjo nuk e ndryshoi  
15 statusin e vet. Eventualisht Kosova ishte në gjendje që të  
16 bëhej një shtet i pavarur sovran në kurriz të shumë jetëve të  
17 humbura dhe për shumë beteja për të cilat shumë njerëz dhanë  
18 jetën e tyre.

19 Pikëpamja gjeografike dhe statusi i Kosovës është i  
20 rëndësishëm për t'u vënë në dukje në kuptimin e përfaqësimit  
21 të këtij konflikti. Fillimisht, konflikti i armatosur në  
22 Kosovë mund të përshkruhet si një konflikt i armatosur jo i  
23 një karakteri ndërkombëtar. Megjithatë, me 23 mars 1999, z.  
24 Javier Solana, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-Serbisë  
25 deklaroi në një konferencë për shtyp: "Unë sapo e kam udhëzuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 132

1 SACUER, Gjeneral Clark që të fillojë operacionet në Republikën  
2 Federale të Jugosllavisë". Në Beograd u deklarua gjendja e  
3 emergjencës në të njëjtën kohë. Domethënë, Javier Solana sa e  
4 sapo kishte udhëzuar ndihmën dhe sulmet ajrore të NATO-s ishin  
5 urdhëruar nën forcat e Aleancës dhe u kryen në fund të vitit  
6 1999, në qershor të 1999. NATO-ja sigurisht që përbëhej nga  
7 një grup vendesh dhe ishin këto shtete që ranë dakord për  
8 veprimin e Aleancës, operacionin e Aleancës. Si të tilla të  
9 gjitha vendet e NATO-s u bënë pjesë e konfliktit, në kuptimin  
10 që ata u bënë një prej palëve luftuese në konflikt. Nuk është  
11 relevante që Jugosllavia është synuar nga vendet individuale,  
12 por nga ana tjetër pa diskutim kjo ishte diçka e detyrueshme  
13 për vendet që funksionuan mbi NATO-n, në kuadrin e NATO.

14 Megjithatë, pavarësisht motiveve që mund të ketë patur  
15 NATO-ja ato nuk janë me rëndësi për çështjen kundër Salih  
16 Mustafës. Ajo çfarë është me rëndësi është që nga marsi, nga  
17 24 marsi në vijim kishte një tjetër palë luftuese,  
18 përkatësisht vendet e përbashkëta të NATO-s të cilët u bënë  
19 pjesë Serbisë konfliktit.

20 Pavarësisht në qoftë se vendet e NATO-s janë bombarduar  
21 apo jo nga Serbia, kjo nuk ka rëndësi. Serbia, pavarësisht  
22 kësaj, deklaroi luftën kundër vendeve të NATO-s, kjo  
23 parashikohet në dokumentin e OSBE-së të datës 25 mars 1999.  
24 Është dokumenti me ERN SPOE0006124-43.

25 Mbrojtja parashtron se nga data 24 mars në vijim, të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 133

1 paktën përshkrimi i konfliktit të armatosur mund të jetë dhe  
2 duhet të jetë i cilësuar si konflikt i armatosur me një  
3 karakter ose natyrë ndërkombëtare. Kjo është në përputhje me  
4 jurisprudencën e TPNJ-së, në veçanti me paragraf 1580 dhe 1581  
5 të çështjes Djordjevic të TPNJ-së. Është çështja I-05-87/I-IT.

6 Sa i takon NATO-s e cila realizoi sulmet, aplikohet  
7 gjithashtu konventat e Gjenevës. Fakti që NATO-ja u bë pjesë e  
8 konfliktit të armatosur, mund të thuhet në këtë rast që  
9 kriteret për të qenë palë zbatohen dhe mbi NATO-n. Dy  
10 elementet përcaktues të një konflikti të armatosur janë,  
11 intensiteti i konfliktit dhe niveli i organizmit të palëve.

12 Sa i takon këtyre dy elementeve përcaktues, Mbrojtja  
13 parashton se NATO-ja pa diskutim i përmbush këto dy elemente.  
14 Mund të arrihet në përfundimin nga aktet e mëposhtme:

15 Serioziteti i sulmeve të NATO-s dhe rritja e përplasjeve  
16 të armatosur, në veçanti, gjithashtu edhe me forcat e NATO-s.  
17 Shpërndarjen e luftimeve gjatë një periudhe të caktuar  
18 ndërkohë që NATO-ja bombardoi si në Kosovë ashtu dhe në Serbi,  
19 po gjithashtu edhe në zona të tjera të Republikës Federale  
20 Jugosllave. Përveç kësaj ka pasur një rritje të numrit të  
21 forcave qeveritare dhe ka pasur mobilizim dhe shpërndarje të  
22 armëve ndërmjet të dyja palëve në konflikt. Së fundi.  
23 Konflikti ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të  
24 Kombeve të Bashkuara.

25 Sa i takon organizimit të palëve në konflikt, Mbrojtja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 134

1 beson se NATO-ja -- se për NATO-n duhet të merret parasysh  
2 faktorë të tjerë si, prania e një selie, zonat e caktuara të  
3 operacioneve dhe mundësia për të prokuruar për të transportuar  
4 dhe për të shpërndarë armë.

5 Nga 24 mars deri në qershor 1999 ka pasur një intensitet  
6 të jashtëzakonshëm nga ana e NATO-s lidhur me etiketat që ata  
7 kishin si në Kosovë ashtu dhe në Republikën Federale të  
8 Jugosllavisë. Intensiteti ishte i tillë që ose më datën 9  
9 qershor ose rreth kësaj date luftimet u ndërpreën.

10 Kjo e gjitha do të thotë që kur shohim periudhën e  
11 Aktakuzës që është prill i vitit 1999 kjo është pjesa e  
12 objektit të periudhës kur ka pasur sulme ajrore nga NATO-ja.  
13 Këto sulme ajrore e patën zanafillën nga jashtë Kosovës dhe  
14 jashtë Republikës Federale të Jugosllavisë.

15 NATO-ja nuk kishte mandat të Kombeve të Bashkuara dhe  
16 sulmet ajrore nuk ishin pjesë e asnjë operacioni paqeruajtës.  
17 Sulmet ajrore të e NATO-s kanë qenë gjithmonë objekt i  
18 debateve të shumta sepse nuk ka pasur një mandat ligjor për  
19 to.

20 Si përfaqësim i konfliktit dhe përderisa reflektimi i  
21 konfliktit sjell një dallim, Mbrojtja parashton se neni  
22 14(1)(c) sepse ai është hartuar për t'i drejtuar një konflikti  
23 të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar.

24 Tani më lejoni që të kaloj tek trajtimi mizor. Dëshirojmë  
25 tani që të flasim për trajtimin mizor. Së pari, krimi i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 135

1 trajtimit mizor parashikohet në nenin 14(1)(c)(i) të Ligjit  
2 për Dhomat e Specializuara.

3 Krimi i luftës i trajtimit mizor në asnjë mënyrë nuk  
4 përcaktohet në Ligjin e Dhomave të Specializuara. Ai thjesht  
5 përmendet, parashikohet pranë gjyqtimit dhe torturës.

6 Tema tjetër është konflikti i armatosur. Në mënyrë që të  
7 mos përsëris veten, të nderuar Gjykatës, Mbrojtja dëshiron që  
8 të ritheksojë pozicionin e vet për përfaqësimin e konfliktit  
9 të armatosur, ashtu siç edhe gjëra që sapo thamë lidhur me  
10 personat e mbrojtur, bazuar në nenin e përbashkët 3 të  
11 Konventave të Gjenevës.

12 Personat e mbrojtur në bazë të nenit të përbashkët 3.  
13 Gjithashtu Mbrojtja ka qëndrimin sa i takon individëve të  
14 cilët janë mbajtur dhe qëndrimi ynë është i njëjti siç thashë  
15 edhe më përpara që këta persona nuk janë pjesë e nenit 14 të  
16 Konventës së Gjenevës. Pra, këta individë nuk bien në fushën e  
17 veprimit të mbrojtjes së personave siç parashikohet në nenin  
18 14 të Konventës së Gjenevës.

19 Qëndrimi i përgjithshëm i Mbrojtjes lidhur me këtë krim  
20 dhe e kam fjalën këtu për pikën 2 të Aktakuzës, është si më  
21 poshtë: Mbrojtja parashtron se Z. Mustafa nuk e ka kryer këtë  
22 krim. Kaq e thjeshtë është. Ai nuk ishte në dijeni fare të  
23 faktit që këta persona ishin të ndaluar ose për çfarëdo arsye  
24 mund të kenë qenë të ndaluar. Ai nuk e di fare se ku mund të  
25 kenë qenë ata të ndaluar. Ai nuk ka urdhëruar as nuk ka nxitur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 136

1 krime të tilla. Z. Mustafa nuk ka kryer asnjë trajtim mizor  
2 përmes formave të përgjegjësisë penale siç parashtrohet nga  
3 ZPS-ja.

4 Nuk ka asnjë provë që provon, që mbështet asnjë mosveprim  
5 prej tij, që trajtimi mizor do të ishte kryer kundër ndonjë  
6 individi. Kështu që në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë as me  
7 kryerje përmes mosveprimit.

8 Ai madje, as nuk i njeh fare tre nga katër individët që  
9 do të diskutojmë më poshtë. Individi i katër 03594 është  
10 dikush që ai e njihte disi. Megjithatë, Dëshmitari 3594  
11 deklaroi se ai nuk e ka parë asnjëherë Salih Mustafën në  
12 vendin e krimit. Dhe po ta kishte parë 3594 Salih Mustafën  
13 aty, ai do ta kishte thënë këtë gjë. Kjo ishte shumë e qartë  
14 në dëshminë e dhënë prej tij. Siç e tha edhe ai me gojën e  
15 vet:

16 "Edhe në qoftë se do të kishte qenë vëllai im, nuk do ta  
17 kisha mbrojtur po ta kisha parë."

18 Elementët e krimit.

19 Sa i takon trajtimin mizor si krim lufte, është e  
20 nevojshme që kryesi të ketë shkaktuar vuajtje të rëndë fizike  
21 ose mendore ndaj një ose më shumë personave. Përveç kësaj,  
22 trajtimi duhet të ndodhë në kuadrin edhe të jetë i lidhur me  
23 një konflikt të armatosur që nuk ka një karakter ndërkombëtar.

24 Sa i takon parimit *mens rea*, kryesi duhet të ketë vepruar  
25 me synimin e drejtpërdrejtë për të kryer trajtim mizor ose



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 137

1 fushës së veprimit, të synimit të tërthortë. Pra çfarë do të  
2 thotë që të kishte njohuri që trajtimit mizor të ishte një  
3 pasoje e mundshme e veprimit ose mosveprimit të tij.

4 Kushtet në Zllash.

5 Zllashi është një vend i largët, në majë të një kodre,  
6 siç e kemi parë. Është një vend ku nuk ka kanalizime, nuk ka  
7 një sistem të rregullt të furnizimit me ujë dhe rryma  
8 elektrike nuk ka qenë e disponueshme në vendet që përshkruhen  
9 nga dëshmitarët. Nuk kishte edhe ndriçim të rrugëve. Këtë gjë  
10 e kanë dëshmuar dëshmitarët e Mbrojtjes. Nuk kishte rrugë të  
11 shtruara, nuk kishte sistem për t'u përdorur në tualete, për  
12 t'u pastruar tualete. Nuk kishte tualete fare, nuk kishte  
13 dushe për t'u larë. Nuk kishte mundësi për të larë rrobat ose  
14 nuk kishte lavatriçe për të larë rrobat.

15 Kur ka përshkruar shtëpitë, Fatmir Sopi deklaroi:

16 "Vendi ku qëndronte BIA ishte çdo vend tjetër në zonë."

17 Ai përshkroi se shtëpitë në atë zonë, pra, në Zllash  
18 ishin si të gjitha shtëpitë e tjera në zonën e Gollakut.

19 Fatmir Sopi thotë dhe e citoj:

20 "Ishte një shtëpi normale e fshatit. Kishte një oborr dhe  
21 një ndërtesë për të jetuar. Ishte njësoj si shtëpitë tona  
22 sepse UÇK-ja nuk kishte baraka."

23 Dhe këtë e citoj nga faqja 2048 e datës 18 janar 2022, në  
24 transkript.

25 Shtëpitë në atë vend i kishin ndërtuar vetë njerëz. Nuk

1 është një vend i zhvilluar urban. Nuk ka patur kompani  
2 ndërtimesh që t'i ketë ndërtuar këto shtëpi, siç ndodh në  
3 vendet urbane. Këto shtëpi janë ndërtuar nga njerëzit të cilët  
4 i kanë ndërtuar vetë për familjen e tyre. Me fjalë të tjera  
5 nuk ka patur asnjë lehtësi higjienike siç dihet kjo në vitin  
6 2022, as në qytetin e Prishtinës nuk jetonin njerëzit në atë  
7 kohës.

8 Siç ka ndodhur nuk ka patur ndonjë ndryshim mes njerëzve  
9 që po i iknin konfliktit apo ndokujt që jetonte atje. Kushtet  
10 janë siç janë në një vend të atillë.

11 Qëndrimi i ZPS-së lidhur me trajtimin mizor.

12 ZPS-ja e ka diskutuar trajtimin mizor në dosjen e saj  
13 përfundimtare gjyqësore, paragrafin 295 deri në paragrafin  
14 302.

15 Trajtimi mizor sipas ZPS-së përbëhet nga dy faktorë në  
16 paragrafin 295 të dosjes përfundimtare gjyqësore: krijimi i  
17 kushteve çnjerëzore dhe duke bërë rrahje dhe forma të tjera të  
18 keqtrajtimit që përfshijnë dëmtimin mendor dhe fizik. Të  
19 akuzuarit dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së i kanë nënshtruar  
20 shtatë vetë ndaj këtij trajtimi çnjerëzor siç është thënë më  
21 lartë.

22 Kushtet çnjerëzore.

23 Krijimi i kushteve çnjerëzore sipas Mbrojtjes është që  
24 këto kushte apo kjo gjendje nuk është krijuar nga i akuzuari  
25 apo ndonjë ushtar i UÇK-së siç thotë ZPS-ja. Mbrojtja vëren se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 139

1 ishte një numër i madh njerëzish të cilët ishin zhvendosur  
2 brenda vendit. Këta njerëz ndodheshin edhe në vendin -- në atë  
3 vend në Zllash ku supozohet që janë mbajtur këta njerëz. Ka  
4 pasur njerëz që kanë fjetur jashtë. Nuk ka patur tualete apo  
5 vend për t'u larë apo për të larë rrobat. Të gjithë këto  
6 njerëz e kanë përballuar situatën ashtu siç ishte. Ishte një  
7 grup i madh i cili ishte vendosur në kamp jashtë.

8 Për sa i përket dëshmive, asgjë nuk është paraqitur për  
9 të treguar që këto kushte apo gjendje të jetë krijuar nga UÇK-  
10 ja apo BIA apo ndokush në veçanti. Nuk kemi dëgjuar dëshmi për  
11 krijimin e ndonjë gjëje të kësaj natyre aty.

12 Katër individët të cilët kanë dëshmuar lidhur me  
13 trajtimin e tyre.

14 Nga shtatë individët të cilët thuhet se janë mbajtur të  
15 paraburgosur në kompleksin e ndalimit në Zllash, tre kanë  
16 folur lidhur me trajtimin mizor. Nuk ka informacion lidhur me  
17 Burmakun, i cili mbetet njeri në kërkim e sipër apo i humbur.  
18 Nuk ka informacion lidhur me viktimën e vrasjes. [REDAKTUAR]  
19 [REDAKTUAR] nuk ka dhënë dëshmi në Gjykatë dhe nuk ka  
20 informacion lidhur me të.

21 Asnjë prej individëve nuk është marrë në pyetje së bashku  
22 apo në praninë e disa prej të paraburgosurve të tjerë. Pra,  
23 dëshmitë që duhen -- që paraqiten janë, vijnë ose nga ajo --  
24 nga dëshmia e individëve vetë ose nga ajo që kanë parë pasi  
25 një individ është kthyer në vendin ku mbaheshin të ndaluar

1 personat e tjerë.

2 Kjo do të thotë që mbeten katër individë që kanë dhënë  
3 dëshmi para këtij Trupi Gjykues.

4 3594 ka deklaruar si më poshtë lidhur me trajtimin e tij:

5 Pyetja ishte:

6 "Ju deklaruat që ju kanë rrahur një herë, ndërkohë që të  
7 tjerët janë rrahur të paktën edhe një herë tjetër. A ju  
8 kujtohet një gjë e tillë?"

9 Dhe ai u përgjigj:

10 "Jo nuk më kujtohet. Ndoshta më kanë keqkuptuar. Nuk ka  
11 pasur një herë më shumë dhe një herë më shumë. Kjo ishte  
12 goditje në duar. Nuk ishte diçka e rëndë. Ishte si të godasësh  
13 një fëmijë të shkollës fillore. Nuk më kanë goditur në  
14 gjymtyrët e mia, në duar apo në pjesë të tjera të trupit. Siç  
15 e thashë ky ishte një person shumë i ri dhe e kam trajtuar të  
16 si fëmijët e mi. Nuk isha fare i zemëruar me të. Me vinte keq  
17 për të, thjesht. Nuk më vinte keq për veten tim. Dhe siç e  
18 thashë, kjo ndodhi vetëm një herë. Dhe e njëjta gjë u ka  
19 ndodhur edhe të tjerëve. Nuk ka pa patur ndryshim mes meje dhe  
20 të tjerëve. Ishte vetëm një person."

21 Pra, për sa i përket shkopit, nuk më kujtohet nëse ishte  
22 një shkop gome, por ishte shumë i lehtë. Nuk ndjeva asnjë  
23 dhimbje apo vuajtje, pavarësisht se kishte dëmtim të dorës."

24 Ky ndodhet në transkript në faqen 1070 me datën 12 tetor.

25 Dëshmitari u tërhoq si viktimë gjatë kësaj seance të

1 gjyqit.

2 Por qëndrimi i Mbrojtjes lidhur me këtë individ 03594  
3 është që ai nuk ka pësuar trajtim mizor. Kushtet në të cilat  
4 është mbajtur në vetvete nuk përbëjnë trajtim mizor. Nuk i  
5 shkakton dhimbje të rëndë apo vuajtje personit në fjalë. Akti  
6 i goditjes së dikujt në gishta nuk përbën dhimbje apo vuajtje  
7 të rëndë. Përndryshe është një vepër penale lokale e cila  
8 duhet trajtuar nga një gjykatë vendore.

9 W4669 thotë lidhur me trajtimin e tij, ai asnjëherë nuk  
10 ka thënë që është rrahur nga një person me emrin Cali. Cali  
11 nuk është përmendur asnjëherë nga dëshmitari. Nuk ka asnjë  
12 indikim që i akuzuari Salih Mustafa ta ketë rrahur atë. Në  
13 fakt ky dëshmitar nuk i ka treguar me emër apo me nofkë asnjë  
14 prej personave që e kanë keqtrajtuar. Ai di thjesht se çfarë  
15 moshe kishin njerëzit që kanë keqtrajtuar. Dhe sipas këtij  
16 dëshmitari këto dy personat të cilët i kanë rrahur ishin të  
17 moshës 17 apo 18 vjeçare. Gjendet në transkript data 10 nëntor  
18 fate 1446.

19 Pavarësisht se dy persona më të vjetër qëndronin në  
20 afërsi, ata nuk kanë marrë pjesë në seancat e rrahjeve dhe  
21 dëshmitari nuk i njihte ato njerëz apo nuk u ka përmendur  
22 emrat.

23 Sa i përket rrahjeve, ai tha si më poshtë.

24 "Ata më thanë që të përkulesha. A do që të tregojmë se si  
25 të duhet të sillesh? Kështu që unë po rrija në këmbë dhe më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 142

1 kërkuan që të përkulesha. Dhe kështu qëndrova. Siç e thashë  
2 unë nuk kisha rroba në pjesën e sipërme të trupit dhe më kanë  
3 goditur në shpatulla, që nga kjo pjesë deri këtu lartë. Nga  
4 këtu deri këtu. Më goditën me një shkop gome. Ishte një si  
5 shkop gome të cilin e përdorte milicia. Forcat militare serbe.  
6 Nuk ishte një shkop metalik, por siç e thashë ishte si një  
7 shkop gome i policisë.”

8 “A ju kujtohet se si?”

9 “Ishte një shkop polici.”

10 10 nëntor, faqe 1444.

11 “Po i kthehem edhe një herë pyetjes”, ishte pyetja që ju  
12 bë. “A ju kujtohet sa herë ju kanë goditur me atë sa i përket  
13 thoni shkop gome?”.

14 Pyetje: [sipas përkthimit]

15 “Vetëm atë natë.”

16 “Pyetja”, ishte vazhdimi, “nuk kishte të bënte se sa herë  
17 u rrahët ndërkohë që ndodheshit në Zllash. Pyetja kishte të  
18 bënte se sa herë ju kanë goditur në shpinë me atë shkop gome,  
19 nëse ju kujtohet?”

20 “Rreth 12 herë. Ndoshta më shumë se kaq”, tha dëshmitari.

21 Data 10 nëntor, faqe 1445.

22 Motivet për rrahjet ose trajtimin mizor.

23 3594. Nuk kemi informacion objektiv lidhur me motivin se  
24 përse të jenë rrahur njerëzit. 3594 deklaroi se pas një pyetje  
25 sugjestionuese të ZPS-së:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 143

1 "Faleminderit z. Dëshmitar. Do ju kujtohet [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR] mund të ketë të bëjë me arrestimin tuaj?"

5 Përgjigja:

6 "Unë mendoj, kam dyshime se ndoshta kjo është një nga  
7 arsyet se pse më kanë burgosur".

8 Pastaj pyetja ishte:

9 Ju kërkoj ndjesë. "Përse [REDAKTUAR] do të ishte  
10 një arsye e mundshme për arrestimin tuaj? A mund të ndalimi  
11 arbitrar shpjegoni neve dhe Trupit Gjykues. Çfarë ju bën ta  
12 besoni një gjë të tillë?"

13 Përgjigja ishte:

14 "Arsyeja për këtë është [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]. Kjo nuk ishte një nga arsyet që më kanë thënë që  
19 më kanë ndaluar në Zllash, por ndoshta mund të ketë qenë një  
20 nga arsyet se përse më dërguan atje."

21 Transkripti i 13 tetor, faqe 1169.

22 Ne mund të arrijmë në përfundimin se pavarësisht motiveve  
23 për t'i ndaluar apo për të rrahur një dëshmitar, kjo është e  
24 bazuar thjesht në atë që mendon një dëshmitar. Nuk ka pasur  
25 asnjë konfirmim nga burime objektive lidhur me motivin se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 144

1 përse ja kanë bërë një gjë të tillë. Mbushja e hendeqeve në  
2 dokumentat e dëshmitarëve është thjesht spekulim dhe  
3 përfundimi është që nuk mund të përcaktohet se cila është  
4 arsyeja për arrestimin e tij. Përse e kanë goditur në gishtat  
5 e tij. Dhe kjo ka ndodhur në kohën që ai ishte i ndaluar në  
6 pjesën e poshtme.

7 Dhe kjo rrahje dhe këtë do ta vendos në thonjëza, nuk ka  
8 të bëjë me trajtimin mizor. Pala Mbrojtëse ka thënë se kjo nuk  
9 është...

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
11 Avokat, ndaloni për shkak se kemi humbur lidhjen me klientin  
12 tuaj.

13 [Vështirësi teknike]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
15 Mustafa, na dëgjoni?

16 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj, mirëpo  
17 pat ndërpreme ma herët.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
19 t'i kërkoj Avokatit tuaj që të përsëritë disa nga gjërat që ka  
20 thënë gjatë kësaj kohe.

21 Z. Avokat ju e keni fjalën.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe ne mund të përfundojmë që  
23 pavarësisht motivit për ta ndaluar apo për ta rrahur  
24 dëshmitarin, kjo është thjesht e bazuar mbi motivin. Nuk ka  
25 ndonjë konfirmimin apo burim objektiv që të tregojë se çfarë



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 145

1 ka ndodhur. Por të mbushësh hendeqet në deklaratën e një  
2 dëshmitari është spekulim. Dhe konkluzioni është që nuk mund  
3 të përcaktohet arsyeja pra për arrestimin e tij. Se njësoj si  
4 nuk mund të përcaktohet se përse është rrahur vetëm në gishtat  
5 e tij. Dhe kjo ka ndodhur në kohën që ishte i ndaluar në  
6 pjesën e poshtë.

7 Pra, kjo rrahje dhe e vendos këtë në thonjëza, nuk ka të  
8 bëjë me trajtimin mizor. Pala Mbrojtëse ka thënë që dëshmitari  
9 nuk është trajtuar në mënyrë mizore edhe sigurisht që kjo nuk  
10 është bërë nga z. Salih Mustafa.

11 Dëshmitari 4669.

12 Nuk kemi informacion objektiv mbi motivin se përse  
13 njerëzit janë rrahur. 4669 deklaroi se:

14 "Nuk di për të tjerë. Ndoshta ka pasur njerëz më të  
15 vjetër. Sidoqoftë, më vonë kur kam pasur mundësinë t'i  
16 analizoj gjërat unë mendoj se ata nuk kanë planifikuar që të  
17 më rrahin. Besoj se kjo kishte të bënte me paragjykimin  
18 politike me besimet tona politike dhe ushtarake. Kjo është  
19 diçka që ju ka ndodhur edhe njerëzve të tjerë. Unë mendoj se  
20 kjo është arsyeja përse është bërë një gjë e tillë. Nuk kishte  
21 të bënte me faktin që ne ishim spinë pasi kjo nuk kishte të  
22 bënte fare me të qenit spiunë apo jo."

23 Dhe ne mund të përfundojmë, e nderuar Gjykatëse,  
24 pavarësisht motivit për të ndaluar apo për të rrahur këtë  
25 dëshmitar, kjo është e bazuar thjesht në një analizë të bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 146

1 më vonë nga vetë dëshmitari. Nuk ka konfirmim nga burime  
2 objektive lidhur me motivin për këtë dhe mbushja e hendeqeve  
3 në deklaratën e një dëshmitari është thjesht spekulim.

4 Dhe përfundimi është që nuk mund të përcaktohet arsyeja  
5 për arrestimin, ndalimin apo rrahjen së cilit i është  
6 nënshtruar ai. Kështu që Trupi Gjykses nuk mund të arrijë në  
7 konkluzion në këtë drejtimin.

8 Kemi dy dëshmitarë të cilët thuhet që janë trajtuar në  
9 mënyrë mizore.

10 3593, shpeshësia e rrahjeve.

11 3593 sipas tij është rrahur dy herë. Një herë kur arriti  
12 dhe një herë tjetër. Hera e parë ka ndodhur kur ka arritur në  
13 vendin ku është mbajtur.

14 Numri i kryesve, u pyet për këtë:

15 "Ishin tre apo katër persona. Siç e thashë mbi kokë më  
16 vendosej një thes dhe më nxorën jashtë dhe siç e thashë dhe  
17 filluan të më rrihnin. Nuk e dija se kush ishin këta persona."

18 20 shtator, faqja 407.

19 Një përgjigje tjetër:

20 "Nuk e di se kush më ka goditur. Nuk kam si ta di. Ishin  
21 katër apo pesë persona që më rrahën në të gjitha mënyrat e  
22 mundshme si kanë dashur. Dhe siç e thashë humba ndjenjat dy  
23 herë dhe nuk di gjë tjetër."

24 Datën 20 shtator, faqe 415.

25 Lidhur me mundësinë për t'i parë kryesit:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 147

1 "Nuk e di si më kanë rrahur. Mund të them që më ka rënë  
2 të fikët nja dy herë. Dy apo tri herë më ka rënë të fikët. Më  
3 kanë goditur me dru. Më kanë shkelmuar. Më kanë goditur në  
4 mënyra të ndryshme. Nuk di se me çfarë. Më është thyer gishti.  
5 Kam thyer -- më janë thyer dhëmbët. Kam pësuar lëndime në kokë  
6 dhe kam pasur operacion në kokë. Kaq mund të them."

7 Data 20 shtator, faqja 409.

8 Lidhur me lëndimet.

9 "Siç ju thashë kur më kanë ndaluar në fillim ditën e parë  
10 më goditën me grusht në fytyrë. Disa nga dhëmbët janë thyer.  
11 Jo të gjithë. Kur më kanë rrahur më kanë vazhduar më kanë  
12 rrahur. Më kanë shkelmuar me të gjitha llojet e instrumenteve  
13 dhe kjo ndodhi -- atëherë mu thyen dhëmbët. Nuk më kujtohet  
14 çdo gjë për shkak se kam humbur ndjenjat shpesh herë."

15 Fjalët e kryesve.

16 "Ata nuk thanë asgjë. Vetëm thjesht më shanin. Kanë thënë  
17 shumë gjëra të ndryshme. Më kanë rrahur. Më kanë sharë dhe siç  
18 e thashë një herë më goditën në kokë. Më shkelmuan. Më goditën  
19 me një shkop. Dhe kaq di të them. Nuk di se çfarë."

20 Faqja 409, 20 shtator.

21 "Unë po flas tani për rastin e parë. Nuk kam dëgjuar gjë  
22 sepse po më godisnin në të njëjtën kohë pesë apo gjashtë  
23 persona. Nuk kisha as dijeni se çfarë po më ndodhte."

24 20 shtator, 429.

25 Për sa i përket kohëzgjatjes, e nderuar Gjykatëse, ai

1 tha:

2 "Nuk kam ide se sa ka zgjatur kjo rrahje për shkak se nuk  
3 kisha orë, nuk kishte elektricitet. Nuk e di. Ndoshta ka  
4 zgjatur dy, tre orë, katër orë. Nuk e di, nuk mund të them."

5 Prokurori pyeti, "Pyetja ime nuk ka të bëjë me orën e  
6 rrahjes. Koha ka të bëjë me momentin. Me ngjarjen. Si ka  
7 përfunduar kjo rrahje. Për shkak se ka mbaruar në një pikë të  
8 caktuar. Si përfundoi? Kjo ishte pyetja ime."

9 "Është e qartë. Më rrahën mua për një kohë shumë të  
10 gjatë. Unë humba ndjenjat nja dy herë. Më hidhnin ujë dhe  
11 pastaj më tërhoqën dhe më dërguan në një dhomë tjetër. Në atë  
12 kohë nuk kam ditur gjë. Në atë moment kohor unë isha i shtrirë  
13 aty në ujë në ahur ndoshta deri të nesërmen. Nuk e di sesa ka  
14 qenë ora. Por e di që isha aty deri të nesërmen."

15 Për sa i përket shfrytëzimit të armëve, të nderuar  
16 Gjykatës, ky person thotë:

17 "Gjatë rrahjeve që keni përshkruar, a ka përdorur ndonjë  
18 armë ndonjëri prej kryesve?"

19 Përgjigja: "Po".

20 "A mund të na thoni më shumë lidhur me përdorimin e kësaj  
21 arme."

22 "Kur isha i shtrirë, njëri prej tyre nxori revolverin dhe  
23 ma vendosi në këtë vend. E vendosi revolverin këtu dhe unë  
24 dëgjova zhurmën. Pra kisha përshtypjen se po më vrisnin. Për  
25 një moment ai bëri këtë zhurmën me revolverin, por fakti është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 149

1 që nuk gjuajti. Dhe pastaj ky person tha: E di çfarë? Lëreni,  
2 sepse ky person është me fat.”

3 Për sa u përket motivit për trajtimin mizor, dëshmitari  
4 tha -- pyetja ishte:

5 “A ishin duke bërë ndonjë akuzë lidhur me këtë?”

6 Ai tha:

7 “Po -- jo, jo, nuk më thanë asgjë mua. Por thjesht më  
8 akuzuan mua që isha bashkëpunëtor i serbëve.”

9 Dhe për rrahjen e dytë, pyetja ishte:

10 “Ju thatë që ju kanë bërë pyetje, një pyetje apo më shumë  
11 që kanë të bëjnë me faktin që ndoshta keni njohur disa  
12 hajduta. A ju kujtohet ndonjë pyetje tjetër që jua ka bërë ai  
13 person juve?”

14 Përgjigja:

15 “Jo, ai nuk tha asgjë tjetër. Më pyeti nëse njihja disa  
16 hajdutë. Ose na trego ose do t'ju vrasim. Po të na tregoni do  
17 t'ju lëmë të shkoni në shtëpi. Kaq më tha.”

18 Data 20 shtator, faqe 438.

19 Pyetje:

20 “A ju kanë akuzuar juve?”

21 “Po -- jo, jo nuk më thanë asgjë. Vetëm se më kanë  
22 akuzuar se isha bashkëpunëtor i serbëve.”

23 Pastaj dëshmitari 1679.

24 Mjetet e përdorura për rrahjen.

25 “Na kanë shkelmuar, na kanë goditur me shkopinj druri, me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 150

1 shkopinj hekuri. Na kanë djegur me qiri e vendosnin qiriun  
2 lart dhe të digjnin me elektricitet. Kishin një kuti dhe na i  
3 lidhnin këmbët me tela. Pra kishte lloje-lloje të torturës.  
4 Mënyra se si më kanë rrahur, më kanë çuar në katin e sipërm,  
5 kishin sakica. Dhe pastaj kishin disa shkopinj që ishin si ato  
6 të policisë. Ato ishin hekuri dhe i kanë përdorur ato për të  
7 më goditur.”

8 “Ju përmendët disa qiri, çfarë kanë bërë? A mund të më  
9 shpjegoni?”

10 “Ata uleshin në një karrige, ndiznin qiriun, e vendosnin  
11 në afërsi të shpinës tuaj dhe dylli binte në lëkurën tënde dhe  
12 të digjte.”

13 Dhe dëshmitari vazhdoi foli për një hekur të nxehtë. Po,  
14 ai tha:

15 “Është një si hekur hekurosje. Ajo po bënte diçka në  
16 dhomë. Nuk e pashë. Ishte pas meje.”

17 “Po vendndodhja ishte lart apo poshtë?”

18 “Këto ndodhën në katin e sipërm.”

19 “Për shkak se përmendët edhe stallën edhe pjesën e  
20 sipërme, çfarë kanë bërë poshtë aty në stallë? Çfarë lloj  
21 keqtrajtimi?”

22 “Kushdo që hapte derën të shkelmonte ose të gjuante me  
23 shpulla. Nuk largoheshin pa të bërë diçka.”

24 Deklarata e 4 tetorit, faqja 884.

25 Trajtimet e tjera.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 151

1 "Kjo ndodhi në katin e poshtëm. Kur isha në haur kërkova  
2 ujë, kërkova që të na sillnin ca ujë. Më pas erdhën dy ushtarë  
3 dhe më rrahën. Isha shtrirë në tokë. Në fund ato urinuan mbi  
4 trupin tim. Dhe thanë: Ky është uji që do."

5 Shpeshtësia e rrahjeve.

6 Është pyetur lidhur me shpeshtësinë.

7 "Ka ndodhur pothuajse çdo ditë. Ndoshta ka pasur ditë kur  
8 nuk më kanë rrahur aq shumë dhe intensiteti ishte më i ulët në  
9 këtë ditë. Por më kanë rrahur thuajse çdo ditë."

10 E nderuar Gjykatëse, dëshmitarët kanë thënë të njëjtën  
11 gjë. Unë dua tani të kaloj tek tortura.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Avokati Mbrojtës, është koha për ta përfunduar sesionin e  
14 ditës së sotme. Kështu që unë do të propozoj që të vazhdojmë  
15 nesër me deklaratën tuaj mbyllëse.

16 A mund të na tregoni se sa kohë do t'ju duhet gjatë ditës  
17 së nesërme?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Jam pothuajse në fund. Ndoshta  
19 edhe një orë, maksimumi.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
21 shkak se sipas llogaritjeve të mia, ju kanë mbetur edhe 40  
22 minuta. Por sigurisht që do t'ju japim kohën që ju nevojitet.  
23 Kështu që besoj që do të përfundoni gjatë seancës së parë.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Sigurisht, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pasi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 152

1 në këtë mënyrë do të mund të bëjmë të mundur që t'u jepet kohë  
2 ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave për të përgatitur komentet  
3 që kanë mbi ato që ju keni thënë tashmë.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Dakord. Atëherë unë po e  
5 përfundoj këtu për ditën e sotme.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
7 mund të biem dakord atëherë që ju do të përfundoni në seancën  
8 e parë?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] 100 për qind i sigurt, të nderuar  
10 Gjykatës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Atëherë për ditën e nesërme, do të përfundojmë deklaratën  
13 mbyllëse të Mbrojtjes dhe më pas kemi parashikuar në rendin e  
14 ditës, përgjigjen e ZPS-së dhe të Mbrojtjes së Viktimave, ndaj  
15 çështjes që ka ngritur pala Mbrojtëse, lidhur me fajësinë apo  
16 pafajësinë e të akuzuarit dhe ndonjë koment që kanë lidhur me  
17 masën e dënimit. Pastaj kemi komentet e Mbrojtjes lidhur me  
18 përgjigjet e ZPS-së dhe të Mbrojtjes së Viktimave. Do të  
19 shohim nëse ka pyetje për të bërë nga ana e Trupit Gjykses.  
20 Dhe në fund të ditës dhe ndoshta të premtën, do të diskutojmë  
21 çështjen e dëmshpërblimeve nëse ka nevojë për ta bërë këtë.

22 Pra, kaq për ditën e sotme. I falënderoj të gjitha palët  
23 dhe pjesëmarrësit për praninë e tyre, përkthyesit, të cilët  
24 kanë pasur një ditë të gjatë. Falënderojmë stenografin dhe të  
25 gjithë punonjësit e departamentit audiovizual.



## Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklaratat përmbyllëse (Seancë e hapur)

Faqe 153

1 --- Seanca mbyllet në orën 17.29

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25